



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

21-05-2020

Nr. organit n. broj	Numeri/Drej	Shtetës Prilog	Vlera Vendoset
01	060/01	390	



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Vitina

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor, 2008), dhe të Nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të Nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, në Nenin 6 pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **-III-**, të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën **28.05.2020, (e Enjte)**, duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Shkollën e Mesme Teknike Januz Zejnullahu në Viti.

Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dyte e Kuvendi Komunal.
2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2020
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e draft strategjisë komunale kundër dhunës në familje për vitin 2020-2023, si dhe planin e veprimit
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e draft rregullores për transparencë në Komunën e Vitisë, me kërkesën e MAPL-së.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik të planit komunal i menaxhimit të mbeturinave.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik të rregullores për menaxhimin e mbeturinave.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik të planit komunal i veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021
8. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuar për vitin 2020, dhe raporti i punës për vitin 2019.
9. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit për Arsim, Kultur, Rini dhe Sport për vitin 2020

Me respekt!
Viti, më 21.5.2020

Kryesuesi i Kuvendit
Naim Pira



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Titullat - Prirjeve Mësimore: 14.04.2020

Nr./ organit Org.broj	Numri/Drej.	Shtëpia Prilog	Vlera Wednos*
02-	300/01-	302	



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA - MUNICIPAL VITINA



Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2020

Viti 14.04.2020



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA - MUNICIPAL VITINA



DREJTORIA E FINANCAVE

Data/Datum/Date	13.04.2020
Nr/Br.	
Për/Za/To	Kuvendin e Komunës, Komitetin për Politikë dhe Financa
Përmes/Preko/Through	Z. Sokol Haliti, Kryetar i Komunës
Nga/Od/From	Z. Ibrahim Rama, Drejtor i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim
Lënda/Predmet/Subject	Pasqyrat Financiare për periudhën janar-mars 2020

Bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin mbi Financat Lokale si dhe Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë paraqesim pasqyrat financiare të organizatës sonë buxhetore (657) për periudhën janar-mars 2020 përfshirë të hyrat vetanake të realizuara si dhe shpenzimet buxhetore për të gjitha kategoritë ekonomike.

Të hyrat

Gjatë periudhës janar – mars 2020 janë inkasuar gjithësej të hyra vetanake në vlerë prej 171.796,85€, shkalla e inkasimit, duke u bazuar në planifikimin vjetor është 18,11%, ndërsa Krahasuar me të hyrat për periudhën janar – mars të vitit 2019 të hyrat e vitit 2020 janë me të ulta për 31.235,57 €

Shpenzimet Buxhetore

Buxheti i Alokuar për periudhën janar – mars të vitit 2020 nga fondet burimore: Granti qeveritar, të hyrat vetanake, dhe donacionet janë: 3.411.984,86€, ndërsa shpenzimet janë: 2.119.580,06€, shkalla e ekzekutimit të buxhetit për periudhën janar- mars 2020 është 62,12% në krahasim me Alokimet për të gjitha programet dhe kategoritë ekonomike.

Në vazhdim të këtyre pasqyrave në mënyrë tabelare do të paraqesim shpenzimet buxhetore, duke i specifikuar sipas burimeve të financimit, programeve dhe kategorive Ekonomike.

Buxheti i Aprovuar, Alokuar dhe i shpenzuar per te Gjitha programet buxhetore - janar-mars 2020

Aprovim						
Kateg.&Ekonomik	Aprovime 10	Aprovime 21	Aprovimet 22	Aprovimet Donacionet	Totali i Aprovimeve	
1 Pagat &Shtesat	7,387,753.00	0.00	0.00	1,098.25	7,388,851.25	
2 Mall.&Sherbime	1,386,703.00	245,000.00	0.00	18,725.12	1,650,428.12	
3 Komunali	279,000.00	0.00	0.00	0.00	279,000.00	
4 Subvencione	0.00	250,000.00	0.00	14.31	250,014.31	
5 Kapitale	1,206,551.00	453,599.00	0.00	10.12	1,660,160.12	
	10,260,007.00	948,599.00	0.00	19,847.80	11,228,453.80	

Alokimet						
Kateg.&Ekonomik	Alokimet 10	Alokimet 21	Alokimet22	Alokimet Donacionet	Totali i Alokimeve	
1 Pagat &Shtesat	1,847,327.14	0.00	0.00	1,098.25	1,848,425.39	
2 Mall.&Sherbime	693,351.50	21,653.00	0.00	18,725.12	733,729.62	
3 Komunali	139,500.00	0.00	0.00	0.00	139,500.00	
4 Subvencione	0.00	17,319.92	0.00	14.31	17,334.23	
5 Kapitale	603,275.50	69,710.00	0.00	10.12	672,995.62	
	3,283,454.14	108,682.92	0.00	19,847.80	3,411,984.86	

Te paalokuara						
Kateg.&Ekonomik	Alokimet 10	Alokimet 21	Alokimet22	Alokimet Donacionet	Totali i Alokimeve	
1 Pagat &Shtesat	5,540,425.86	0.00	0.00	0.00	5,540,425.86	
2 Mall.&Sherbime	693,351.50	223,347.00	0.00	0.00	916,698.50	
3 Komunali	139,500.00	0.00	0.00	0.00	139,500.00	
4 Subvencione	0.00	232,680.08	0.00	0.00	232,680.08	
5 Kapitale	603,275.50	383,889.00	0.00	0.00	987,164.50	
	6,976,552.86	839,916.08	0.00	0.00	7,816,468.94	

Shpenzimet							
Kateg.&Ekonomik	Shpenzimet 10	Shpenzimet 21	Shpenzimet 22	Shpenzimet Donacionet	Totali i Shpenzimeve	% shpenzimit	
1 Pagat &Shtesat	1,847,327.14	0.00	0.00	0.00	1,847,327.14	99.94%	
2 Mall.&Sherbime	187,027.29	0.00	0.00	0.00	187,027.29	25.49%	
3 Komunali	55,153.15	0.00	0.00	0.00	55,153.15	39.54%	
4 Subvencione	0.00	7,640.00	0.00	0.00	7,640.00	44.07%	
5 Kapitale	22,432.48	0.00	0.00	0.00	22,432.48	3.33%	
	2,111,940.06	7,640.00	0.00	0.00	2,119,580.06	62.12%	

Diferenca Alokim-Shpenzim						
Kateg.&Ekonomik	Shpenzimet 10	Shpenzimet 21	Shpenzimet 22	Shpenzimet Donacionet	Totali i Shpenzimeve	
1 Pagat &Shtesat	0.00	0.00	0.00	1,098.25	1,098.25	
2 Mall.&Sherbime	506,324.21	21,653.00	0.00	18,725.12	546,702.33	
3 Komunali	84,346.85	0.00	0.00	0.00	84,346.85	
4 Subvencione	0.00	9,679.92	0.00	14.31	9,694.23	
5 Kapitale	580,843.02	69,710.00	0.00	10.12	650,563.14	
	1,171,514.08	101,042.92	0.00	19,847.80	1,292,404.80	

Diferenca Aprovim-Shpenzim						
Kateg.&Ekonomik	Shpenzimet 10	Shpenzimet 21	Shpenzimet 22	Shpenzimet Donacionet	Totali i Shpenzimeve	
1 Pagat &Shtesat	5,540,425.86	0.00	0.00	1,098.25	5,541,524.11	
2 Mall.&Sherbime	1,199,675.71	245,000.00	0.00	18,725.12	1,463,400.83	
3 Komunali	223,846.85	0.00	0.00	0.00	223,846.85	
4 Subvencione	0.00	242,360.00	0.00	14.31	242,374.31	
5 Kapitale	1,184,118.52	453,599.00	0.00	10.12	1,637,727.64	
	8,148,066.94	940,959.00	0.00	19,847.80	9,108,873.74	

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit për të gjitha njësit buxhetore

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	7,388,851.25	1,848,425.39	1,847,327.14	5,541,524.11	1,098.25	99.94%
2	Mallra dhe shërbime	1,650,428.12	733,729.62	187,027.29	1,463,400.83	546,702.33	25.49%
3	Subvencione	250,014.31	17,334.23	7,640.00	242,374.31	9,694.23	44.07%
4	Komunali	279,000.00	139,500.00	55,153.15	223,846.85	84,346.85	39.54%
5	Shpenzime kapitale	1,660,160.12	672,995.62	22,432.48	1,637,727.64	650,563.14	3.33%
	Gjithesëjt	11,228,453.80 €	3,411,984.86 €	2,119,580.06 €	9,108,873.74 €	1,292,404.80 €	62.12%

Shpenzimet për të gjitha njësit buxhetore

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11110	Paga neto	1,569,636.95
11500	Tatimi në paga	91,979.33
11600	Kontributi i punëtorit	87,773.96
11700	Kontributi i punëdhënsit	87,773.96
11115	Sindikata	7,582.81
11125	OIK	500.13
11126	OMK	2,080.00
	Totali i pagave	1,847,327.14
13130	Shpenzimet e udhëimit mbrenda vendit	3,956.90
13210	Shpenzimet e rrymës	48,028.97
13220	Shpenzimet e ujit	4,566.18
13230	Shpenzimet e mbeturinave	689.07
13250	Shpenzimet e telefonis fikse	1,868.93
13320	Shpenzimet e telefonis mobile	2,831.76
13430	Shërbime të ndryshme shëndetësore	24,450.00
13460	Shërbime kontraktuese tjera	20,499.33
13470	Shërbime teknike	529.50
13503	Kompjuter	1,685.00
13509	Pajisje tjera	14,842.65
13610	Furnizime për zyre	7,579.82
13620	Furnizime me ushqim dhe pije	1,861.27
13630	Furnizime mjeksore	7,674.20
13650	Furnizime me veshmbathje	500.00
13760	Furnizim me lende djegese (Dru)	16,243.00

13780	Derivate veturave	2,155.92
13950	Regjistrimi i automjeteve	980.00
13951	Sigurimi i automjeteve	975.24
14010	Mirembatja dhe riparim i automjeteve	2,797.00
14020	Mirembatja e ndertesave	20,040.98
14032	Mirembatja e autorrugëve lokale	16,671.36
14040	Mirembatja e teknologjis informative	2,550.00
14060	Mir rutinore(M utesjelisave dhe kanalizimeve	690.00
14220	Botimet e publikimet	990.00
14230	shpenzimet per informim publik	3,819.45
14310	Dreka zyrtare	4,125.50
14410	Shpenzime - vendimet e gjykatave	28,578.41
	Totali për shërbimeve mallra dhe komunal	242,180.44
200	Subvencionet dhe transfere	7,640.00
	Totali i subvencioneve	7,640.00
300	Investime kapitale	22,432.48
	Totali i investimeve kapitale	22,432.48
	Gjithsej shpenzimet	2,119,580.06 €

Zyra e Kryetarit
Kodi 16033

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	306,156.00	70,002.65	70,002.65	236,153.35	0.00	100.00%
2	Mallra dhe shërbime	136,003.30	64,789.30	24,874.25	111,129.05	39,915.05	38.39%
3	Subvencione	98,000.00	11,569.00	6,340.00	91,660.00	5,249.00	54.71%
4	Komunali	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	Gjithsej	540,159.30 €	146,380.95 €	101,216.90 €	438,942.40 €	45,164.05 €	69.15%
Shpenzimet e Zyres Kryetarit 16033							

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11110	Paga neto	59,260.02
11500	Tatimi në paga	3,989.59
11600	Kontributi i punëtorit	3,333.49
11700	Kontributi i punëdhënsit	3,333.49
11115	Sindikata	86.06
	Totali i pagave	70,002.65
13320	Shpenzimet e telefonis mobile	162.39
13460	Shërbime kontraktuese tjera	7,116.07
13503	Komputer	1,685.00
13509	Pajisje tjera	30.00
13780	Derivate veturave	56.27
13950	Regjistrimi i automjeteve	105.00
14220	Botimet e publikimit	990.00
14230	shpenzimet per informim publik	2,917.30
14310	Dreka zyrtare	891.50
14410	Shpenzime - vendimet e gjykatave	10,920.72
	Totali për shërbime dhe mallra	24,874.25
200	Subvencione dhe transfere	6,340.00
	Totali i subvencioneve	6,340.00
300	Investime kapitale	0.00
	Totali i investimeve kapitale	0.00
	Gjithsej shpenzimet	101,216.90 €

Administrata dhe personeli
Kodi 16333

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	196,324.00	42,420.28	42,420.28	0.00	0.00	100.00%
2	Mallra dhe shërbime	95,000.00	38,998.00	9,394.35	85,605.65	29,603.65	24.09%
3	Subvencione	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
4	Komunali	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	Gjithsej	291,324.00	81,418.28	51,814.63	239,509.37	29,603.65	63.64%

Shpenzimet - Administrata dhe Personeli - 16333

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11110	Paga neto	36,445.52
11500	Tatimi në paga	1,806.23
11600	Kontributi i punëtorit	2,019.88
11700	Kontributi i punëdhënsit	2,019.88
11115	Sindikata	128.77
	Totali i pagave	42,420.28
13460	Shërbime kontraktuese tjera	3,100.30
13509	Pajisje tjera	960.00
13950	Regjistrimi i automjeteve	525.00
13951	Sigurimi i automjeteve	975.24
14040	Mirembajtja e teknologjis informative	30.00
14410	Shpenzime - vendimet e gjykatave	3,803.81
	Totali për shërbime dhe mallra	9,394.35
200	subvencione dhe transfere	0.00
	Totali i subvencioneve	0.00
300	Investime kapitale	0.00
	Totali i investimeve kapitale	0.00
	Gjithsej shpenzimet	51,814.63 €

Zyra e Kuvendit Komunal
Kodi 16933

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit							
Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	92,300.00	23,600.56	23,600.56	68,699.44	0.00	100.00%
2	Mallra dhe shërbime	16,000.00	5,416.00	964.55	15,035.45	4,451.45	17.81%
3	Subvencione	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
4	Komunali	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	Gjithsej						
		108,300.00	29,016.56	24,565.11	83,734.89	4,451.45	84.66%

Shpenzimet e zyrës së Kuvendit Komunal		Shuma
Kodi	Përsëkrimi	
11110	Paga neto	20,158.17
11500	Tatimi në paga	1,204.23
11600	Kontributi i punëtorit	1,119.08
11700	Kontributi i punëdhënsit	1,119.08
11115	Sindikata	0.00
	Totali i pagave	23,600.56
13460	Shërbime Kontraktuese tjera	364.55
14410	Shpenzime - vendimet e gjykatave	600.00
	Totali për shërbimeve dhe mallra	964.55
200	Subvencione dhe transfere	
	Totali i subvencioneve	0.00
300	Investime Kapitale	0.00
	Totali i investimeve kapitale	0.00
	Gjithsej shpenzimet	24,565.11 €

Buxhet e financa
Kodi 17533

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	162,363.25	40,669.96	40,126.71	122,236.54	543.25	98.66%
2	Mallra dhe shërbime	69,902.42	36,564.92	5,176.48	64,725.94	31,388.44	14.16%
3	Subvencione	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
4	Komunal	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	1,520,155.47	612,722.97	22,432.48	1,497,722.99	590,290.49	3.66%
	Gjithsej	1,752,421.14 €	689,957.85 €	67,735.67 €	1,684,685.47 €	622,222.18 €	9.82%

Shpenzimet - Buxhet e Financa 17533

Kodi	Pershkrimi	Shuma
11110	Paga neto	34,286.88
11500	Tatimi në paga	1,935.16
11600	Kontributi i punëtorit	1,910.84
11700	Kontributi i punëdhënsit	1,910.84
11115	Sindikata	82.99
	Totali i pagave	40,126.71
13460	Shërbime kontraktuese tjera	1,217.06
13509	Pajisje tjera	665.00
13610	Fumizime per zyre	163.80
14040	Mirembajtja e teknologjis informative	310.00
14310	Dreka zyrtare	337.00
14410	Shpenzime - vendimet e gjykatave	2,483.62
	Totali për shërbime dhe mallra	5,176.48
200	subvencione dhe transfere	0.00
	Totali i subvencioneve	0.00
300	Investime Kapitale	22,432.48
	Totali i investimeve kapitale	22,432.48
	Gjithsej shpenzimet	67,735.67 €

Sherbime Publike, mbrotje civile, emergjence

Kodi 180

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	211,079.00	76,442.31	76,442.31	134,636.69	0.00	100.00%
2	Mallra dhe sherbime	449,000.00	193,239.00	56,242.70	392,757.30	136,996.30	29.11%
3	Subvencione	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
4	Komunali	146,000.00	73,000.00	30,488.03	115,511.97	42,511.97	41.76%
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	Gjithsej	806,079.00 €	342,681.31 €	163,173.04 €	642,905.96 €	179,508.27 €	47.62%

Shpenzimet - Sherbime Publike, mbrotje civile, emergjence 180

Kodi	Përkrimi	Shuma
11110	Paga neto	64,437.96
11500	Tatimi në paga	4,677.99
11600	Kontributi i punëtorit	3,640.08
11700	Kontributi i punëdhënsit	3,640.08
11115	Sindikata	46.20
	Totali i pagave	76,442.31
13210	Shpenzimet e rrymës	29,746.57
13220	Shpenzimet e ujit	741.46
13320	Shpenzimet e telefonis mobile	2,669.37
13470	Sherbime teknike	389.50
13509	Pajisje tjera	10,710.40
13950	Regjistrimi i automjeteve	35.00
14010	Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve	855.00
14020	Mirembajtja e nderesave	20,040.98
14032	Mirembajtja e autorrugeve lokale	16,671.36
14060	Mirembajtja rutinore(M.uesjelsave dhe kanalizimev	690.00
14310	Drekat zyrtare	66.50
14410	Shpenzime - vendimet e gjykatave	4,114.59
	Totali për sherbime mallra dhe komunali	86,730.73
200	Subvencione dhe transfere	0.00
	Totali i subvencioneve	0.00
300	Investime kapitale	0.00
	Gjithsej shpenzimet	163,173.04 €

Zyra e komuniteteve
Kodi 19865

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	16,607.00	4,147.50	4,147.50	12,459.50	0.00	100.00%
2	Mallra dhe shërbime	3,000.00	500.00	0.00	3,000.00	500.00	0.00%
3	Subvencione	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
4	Komunali	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	Gjithsej	19,607.00	4,647.50	4,147.50	15,459.50	500.00	89.24%
Shpenzimet - Zyra e Komuniteteve - 19865							

Kodi	Përshkrimi	Shuma
11110	Paga neto	3,556.29
11500	Tatimi në paga	183.99
11600	Kontributi i punëtorit	197.49
11700	Kontributi i punëdhënsit	197.49
11115	Sindikata	12.24
	Totali i pagave	4,147.50
	Totali për shërbime dhe mallra	0.00
200	Subvencione dhe transfera	0.00
	Totali i subvencioneve	0.00
300	Investimet Kapitale	0.00
	Totali i investimeve kapitale	0.00
	Gjithsej shpenzimet	4,147.50 €

Shëndetësia - kodi 730

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	1,009,048.00	245,217.78	245,217.78	763,830.22	0.00	100.00%
2	Mallra dhe shërbime	360,000.00	161,000.00	53,717.44	306,282.56	107,282.56	33.36%
3	Subvencione	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
4	Komunali	35,000.00	17,500.00	9,498.50	25,501.50	8,001.50	54.28%
5	Shpenzime kapitale	70,000.00	28,852.00	0.00	70,000.00	28,852.00	0.00%
	Gjithsej	1,474,048.00 €	452,569.78 €	308,433.72 €	1,165,614.28 €	144,136.06 €	68.15%

Shpenzimet - Shendetesi 730

Kodi	Përkrimi	Shuma
11110	Paga-neto	204,048.48
11500	Tatimi në paga	13,244.34
11600	Kontributi i punëtorit	11,677.20
11700	Kontributi i punëdhënsit	11,677.20
11115	Pagesa për sindikat	1,990.43
11125	OIK	500.13
11126	OMK	2,080.00
	Totali i pagave	245,217.78
13210	Shpenzimet e rrymës	7,910.15
13220	Shpenzimet e ujit	899.28
13230	Shpenzimet e mbeturinave	689.07
13430	Shërbime të ndryshme shëndetësore	24,450.00
13460	Shërbime kontraktuese tjera	3,663.90
13509	Pajisje tjera	1,057.20
13610	Furnizim për zyre	1,032.20
13620	Furnizim me ushqim dhe pije	90.70
13630	Furnizime mjeksore	7,674.20
13760	Dru	6,585.00
13780	Derivate veturave	2,099.65
13950	Regjistrim i automjeteve	315.00
14010	Mirembajtja dhe riparim i automjeteve	1,942.00
14040	Mirembajtja e teknologjis informative	140.00
14310	Dreka zyrtare	914.50
14410	Shpenzime - vendime gjykatave	3,753.09
	Totali për shërbime mallra dhe komunali	63,215.94
200	Subvencione dhe Transfera	0.00
	Totali i subvencioneve	0.00
300	Investime kapitale	
	Totali i investimeve kapitale	0.00
	Gjithsej shpenzimet	308,433.72

Kultur rini e sport
Kodi 85033

Pasqyrat e ekzekutimit të buxhetit

Nr	Emërtimi	Buxheti i aprovuar	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	Buxheti i pa shpenzuar	Alokimi i pa shpenzuar	%
1	Kompensimi i të punësuarve	75,404.00	18,526.41	18,526.41	56,877.59	0.00	100.00%
2	Mallra dhe shërbime	51,388.40	21,306.40	7,174.10	44,214.30	14,132.30	33.67%
3	Subvencione	48,000.00	730.92	0.00	48,000.00	730.92	0.00%
4	Komunal	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
	Gjithsej	174,792.40 €	40,563.73 €	25,700.51 €	149,091.89 €	14,863.22 €	63.36%
Shpenzimet e drejtoris për kultur rini e sport 85033							
Kodi	Përshkrimi	Shuma					
11110	Pagat	15,924.93					
11500	Tatimi në paga	792.96					
11600	Kontributi i punëtorit	882.15					
11700	Kontributi i punëdhënsit	882.15					
11115	Sindikata	44.22					
	Totali i pagave	18,526.41					
13130	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit	318.37					
13470	Shërbime teknike	140.00					
13610	Furnizime për zyre	230.00					
13650	Furnizime me veshmbathje	500.00					
14040	Mirëmbajtja e teknologjis informative	420.00					
14230	Shpenzimet për informim publik	902.15					
14310	Drekat zyrtare	1,761.00					
14410	Shpenzime - vendimet e gjykatave	2,902.58					
	Totali për shërbime dhe mallra	7,174.10					
200	Subvencione dhe transfera						
	Totali i subvencioneve	0.00					
300	Investime kapitale	0.00					
	Totali i investimeve kapitale	0.00					
	Gjithsej shpenzimet	25,700.51 €					

Të hyrat buxhetore komunale vetanake të planifikuara dhe të realizuara për periudhën janar-mars 2020

Kodi	Burimet e të hyrave	Planifikimi		Të hyrat e realizuara	Diferenca nga Plani		% tremujore	% Vjetore
		Vjetor	tremujor		Plani tremujor	Plani vjetor		
1.1	Sherbimi i arkivit	3,600.00	900.00	454.00	-446.00	-3,146.00	50.44%	12.61%
1.2	Dokumentet zyrtare ofiqarja	28,800.00	7,200.00	345.00	-6,855.00	-28,455.00	4.79%	1.20%
1.3	Kunorezimi	9,600.00	2,400.00	903.00	-1,497.00	-8,697.00	37.63%	9.41%
1.4	C. te vdekjes	0.00	0.00	36.00	36.00	36.00	#DIV/0!	#DIV/0!
1.5	T.H. tjera ofiqarie	36,000.00	9,000.00	8,201.00	-799.00	-27,799.00	91.12%	22.78%
1.0	Totali i administrates	78,000.00	19,500.00	9,939.00	-9,561.00	-68,061.00	50.97%	12.74%
2.1	Tatimi ne prone	430,000.00	98,000.00	63,901.42	-34,098.58	-366,098.58	65.21%	14.86%
2.2	Regjistrimi i automjeteve	89,500.00	21,000.00	16,190.00	-4,810.00	-73,310.00	77.10%	18.09%
2.3	Te hyrat nga rimbursimi i permbaresit	0.00	0.00	64.90	64.90	64.90	#DIV/0!	#DIV/0!
2.0	Total i buxetit dhe financeve	519,500.00	119,000.00	80,156.32	-38,843.68	-439,343.68	67.36%	15.43%
3.1	Të hyrat qerdhja e fëmive	20,000.00	4,900.00	7,455.00	2,555.00	-12,545.00	152.14%	37.28%
3.2	Të hyrat nga shkollat e mesme	9,000.00	2,250.00	350.00	-1,900.00	-8,650.00	15.56%	3.89%
3.0	Totali i Arsimit	29,000.00	7,150.00	7,805.00	655.00	-21,195.00	109.16%	26.91%
4.1	Të hyrat nga shtepia e kultures	600.00	150.00	0.00	-150.00	-600.00	0.00%	0.00%
4.2	te hyrat nga Arhivi historik	600.00	150.00	0.00	-150.00	-600.00	0.00%	0.00%
4.0	Total i kulturës	1,200.00	300.00	0.00	-300.00	-1,200.00	0.00%	0.00%
5.1	pranimi teknik i lokaleve	2,400.00	600.00	370.00	-230.00	-2,030.00	61.67%	15.42%
5.2	Te hyrat nga Inspektimi	2,400.00	600.00	0.00	-600.00	-2,400.00	0.00%	0.00%
5.3	Shiqim i autotaksive	2,400.00	600.00	190.00	-410.00	-2,210.00	31.67%	7.92%
5.4	Gjambat nga inspeksioni	2,400.00	600.00	100.00	-500.00	-2,300.00	16.67%	4.17%
5.5	Inspektimi hixhienik sanitar	2,400.00	600.00	20.00	-580.00	-2,380.00	3.33%	0.83%
5.0	Total i inspeksionit	12,000.00	3,000.00	680.00	-2,320.00	-11,320.00	22.67%	5.67%
6.1	Plan gjodezik dhe kopjet e planit	30,900.00	6,000.00	4,016.00	-1,984.00	-26,884.00	66.93%	13.00%
6.2	Barlja e pronesise	30,700.00	8,100.00	6,700.50	-1,399.50	-23,999.50	82.72%	21.83%
6.3	Daljet ne teren	18,600.00	4,200.00	3,001.00	-1,199.00	-15,599.00	71.45%	16.13%
6.0	Total i gjeodezisë kad.	80,200.00	18,300.00	13,717.50	-4,582.50	-66,482.50	74.96%	17.10%
7.1	Lejet e Ndërtimit	74,000.00	15,500.00	2,024.90	-13,475.10	-71,975.10	13.06%	2.74%
7.2	Lejet mjedisore	3,600.00	900.00	0.00	-900.00	-3,600.00	0.00%	0.00%
7.3	Lejet e përdorimit	2,400.00	600.00	0.00	-600.00	-2,400.00	0.00%	0.00%
7.0	Totali Urbanizmit	80,000.00	17,000.00	2,024.90	-14,975.10	-77,975.10	11.91%	2.53%
8.1	Participim nga shendetësia	72,000.00	18,000.00	12,962.00	-5,038.00	-59,038.00	72.01%	18.00%
8.2	Të hyrat nga Qiraja objekte shendetesore	8,640.00	2,160.00	1,440.00	-720.00	-7,200.00	66.67%	16.67%

8.3	Te hyrat nga QPS-ja	2,370.00	600.00	890.00	290.00	-1,480.00	148.33%	37.55%
8,0	Totali shëndetësisë dhe shërbime sociale.	83,010.00	20,760.00	15,292.00	-5,468.00	-67,718.00	73.66%	18.42%
9.1	Qiraja nga hapsira publike	13,548.00	3,387.00	626.00	-2,761.00	-12,922.00	18.48%	4.62%
9.2	Reklamat publike	3,000.00	750.00	0.00	-750.00	-3,000.00	0.00%	0.00%
9.3	Parkim Publik	7,700.00	1,800.00	1,844.00	44.00	-5,856.00	102.44%	23.95%
9.4	Shfrytëzimi i hapsires publike	3,600.00	900.00	410.00	490.00	-3,190.00	45.56%	11.39%
9.5	Takse per licenca autotaksive	1,800.00	450.00	0.00	-450.00	-1,800.00	0.00%	0.00%
9.6	Takse komunale per biznes	2,400.00	600.00	0.00	-600.00	-2,400.00	0.00%	0.00%
9.7	Te hyrat nga shitja e asetëve	0.00	0.00	6,320.88	6,320.88	6,320.88	#DIV/0!	#DIV/0!
9,0	Total i shërbimeve publike	32,048.00	7,887.00	9,200.88	1,313.88	-22,847.12	116.66%	28.71%
10.1	Shëndrimi tokës bujqësore në tokë ndërtimore	23,441.00	3,000.00	1,254.25	-1,745.75	-22,186.75	41.81%	5.35%
10.2	çertifikatat për marrje me aktivitetë bujqësore	1,800.00	450.00	30.00	-420.00	-1,770.00	6.67%	1.67%
10.3	Shitja e masave drurorë	8,400.00	2,100.00	0.00	-2,100.00	-8,400.00	0.00%	0.00%
10,0	Total i bujqësisë	33,641.00	5,550.00	1,284.25	-4,265.75	-32,356.75	23.14%	3.82%
11.1	Dënimet e eko së pyjeve			0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!
11.2	Dënimet e gjobave të gjykatës			360.00	360.00	360.00	#DIV/0!	#DIV/0!
11.3	Dënimet e trafikut			31,337.00	31,337.00	31,337.00	#DIV/0!	#DIV/0!
11,0	Totali i të hyrave tjera	0.00	0.00	31,697.00	31,697.00	31,697.00	#DIV/0!	#DIV/0!
Gjithesëjt		948,599.00	218,447.00	171,796.85	-46,650.15	-776,802.15	78.64%	18.11%

Komente:

Të hyrat e planifikuara për periudhën janar - mars 2020 janë.....218,447,00€
Të hyrat e realizuara për periudhën janar mars 2020 janë..... 171,796,85€
Shkalla e realizimit duke u bazuar në planifikimin tremujor është.....78,64%
Të hyrat e planifikuara për vitin 2020 janë.....948,599,00€
Shkalla e realizimit duke u bazuar në planifikimin vjetor është.....18,11%

Te hyrat nga Donacionet per periudhen janar - mars 2020

1	Donacionet nga Unioni European (Turizmi pa kufi)	16,080.44
	Totali i Donacioneve	16,080.44

Krahasimi i të hyrave vetanake në periudhën janar - mars 2020 me të njejtin periudhë të vitit 2019

Nr	Burimet e të hyrave	te hyrat 2019	te hyrat 2020	Diferencat 2020/2019	% e krahasimit 2020/2019
2	Sherbimi i arhivit	198.00	454.00	256.00	229.29%
3	Dokumentet zyrtare (ofiqarjia)	511.00	345.00	-166.00	67.51%
5	Ceremonit martesore	1,028.00	903.00	-125.00	87.84%
6	C. te vdekjes	60.00	36.00	-24.00	60.00%
7	Te hyrat nga zyra e pritjes(T.H. tjera Of.)	10,507.00	8,201.00	-2,306.00	78.05%
	Totali i Administrates	12,304.00	9,939.00	-2,365.00	80.78%
1	Tatimi ne prone	87,684.65	63,901.42	-23,783.23	72.88%
2	Të hyrat nga Rexhistrimi i automjeteve	19,410.00	16,190.00	-3,220.00	83.41%
3	Te hyrat nga rimbursimi i permbauesit	0.00	64.90	64.90	#DIV/0!
	Totali i Buxhetit dhe Financave	107,094.65	80,156.32	-26,938.33	74.85%
1	Te hyrat nga qerdhja e femijeve	4,737.00	7,455.00	2,718.00	157.38%
2	Të hyrat nga shkollat e mesme	290.00	350.00	60.00	120.69%
	Totali i Arsimit	5,027.00	7,805.00	2,778.00	155.26%
1	Te hyrat nga Shtepia e Kultures	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
2	Te hyrat nga Arhivi historik	46.00	0.00	-46.00	0.00%
	Totali i Kultures	46.00	0.00	-46.00	0.00%
1	Lejet e ndertimit	4,820.40	2,024.90	-2,795.50	42.01%
	Totali i Urbanizimit	4,820.40	2,024.90	-2,795.50	42.01%
1	Planet gjeodezik dhe kopjet e planit	4,705.00	4,016.00	-689.00	85.36%
2	Dalje ne teren	3,261.00	3,001.00	-260.00	92.03%
3	Bartje e pronësisë - regjistrimi i pronës	7,072.00	6,700.50	-371.50	94.75%
	Totali i gjeodezise kad.	15,038.00	13,717.50	-1,320.50	91.22%
1	Të hyrat nga shëndetësia primare	15,240.40	12,962.00	-2,278.40	85.05%
2	Të hyrat nga Qeraja objektet shendetesore	1,440.00	1,440.00	0.00	100.00%
3	Te hyrat nga QPS-ja	1,143.00	890.00	-253.00	77.87%
	Totali i shendetesis dhe sherbimeve soc.	17,823.40	15,292.00	-2,531.40	85.80%
1	Inspeksioni i komunikacionit	340.00	190.00	-150.00	55.88%
2	Paranimi teknik i lokaleve	1,795.50	370.00	-1,425.50	20.61%
3	Inspektimi sanitar	80.00	20.00	-60.00	25.00%
4	Te hyrta nga Inspektimi	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
5	Gjobat nga Inspektoriati	50.00	100.00	50.00	200.00%
	Totali i Inspeksionit	2,265.50	680.00	-1,585.50	30.02%
1	Qeraja nga hapsira publike	909.00	626.00	-283.00	68.87%
2	Shfrytëzimi i hapsirës komunale	5,853.75	410.00	-5,443.75	7.00%

3	Licencat për shërbime transportuese	5.00	0.00	-5.00	0.00%
4	Parkimi Publik	1,331.00	1,844.00	513.00	138.54%
5	Reklamata Publike	620.00	0.00	-620.00	0.00%
6	Taks Komunale per biznes	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
7	Te hyrat nga shitja e asetëve	0.00	6,320.88	6,320.88	#DIV/0!
	Totali i shërbimeve publike	8,718.75	9,200.88	482.13	105.53%
1	Shëndrimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore	6,643.00	1,254.25	-5,388.75	18.88%
2	Çertifikatat për marrje me aktivitetë bujqësore	0.00	30.00	30.00	#DIV/0!
3	Shitja e mases drurore	1,366.72	0.00	-1,366.72	0.00%
	Totali i Bujqesise	8,009.72	1,284.25	-6,725.47	16.03%
1	Gjobat e gjykatës	0.00	360.00	360.00	#DIV/0!
2	Gjobat pyjore	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!
3	Dënimet e trafikut	21,885.00	31,337.00	9,452.00	143.19%
	Totali i te hyrave tjera	21,885.00	31,697.00	9,812.00	144.83%
	Totali	203,032.42 €	171,796.85 €	-31,235.57 €	84.62%

Komente

Të hyrat e realizuara për periudhën janar - mars të Vitit 2020 janë 171.796,85€, ndërsa të hyrat e realizuara për periudhën janar - mars të vitit 2019 kanë qenë 203.032,42€

Në periudhën janar-mars të vitit 2020 janë realizuar të hyra me të ulta për 31.235,57€

Krahasimi i të hyrave nga donacionet për periudhën janar - mars 2020 me të njëjtin periudhë të vitit 2019

Nr	Burimet e të hyrave	te hyrat 2019	te hyrat 2020	Diferencat 2020/2019	% e krahasimit 2020/2019
1	Te hyrat nga Donacionet	69,023.00	16,080.44	-52,942.56	23.30%
2				0.00	#DIV/0!
3				0.00	#DIV/0!
	Totali	69,023.00	16,080.44 €	-52,942.56 €	23.30%

Komente:

Te hyrat e realizuara nga donacionet per periudhen janar - mars 2020 jane:

16.080,44€, Ndersa per periudhen janar - mars 2019 te hyrat nga Donacionet kane qene 69.023,00€


Prezentimi Analitik i investimeve për periudhën janar - mars 2020

Përshkrimi i Investimit	Furnitori	Vendi i investimeve	fondi burimor 10	fondi burimor 21	fondi burimor 22	Donacionet	Shuma
1 Ndertimi I trotuarit dhe ndriqimit publik	Kema Company	Terpez, Kabash, Viti, Sedo					
Rritja e punesimit per te rinj	Helvetas	vin, Ramnishite, Verban, Begunic, Pozheran, Slatin	17,195.73				17,195.73
2			5,236.75				5,236.75
Gjithesej			22,432.48	0.00	0.00	0.00	22,432.48 €

Prezentimi i investimeve sipas burimeve të financimit per periudhen janar - mars 2020

1	Grandi qeveritar	22,432.48	100.00%
2	Të hyrat vetanake	0.00	0.00%
3	Të hyrat vetanake te bartura	0.00	0.00%
4	Participim dhe donacionet	0.00	0.00%
	Gjithesejt	22,432.48 €	100.00%


Paraqitja grafike e investimeve sipas burimeve të financimit per periudhen janar - mars 2020



Shpenzimi i buxhetit sipas kategorive ekonomike per periudhen janar - mars 2020

	Kategorit Ekonomike	Alokimet e buxhetit	Shpenzimet	% Shpenzimit
1	Pagat dhe meditje	1,848,425.39	1,847,327.14	99.94%
2	Mallra dhe Sherbime	733,729.62	187,027.29	25.49%
3	Komunali	139,500.00	55,153.15	39.54%
4	Subvencione	17,334.23	7,640.00	44.07%
5	Kapitale	672,995.62	22,432.48	3.33%
	Gjithesejt	3,411,984.86 €	2,119,580.06 €	62.12%

Paraqitja grafike e shpenzimeve sipas kategorive Ekonomike për periudhën janar - mars 2020



Krahasimi i Shpenzimeve në vitin 2020 me të njëjtën periudh të vitit 2019

Kodi Ekonomik	Përshkrimi	Shpenzimet e vitit 2019	Shpenzimet e vitit 2020	Diferenca
11110	Paga neto	1,531,829.67	1,569,636.95	37,807.28
11500	Talimi në paga	88,799.69	91,979.33	3,179.64
11600	Kontributi i punëtorit	85,820.80	87,773.96	1,953.16
11700	Kontributi i punëdhënsit	85,820.80	87,773.96	1,953.16
11115	Pagesa për sindikat	7,514.85	7,582.81	67.96
11125	OIK	515.93	500.13	-15.80
11126	OMK	1,920.00	2,080.00	160.00
	Totali i pagave	1,802,221.74	1,847,327.14	45,105.40
13130	Shpenzimet e udhëtimit mbrenda vendit	7,093.08	3,956.90	-3,136.18
13140	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashte vendit	1,098.80	0.00	-1,098.80
13141	Meditjet e udhëtimit zyrtar jashte vendit	594.67	0.00	-594.67
13210	Shpenzimet e rrymes	49,443.12	48,028.97	-1,414.15
13220	Shpenzimet ujtit	12,494.43	4,566.18	-7,928.25
13230	Shpenzimet e mbeturinave	10,366.13	689.07	-9,677.06
13250	Shpenzimet e telefonise fikse	3,585.85	1,868.93	-1,716.92
13310	Shpenzimet per internet	350.21	0.00	-350.21
13320	Shpenzimet e telefonis mobile	3,621.51	2,831.76	-789.75
13330	Shpenzimet postare	16.90	0.00	-16.90
13430	Sherbime te ndryshme shendetesore	12,176.28	24,450.00	12,273.72
13450	sherbime shtypje - jo marketing	5,844.00	0.00	-5,844.00
13460	Sherbime kontraktuese tjera	18,944.81	20,499.33	1,554.52
13470	Sherbime teknike	640.00	529.50	-110.50
13490	Shpenzimet e varrimit	395.00	0.00	-395.00
13501	Mobilje	422.00	0.00	-422.00
13503	Kompjuter	3,910.00	1,685.00	-2,225.00
13505	Makina fotokopjuese	1,050.00	0.00	-1,050.00
13509	Pajisje tjera	14,447.50	14,842.65	395.15
13610	Furnizime per zyre	9,085.70	7,579.82	-1,505.88
13620	Furnizim me ushqim dhe pije	7,260.00	1,861.27	-5,398.73
13630	Furnizime mjeksore	4,392.50	7,674.20	3,281.70
13640	Furnizime pastrimi	490.30	0.00	-490.30

13650	Furnizim me veshmbathje	1,250.00	500.00	-750.00
13720	Naftë per ngrohje qendrore	430.95	0.00	-430.95
13760	Furnizim me lende djegese (Dru)	17,839.99	16,243.00	-1,596.99
13770	Derivate per xhenerator	272.13	0.00	-272.13
13780	Derivate per vetura	5,079.73	2,155.92	-2,923.81
13950	Regjistrim i automjeteve	970.00	980.00	10.00
13951	Sigurimi i automjeteve	1,426.09	975.24	-450.85
14010	Mirembatja dhe riparimi i automjeteve	8,242.00	2,797.00	-5,445.00
14020	Mirembatja e ndertesave	27,821.42	20,040.98	-7,780.44
14023	Mirembatja e shkollave	1,520.00	0.00	-1,520.00
14032	Mirëmbatja e autorrugëve lokale	26,128.55	16,671.36	-9,457.19
14040	Mirembatja e teknologjise informative	3,229.00	2,550.00	-679.00
14050	Mirembatja e mobiljeve dhe paisjeve	105.00	0.00	-105.00
14060	Mirembatja rutinore(M.ujesjellsave dhe kanalizimeve)	0.00	690.00	690.00
14210	Reklammat dhe konkurset	500.00	0.00	-500.00
14220	Botimet e publikimet	3,100.00	990.00	-2,110.00
14230	Shpenzimet per informim publik	0.00	3,819.45	3,819.45
14310	Dreka zyrtare	7,208.23	4,125.50	-3,082.73
13260	shpenzime - vendime gjyqesore	3,256.75	0.00	-3,256.75
14410	shpenzime - vendime gjyqesore	17,596.73	28,578.41	10,981.68
	Totali për shërbime mallra dhe komunali	293,699.36	242,180.44	-51,518.92
22200	Subvencione dhe transfera	10,440.00	7,640.00	-2,800.00
	Totali i subvencioneve	10,440.00	7,640.00	-2,800.00
31000	Investime Kapitale	119,125.10	22,432.48	-96,692.62
	Totali i investimeve kapitale	119,125.10	22,432.48	-96,692.62
	Gjithsej shpenzimet	2,225,486.20	2,119,580.06	-105,906.14

Komente:

Shpenzimet në vitin 2020 ne total janë 2.119.580,06€, Ndersa Shpenzimet ne vitin 2019 kane qene 2.225.486,20€
Shpenzimet në vitin 2020 janë më të vogla në total për 105.906,14€ në krahasim me të njejtën periudhë të vitit 2019
Në shpenzime janë përfshirë pagat dhe medijet, shërbime mallra dhe shpenzimet komunale, subvencione dhe transfera dhe investime kapitale
Shpenzimet për Paga dhe medijet të vitit 2020 janë më të larta për 45.105,40€ në krahasim me vitin 2019
Shpenzimet për shërbime mallra dhe komunali të vitit 2020 janë më të ulta për 51.518,92€ në krahasim me vitin 2019
Shpenzimet për subvencione dhe transfera të vitit 2020 janë më të ulta për 2.800,00€ në krahasim me shpenzimet e vitit 2019
Shpenzimet për investime kapitale të vitit 2020 janë më të ulta për 96.692,62€ në krahasim me shpenzimet e vitit 2019,



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58, shkronja h) e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 50.1, shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shqyrtimin dhe aprovimin e Draft Strategjisë Komunale kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2020 - 2023

Neni 1

Kryetari i Komunës, i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë, për shqyrtim dhe miratim Draft Strategjisë Komunale kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2020 - 2023

Neni 2

Kjo Strategji ka për qëllim parandalimin e dhunës në familje, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave të dhunës në familje.

Neni 3

Debati publik do të mbahet me datën: 06.01.2020 në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Neni 4

Për zbatimin e kësaj Strategjie, kujdeset Kryetari i Komunës dhe organet tjera kompetente që punojnë në këtë fushë.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

PROPOZUES : KRYETARI KOMUNËS
Sokol Haliti





KOMUNA E VITISË

**DRAFT STRATEGJIA KOMUNALE KUNDËR DHUNËS NË
FAMILJE
2020-2023**

Viti, 2020

Lajmrimi i rasteve të dhunës në familje

Kontakt:



Tel: 0280/381199 – Policia e Kosovës / Viti
0280/381660 – Qendra për Punë Sociale / Viti
112 – Thirrjet emergjente

PËRMBAJTJA

FALENDERIME
SHKURTIME

- KAPITULLI 1: HYRJE PËRMBLEDHËSE
- KAPITULLI 2: QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TE
STRATEGJISË
- KAPITULLI 3: ANALIZA E SITUATËS DHE PROBLEMATIKA E
DHUNËS NË FAMILJE
- KAPITULLI 4: KOHËZGJATJA E ZBATIMIT TË STRATEGJISË DHE
INSTITUCIONET E PËRFSHIRA
- KAPITULLI 5: AKTIVITETET NË ZBATIM TË STRATEGJISË
- KAPITULLI 6: PLANI I MONITORIMIT DHE I VLERËSIMIT TË
PROGRESIT NË ZBATIM
- SHTOJCA 1: PLANI I VEPRIMIT

FALENDERIME

Draft Strategjia Komunale kundër Dhunës në Familje është një prej dokumenteve të rëndësishme të Komunës së Vitisë, hartimi i së cilës ka ndjekur një proces të gjatë diskutimesh dhe kontributesh konkrete të shumë institucioneve relevante që punojnë në këtë fushë. Përfshirja dhe kontributi i tyre kanë dhënë frytin e punës që gjendet në faqet e këtij dokumenti për parandalimin e dhunës në familje në komunën tonë.

Grupi i punës për hartimin e Strategjisë, i përbërë nga përfaqësues të ZBGJ, QKMF, QPS, OJQ-ve, Grupi Grave, Mediat Lokale, Policia e Kosovës, falënderon veçanërisht institucionet komunale për kontributin që ka treguar se vlerëson me prioritet masat për parandalimin e dhunës në familje: Drejtorinë e Arsimit, Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (DSHMS), Drejtorinë e Administratës e dikasterë të tjerë.

SHKURTIME

PK	Policia e Kosovës - Viti
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
QKMF	Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
ZBGJ	Zyrtarja për Barazi Gjinore
ZKK	Zyra Komunale për Komunitete
ZKP	Zyra Komunale për punësim – Viti
GG	Grupi i Grave

KAPITULLI I

HYRJE PËRMBLEDHËSE

Hartimi dhe zbatimi i Strategjisë Komunale dhe Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje për Komunën e Vitisë, mundëson koordinimin e përpjekjeve ekzistuese të të gjitha departamenteve dhe institucioneve qeverisëse komunale dhe të organizatave joqeveritare. Qëllimi i vetëm i këtyre përpjekjeve të përbashkëta është të parandalojë dhe luftojë Dhunën në Familje si dhe të ndihmojë zhvillimin adekuat dhe mirëqenien e të gjithë shoqërisë sonë.

Parandalimi dhe luftimi i Dhunës në Familje kërkon angazhim të strukturave të ndryshme publike dhe private, për të diskutuar dhe zgjidhur çështjet të ndryshme si ato të arsimit, shëndetit, shërbimeve sociale, punësimit, drejtësisë, familjes, fëmijëve dhe të moshuarve, etj. Tërë këto çështje përmbajnë problematika që duhen zgjidhur përmes proceseve të zhvillimit të shoqërisë në tërësi. Strukturat vendimmarrëse, së bashku me organizatat joqeveritare, kanë detyrime në zbatim të kësaj strategjie, të cilat rrjedhin nga funksionet specifike dhe roli që luajnë në shoqëri.

Ky dokument synon të japë ndihmesën e saj në arritjen e standardeve më të larta në trajtimin e çështjeve të Dhunës në Familje, si pjesë e përpjekjeve të Komunës së Vitisë. Kjo strategji i referohet implementimit si dhe zbatimit të kuadrit ligjor kundër dhunës në familje në tërësi, i cili ndër të tjera thekson:

1. Të hartohen politika në nivel lokal për parandalimin, mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat dhe ushtruesit e dhunës në familje.
2. Mbështetja financiare e strehimoreve regjionale që mbështesin nëna me fëmijë, në proporcion me numrin e rasteve nga Komuna e Vitisë të strehuara si viktimat të dhunës në familje

Hartimi i kësaj strategjie është kryer përmes një procesi të gjatë pjesëmarrës, nën drejtimin e Komunës, drejtuesit më të lartë dhe stafet përgjegjëse të drejtorive të ndryshme përfshirë në proces, së bashku me të gjitha institucionet e tjera në nivel komunal. Gjatë muajit Nëntor janë organizuar dhe do të organizohen një sërë takimesh të gjera për njohjen e situatës, hartimin e drejtimeve strategjike dhe planifikimin e aktiviteteve specifike sipas termave kohorë të kësaj strategjie.

KAPITULLI II

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË TË STRATEGJISË KOMUNALE KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

Krahas vështirësive ekonomike, shoqëria jonë po ballafaqohet edhe me një sërë problemesh tjera të papunësisë, të lëvizjeve demografike, të koncepteve të ndryshme mbi vlerat dhe virtytet njerëzore, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e ulët të gruas në vendimmarrje dhe pabarazisë gjinore. Prandaj, Komuna jonë ka nevojë që të hartojmë këtë strategji me anë të së cilës synojmë një shoqëri ku secili respektohet si duhet dhe të jetë në gjendje të realizojë potencialin që ka, pa dhunë dhe diskriminim.

Strategjia komunale kundër Dhunës në Familje për Komunën e Vitisë, synon të:

- Të punojë në parandalimin e dhunës në familje dhe ngritjen e vetëdijes tek komuniteti për aspektet negative të këtij fenomeni;
- Të përmirësojë/ndërtojë sistemin e grumbullimit dhe shkëmbimit të të dhënave në mes të akterëve relevant;
- Të fuqizojë mekanizmat për reagim sa më të shpejtë ndaj rasteve të dhunës në familje dhe të përmirësojë koordinimin në mes anëtarëve të grupit gjatë menaxhimit të tyre;
- Të bëjë avokim dhe monitorim të zbatimit të politikave si dhe të sugjerojë ndryshime bazuar në përvojat më të mira nga terreni.

Fushat e veprimit dhe objektivat strategjike të këtij dokumenti janë:

Fushat e Veprimit A.

ELIMINIMI I PABARAZIVE GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE

Deri në vitin 2023, strategjia komunale synon që të kontribuojë në ndryshimin e qasjes në familje dhe shoqërisë për eliminimin e pabarazisë gjinore dhe dhunën në familje

Fushat e Veprimit B.

ARSIMIMI DHE INFORMIMI

Deri në vitin 2023, strategjia komunale synon një komunitet të mirëinformuar, edukuar në çështjet e dhunës në familje, me profesionistë, të aftë dhe të përgatitur për trajnimin adekuat të viktimave të dhunës në familje dhe të komunitetit në përgjithësi si dhe të kryersve të veprës penale (kryerësit të dhunës)

Fushat e Veprimit C.

FUQIZIMI I BAZËS EKONOMIKE

Deri në vitin 2023, strategjia komunale synon në parandalimin, mbrojtjen dhe rintegrimin përmes mbështetjes ekonomike dhe dhënien e mundësive për mirëqenien e të mbijetuarave

të Dhunës në Familje dhe të familjeve të tyre si dhe kryerësit të veprës penale (kryerësit të dhunës)

Fushat e Veprimit D.

FUQIZIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Deri në vitin 2023, strategjia komunale synon të ketë një koordinim më të mirë për parandalimin, mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe riintegrimin e tyre dhe të familjeve në jëtën ekonomike dhe sociale të komunës.

Çdo objektiv strategjik është zbërthyer më tej në disa objektiva specifike, për të cilat është zhvilluar një plan veprimi i detajuar me aktivitete, institucionet përgjegjëse dhe partnere si dhe vlerësime të tjera që lidhen me afatet kohore të zbatimit, kostot dhe planin e monitorimit.

KAPITULLI III

ANALIZA E SITUATËS DHE PROBLEMATIKA E DHUNËS NË FAMILJE

Dhuna në Familje nuk është një dukuri e re për qytetarët e komunës sonë, por edhe shoqërinë kosovare në përgjithësi. E shprehur në forma dhe intensitete të ndryshme ajo është trashëguar prej së shkuarës, por në ditët e sotme vërehen edhe shumë tipare të reja të shprehjes së saj. Analiza e shkurtër e situatës në Komunën e Vitisë, ka ndihmuar të qartësohet lista e problemeve dhe shkaqeve që i shkaktojnë ato.

Shkaqet që çojnë në rritjen e shkallës së Dhunës në Familje janë të shumta, ndërmjet të cilave përmendim:

Pabarazitë gjinore: Në Kosovë, roli i femrave në proceset e zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe politik është shumë i rëndësishëm, ndonëse ende në ditët e sotme ndeshemi me pabarazi gjinore të dukshme apo të fshehura. Pozita e pabarabartë gjinore ndikohet nga shkalla e ulët e punësimit të grave, vështirësitë që kanë në qasje të shërbimeve shëndetësore, niveli i ulët i integritit të grave në ekonomi dhe numri i vogël i grave në pozitë udhëheqëse në administratën publike.

Në Kosovë është krijuar një bazë e mirë ligjore sa i përket çështjes së barazisë gjinore dhe janë bërë hapa të dukshëm në avancimin e pozitës së grave, ku Komuna e Vitisë, krahas viteve të mëhershme, ka shënuar progres të dukshëm në avancimin e gruas. Të dhënat paraqesin një përfshirje më të madhe të grave në politikë, në arsim, e sektorë të tjerë. Megjithatë, ende nuk është arritur përfaqësimi i kënaqshëm gjinor, i paraparë në Ligjin për Barazi Gjinore, në të cilin përcaktohet se pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve, në institucione apo në nivel të pushtetit, është 50% me 50%.

Duke pasur parasysh trendet e shkallës së papunësisë, për një pjesë të popullsisë në Komunën e Vitisë, femra mbetet në pozitë më të pafavorshme krahasuar me meshkujt si në lëmin e punësimit, nivelit të varfërisë, arsimit, si dhe pjesëmarrjen aktive në sferën publike dhe private.

Pabarazitë gjinore në gjendjen ekonomike: Në Komunën e Vitisë ashtu si në tërë vendin, gjendja e vështirë ekonomike rëndon më shumë mbi femrat, të cilat kanë numrin më të madh të papunësuarve. Për vitin 2019, janë të rexhistruara 470 familje me 1600 anëtarë në skemën e ndihmës sociale, prej tyre 14 familje nga komuniteti pakicë me 51 anëtarë. Nga komuniteti serb janë 6 familje me 21 anëtarë, nga ai ashkalinj 4 familje me 17 anëtarë, nga komuniteti kroat 2 familje me 3 anëtarë si dhe nga ai boshnjak janë 2 familje me 10 anëtarë.

Probleme sociale të lidhura me dhunën në familje: Martesat e hershme janë një ndër dukuritë evidente që prek vajzat dhe djemtë, ndonëse vajzat janë në numër më të madh dhe përballen me pasoja më të shumta. Martesat e hershme privojnë të rinjtë, e sidomos vajzat nga arsimimi dhe zhvillimi i perspektivave afatgjata. Vajzat lindin fëmijë në moshën e tyre më të hershme, mbeten të izoluar nga shoqet, shokët dhe familja e tyre. Gratë e reja nuk fitojnë të ardhura, ndaj mbeten të varura ekonomikisht dhe nuk janë vendimmarrëse në ekonominë familjare. Për këto arsye, këto gra të reja janë më të prekura nga dhuna në familje. Sipas disa të dhënave, numri i rasteve të paraqitura në Qendrën për Punë Sociale (QPS) - Viti për dhënien e pëlqimit për martesë të hershme ndryshon:

viti 2017: Nuk kemi patur raste të martesës së parakoheshme

viti 2018: Nuk kemi patur raste të martesës së parakoheshme

viti 2019: 2 raste të martesës së parakoheshme

Numri i rasteve është dukshëm më i madh, por për shumë prej tyre nuk ka raportime.

Dhuna në Familje sjell shumë pasoja në komunitet, të cilat kanë një numër të madh efektesh të padëshiruara:

Kriza familjare: Avancimi i rolit të femrës në shoqëri dhe pozita e saj në familje ka ndryshuar në kuptimin e pavarësimit më të madh të saj, marrjes së iniciativave, edukimit dhe arsimimit, fakte të cilat kanë ndikuar në ndryshimin e roleve në familje dhe shoqëri. Kriza familjare në periudhën e pas luftës në Kosovë ka shkaqe të ndryshme: lëvizja e popullatës nga fshatrat në qytete, kalimi nga familjet e zgjeruara dhe të mëdha në familje më të vogla. Të tilla ndryshime shihen si faktorë mbrojtës (kur shmanget ndikimi patriarkal prej brezave më të vjetër), por edhe faktorë rreziku njëherësh, si pamundësia e mbrojtjes në rastet e dhunës në familje të nxitura nga papunësia, konfliktet dhe mentalitetin mes gjeneratave, etj.

RRITJA E DIVORCEVE NË SHOQËRI: Numri i divorceve ndryshon nga viti në vit. Në vitin 2017 ka pasur 45 kërkesa për divorc, në vitin 2018 kanë qenë 65 kërkesa, ndërsa në vitin 2019 janë 54 kërkesa. Sa i përket rritjes së numrit të divorceve nga viti në vit, nuk kemi arritur të nxjerrim ndonjë përfundim.

Nga tregues statistikor, numri i rasteve të dhunës në familje të raportuara në QPS për vitin 2017 janë 8 ndaj të cilave është ushtruar dhunë në familje, prej këtyre rasteve 2 janë vendosur në strehimore për mbrojtjen e viktimave. Ndërsa në policia po në vitin 2017 janë trajtuar 21 raste. Në vitin 2018 janë evidentuar 36 raste të dhunës në familje (raste këto të trajtuara nga QPS-ja), ndërsa nga policia 48 raste. Këto raste 2 ishin të vendosura në strehimore për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje. Ndërsa në vitin 2019 është rritur numri. Nga QPS-ja janë të trajtuara 47 viktima. 40 raste nga gjinia femrore dhe 7 raste nga gjinia mashkullore, nga këto raste 1 ka qenë në strehimore. Ndërsa nga Policinë e Kosovës

janë lajmruar 51 raste. Sa i përket keqtrajtimit fizik të dhunës ndaj fëmijëve janë evidentuar 20 raste të keqtrajtimit fizik, nga këto raste 8 janë të gjinisë femrore dhe 12 të gjinisë mashkullore. Raste të ngacmimit seksual në vitin 2019 ka qenë vetëm 1 rast. Janë shqiptuar 6 urdhëra mbrojtës për viktimat e dhunës në familje. Në vitin 2017, strehimorja e Gjilanit ka mbështetur 2 raste të dhunës në familje, prej të cilave 1 rast është me 3 fëmijë, ndërsa për vitin 2018 në strehimoren e Gjilanit “ Liria” janë të strehuara 2 raste. Meqenëse në disa raste është arritur zgjidhje dhe tejkalim i problemeve falë ndërmjetësimit të Qendrës për Punë Sociale, ku viktimat e dhunës janë rikthyer në shtëpitë e tyre, disa raste tjera kanë mbetur ende pa zgjidhje, pasi që qëndrimi në strehimoren regjionale “ Liria” është i përkohshëm, deri në 6 muaj, por në strehimoren “ Liria” në Gjilan, ndodh që për ndonjë rast më specifik strehimi ti vazhdohet deri në 1 vit por, varësisht nga rasti ndodh që edhe deri në dy vite. Viktimat e dhunës në familje, pas qëndrimit gjashtëmujor transferohen në strehimoret tjera (në regjionet tjera të Republikës së Kosovës), ku në çdo strehimore qëndrimi i tyre zgjat jo më tepër se gjashtë muaj. Mandej këto viktimat të dhunës, nuk kanë zgjidhje tjetër, ose të kthehen në shtëpinë e gjinisë së tyre, ku shpeshherë ndodh që mos ti pranojnë edhe ato, ose të kthehen sërish tek kryerësi i cili ka ushtruar dhunë ndaj tyre, pasi që nuk mund të bëjnë zgjidhje tjetër.

Krahas numrit të raportuar, rastet e dhunës në familje mbeten më tepër raste të izoluara dhe shumë pak të raportuara. Nga ndryshimet e statistikave nga viti në vit, vërehet se ka një rritje të raportimit të rasteve të dhunës në familje në institucionet gjegjëse, që na bënë të kuptojmë se është rritur dukshëm vetëdijësimi qytetar për të raportuar dhunën krahasuar me periudhat e mëhershme, por njëkohësisht është rritur edhe besimi qytetar në institucionet që luftojnë këtë fenomen.

Viktima të dhunës në familje, marrë për bazë statistikën e vitit 2017, 2018 dhe 2019, kryesisht janë nga gjinia femërore.

Frika dhe ndërgjegjësimi ulët për çështjet e dhunës në familje: Mos raportimi i dhunës në familje nga viktimat është ndër fenomenet më të shpeshta, pasi konsiderohet turp dhe një çështje që nuk duhet të dalë jashtë mureve të shtëpisë.

Mospranimi i dhunës seksuale: Për shkak të stigmës dhe ndëshkimit vërehet mos raportim i dhunës nga ana e viktimave dhe për këtë dhuna seksuale rezulton më pak e raportuar ose nuk ekziston fare në krahasim me dhunën fizike.

Probleme lidhur me trashëgiminë: Sa i përket procedurave të shqyrtimit të trashëgimisë, shumë herë ndodh që gruaja nuk njoftohet fare ose përjashtohet nga diskutimi për masën trashëgimore, qoftë në pozitën e bashkëshortes, nënës apo motrës dhe në këtë mënyrë diskriminohet. Veç kësaj, organi kompetent komunal për mbajtjen e librit amzë të vdekjeve ka për detyrë që në aktvdekje të shënojë emrat e trashëgimtarëve femra dhe meshkuj dhe asesi të mos i diskriminojë femrat.

KAPITULLI 4:

KOHËZGJATJA E ZBATIMIT TË STRATEGJISË DHE INSTITUCIONET E PËRFSHIRA

Shtrirja kohore e strategjisë

DRAFT STRATEGJIA KOMUNALE KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

Strategjia Komunale kundër Dhunës në Familje është paraparë si një strategji 4 vjeçare që do të zbatohet në periudhën 2020-2023.

Institucionet zbatuese dhe partnere

Komuna Viti: Institucioni kryesor zbatues për strategjinë është Komuna e Vitisë me dikasterët e saj (ZBGJ, QPS, QKMF, DKA), Policia e Kosovës, Prokuroria dhe Gjykatat

Ndër institucionet e tjera të përfshira në zbatimin e elementeve të caktuara të kësaj strategjie janë dhe më kryesoret, janë:

Policia e Kosovës, Prokuroria dhe Gjykatat

Ndërsa si institucione që mund të indihmojnë në parandalimin e dhunës në familje, dhe mbrojtjen e viktimave, janë:

Ekipa Vepruese për Siguri në Bashkësi – EVSB, Këshilli i Veprimit Rinor Lokal, OJQ-të

Zyra për Punësim: Në koordinim me Qendrën për Punë Sociale, regjistron dhe evidenton personat, të cilët lajmërohen në zyrë, ndaj të cilëve është ushtruar dhunë në familje. Këtyre personave në cilësi të punëkërkesve, ju ofrohet: këshillim profesional, informim mbi mundësitë e punësimit, përgatitje dhe ndërmjetësim në punësim, informim për aftësim dhe riaftësim profesional me qëllim përgatitjen për nevojat e tregut të punës.

Mbrojtësi i viktimave i cili bashkëpunon ngushtë me institucionet e tjera që ofrojnë ndihmë për viktimat e Dhunës në Familje, dhe lloje të tjera të dhunës apo trafikimit me qenieve njerëzore, etj si Policinë, QPS, Prokurorinë, Gjykatën, QKMF, strehimoren, etj. Ndër detyrat e tij është të informojë viktimën për të drejtat ligjore, të parapara sipas ligjeve në fuqi për dhunën në familje, të parapërgatitë viktimën për seancat gjyqësore, e shoqëron gjatë seancave si në Prokurori dhe Gjykatë, etj.

Zyra për Ndihmë Juridike falas

Kjo zyrë është regjionale, e cila gjendet në Gjilan dhe ofron ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës.

KAPITULLI 5:

AKTIVITETET NË ZBATIM TË STRATEGJISË

(Plani i Veprimit të kësaj Strategjie gjendet i bashkëlidhur në Shtojcën 1)

Arritja e objektivave strategjike të kësaj Strategjie është paraparë të kryhet përmes zbërthimit të tyre në disa objektiva specifike me aktivitetet përkatëse.

Aktivitetet në planin e veprimit janë renditur sipas tre shtyllave bazë të përcaktuara edhe në Planin e Veprimit të Kosovës: Parandalim, Mbrojtje dhe Riintegrim. Për arritjen e objektivave të kësaj Strategjie, aktivitetet janë specifikuar edhe sipas prioritetit për zbatim:

Afat Shkurtra: aktivitete të rëndësisë së lartë që duhet të zbatohen brenda një afati kohor të shkurtër 6 muaj – 1 vit. Të tilla mund të jenë ngritja dhe forcimi institucional për adresimin e Dhunës në Familje, çështje që lidhen me forcimin e mbrojtjes, etj

Afat Mesme: aktivitete të rëndësishme që duhet zbatohen brenda periudhës kohore 1-2 vjeçare. Ndër aktivitete të tilla mund të jenë edhe ato që kërkojnë fonde, të cilat duhet të sigurohen nga institucionet gjegjëse për implementimin e kësaj strategjie.

Afat Gjata: janë renditur të gjitha aktivitetet të cilat synojnë konsolidimin dhe qëndrueshmërinë afat gjatë të mbështetjes që u jepet të mbijetuarave prej Dhunës në Familje, shërbimeve cilësore, etj

Aktivite në vijimësi: janë aktivitete, të cilat do të kryhen prej institucioneve zbatuese dhe atyre partnere në vijimësi, si pjesë e punës së tyre. Ndër to mund të përmendim aktivitetet që kanë të bëjnë me parandalimin, informimin dhe vetëdijësimin e komunitetit.

Objektivat specifike dhe disa prej aktiviteteve të planifikuara në Planin e Veprimit renditen si më poshtë:

FUSHA E VEPRIMIT –

A. ELIMINIMI I PABARAZIVE GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE

Objektiv Specifik A.1.

Eliminimi i stereotipeve gjinore për luftimin e dhunës në familje:

Aktivite:

- Fushata vetëdijësuese dhe kampanja informuese mediatike për publikun e gjerë në komunën e Vitisë
- Trajnimet për barazi gjinore dhe dhunën në familje me përfaqësues të institucioneve komunale

Objektiv Specifik A.2.

Ngritja e vetëdijësimit të grave dhe të rinjve, institucioneve dhe OJQ-ve për pasojat e dhunës në familje dhe të pabarazive gjinore.

Aktivite:

- Fushata (drama me temë të barazisë gjinore dhe dhunës në familje , ligjërata, ese, dhe piktura me të rinjtë dhe grupe të ndryshme të interesit)

- Takime me gra dhe vajza në fshatra për të drejtat e tyre ligjore, me fokus në Dhunën në Familje. Gjatë takimeve do të shpërndahen informacione dhe fletëpalosje
- Debate të hapura dhe emisione televizive me tematika rreth Dhunës në Familje, me përfaqësues të institucioneve dhe të OJQ-ve

Objektiv Specifik A.3.

Fuqizimi i rolit të gruas në shoqëri përmes promovimit dhe rritjes së numrit të femrave në pozicionet vendimmarrëse

Aktivitete:

- Ndarja e përvojave të suksesshme të grave në pozita udhëheqëse gjatë takimeve me gratë dhe komunitetin

**FUSHA E VEPRIMIT –
B. ARSIMIMI DHE INFORMIMI**

Objektiv Specifik B.1:

Ndërgjegjësimi i nxënësve dhe prindërve të Arsimit të Mesëm të Ulët dhe Arsimit të Mesëm të Lartë për çështjet e Dhunës në Familje dhe LMDHF

Aktivitete:

- Aktivitete informuese nëpërmjet mekanizmit koordinues, në kuadër të orëve mësimore dhe të fletëpalosjeve, broshurave, etj
- Informimi i prindërve për mekanizmin koordinues nëpërmjet zyrtarëve të arsimit
- Aktivitete informuese dhe edukuese në kuadër të programit të aktiviteteve shkollore me pjesëmarrjen e nxënësve (orë mësimore, fushata, fletëpalosje)

Objektiv Specifik B.2:

Ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve të edukatës qytetare lidhur me Dhunën në Familje dhe trajtimin e saj

Aktivitete:

- Organizimi i trajnimeve të mësimdhënësve të edukatës qytetare për çështje të Dhunës në Familje
- Organizimi i shkëmbimit të përvojave përmes vizitave studimore të specialistëve të kësaj fushe

Objektiv Specifik B.3:

Ulja e numrit të nxënësve që braktisin shkollën e mesme të ulët dhe të lartë si rezultat i Dhunës në Familje, në zonat rurale apo lokalitete urbane

Aktivitete:

- Kryerja e hulumtimeve sociologjike mbi shkaqet kryesore të braktisjes së shkollës prej nxënësve
- Vetëdijesimi nëpërmjet liderëve të komuniteteve dhe ndërmjetësuesve përmes takimeve dhe punës me familje të veçanta që shfaqin probleme të Dhunës në Familje
- Aplikimi i masave ligjore që sanksionojnë braktisjen e shkollës

FUSHA E VEPRIMIT –

C: FUQIZIMI I BAZËS EKONOMIKE

Objektiv Specifik C.1:

Fuqizimi ekonomik i viktimave të dhunës në familje në përkrahjen për punësim dhe vetëpunësim

Aktivitete:

- Regjistrimi, evidentimi dhe orientimi i viktimave të Dhunës në Familje
- Ofrimi i këshillave në prezantimin e dokumentacionit për aplikim të suksesshëm sipas tregut të punës
- Hartimi i kuadrit nënligjor, përmes nxjerrjes së një vendimi në nivel komunal, për lirim nga taksat komunale për rastet e dhunës në familje në rastet e hapjes së një biznesi të ri

Objektiv Specifik C.2:

Mbështetje socio-ekonomike të mbijetuarve të Dhunës në Familje

Aktivitete:

- Ofrimi i trajnimeve për ngritjen profesionale, informacioneve për mundësitë për biznes
- Ofrimin e mbështetjes ekonomike me fond të veçantë prej komunës
- Ndarja e subvencioneve për familjet në zonën rurale përmes ndarjes subvencioneve për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore
- Përkrahje e strehimores regjionale për kryerjen e shërbimeve dhe mbështetjen e të mbijetuarve të Dhunës në Familje si dhe bashkëpunimi me mekanizmat që merren me çështjet e dhunës në familje

Objektiv Specifik C.3:

Zgjidhje e strehimit për rastet e të mbijetuarve të Dhunës në Familje

Aktivitete:

- Ofrimin e mbështetjes ekonomike përmes pagesës së qirasë për rastet e pazgjidhura

FUSHA E VEPRIMIT –

D: FUQIZIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Objektiv Specifik D.1:

Fuqizimi i Mekanizmit koordinues në nivel të komunës

Aktivite:

- Takime me strukturat udhëheqëse të komunës për qartësimin e roleve dhe përgjegjësi
- Takime periodike të Mekanizmit Koordinues për shkëmbim informacioni dhe koordinim aktivitetesh.

Objektiv Specifik D.2:

Rritja e vetëdijes për identifikimin sa më të hershëm të situatave të rrezikut për Dhunën në Familje prej secilit institucion dhe planifikimin e masave parandaluese

Aktivite:

- Identifikimi i rasteve të dhunës në Familje
- Regjistrimi në databazë dhe vlerësimi i nevojave të mbijetuarve të Dhunës në Familje.

KAPITULLI 6

PLANI I MONITORIMIT DHE I VLERËSIMIT TË PROGRESIT NË ZBATIM

Për monitorim dhe zbatimin të kësaj strategjie obligohet Komuna e Vitisë dhe dikasterët tjerë të përmendur në këtë dokument..

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të saj si dhe ato partnere duhet të informojnë në mënyrë të rregullt Zyrën e Kryetarit - me anë të të dhënave mbi arritjen e objektivave dhe realizimin e aktiviteteve të përcaktuara.

DRAFT STRATEGJIA KOMUNALE KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

Të paktën një herë në vit, Kryetari i Komunës raporton në Kuvendin e Komunës mbi progresin në zbatimin e strategjisë sipas treguesve të përcaktuar për çdo drejtim strategjik.

SHTOJCA 1: PLANI I VEPRIMIT



Komuna e Vitisë

PLANI I VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN E DHUNËS NË FAMILJE (2020 – 2023)

FUSHA E VEPRIMIT – A. ELIMINIMI I PABARAZIVE GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE Deri në vitin 2023, strategjia lokale synon të ndryshojë qasjen në familje dhe shoqëri për eliminimin e pabarazisë gjinore dhe dhunën në familje				
Drejtimi strategjik	Aktivitete	Koha e zbatimit Sipas shtyllave: Parandalim, Mbrojtje, Riintegrim Sipas kohës së zbatimit: ASH – Afat shkurtër, AM – Afat Mesëm; AGJ – Afat Gjatë	Indikator i suksesit	Institucion et përgjegjës e për zbatim
A.1. Eliminimi i stereotipeve gjinore për luftimin e dhunës në familje	1.1 Fushata vetëdijësuese dhe kampanja informuese mediatike për publikun e gjerë në komunën e Vitisë 1.2 Trajnimet për Barazi gjinore dhe dhunën në familje me përfaqësues të institucioneve vendore	P+M+R ASH+AM P+M+R ASH	Prej rreth 46786 banorëve , rreth 35% e tyre kanë marrë mesazhin dhe janë bërë pjesë e aktiviteteve ndërgjegjësuese	Institucioni Përgjegjës: QPS, Policia, EVSB Institucione Partnere: Komuna OJQ-te Media lokale
A.2. Ngritja e vetëdijësimit të grave dhe të rinjve , institucioneve dhe	2.1 Fushata (drama, me temë të barazisë gjinore dhe dhunës në familje , ligjërata, ese, dhe piktura) me të rinjtë	P Aktivitet në vijimësi	Rritja e përqindjes së grave dhe vajzave të ndërgjegjësuar	Institucioni Përgjegjës: OJQ-te

<p>bizneseve për pasojat e dhunës në familje dhe të pabarazisë gjinore</p>	<p>2.2 Takime me gra dhe vajza në fshatra për të drejtat e tyre ligjore, me fokus në DHF. Gjatë takimeve do të shpërndahen informacione dhe fletëpalosje</p> <p>2.3 Debate të hapura dhe emisione televizive me tematika rreth DHF, me përfaqësues të institucioneve dhe të bizneseve.</p>	<p>P</p> <p>Aktivitet në vijimësi</p> <p>P+M+R</p> <p>Aktivitet në vijimësi</p>	<p>nga 40% në 55%</p>	<p>Institucione Partnere: Komuna Bizneset Donatorë</p>
<p>A.3. Fuqizimi i rolit të gruas në shoqëri përmes promovimit dhe rritjes së numrit të femrave në pozicionet vendimmarrëse</p>	<p>3.1 Ndarja e përvojave të suksesshme të modeleve në takime me gratë dhe komunitetin</p>	<p>P</p> <p>AGJ</p>	<p>Rritja e përqindjes së grave pjesëmarrëse aktive në takime</p> <p>Rritja e përqindjes së grave në pozicionet vendimmarrëse nga 30% në 45%</p>	<p>Institucioni Përgjegjës: OJQ lokale</p> <p>Institucione Partner: MK, grupi i grave asambleiste</p>

FUSHA E VEPRIMIT – B. ARSIMIMI DHE INFORMIMI

Deri në vitin 2023, strategjia lokale synon një komunitet të mirëinformuar, edukuar në çështjet e dhunës në familje, me profesionistë të përgatitur për të parandaluar, njohur dhe kualifikuar për trajtimin adekuat të viktimave të dhunës në familje dhe të komunitetit në tërësi si dhe të kryerësve të veprave penale

Drejtimi strategjik	Aktivitete	Lidhja me Strategjinë Kombëtare dhe Koha e zbatimit	Indikator i suksesit	Institucionet përgjegjëse për zbatim
B.1 Ndërgjegjësimi i nxënësve dhe prindërve të AMU dhe AML për çështjet e DHF dhe LMDF	<p>1.1 Aktivitete informuese nëpërmjet mekanizmit kordinues, në kuadër të orëve mësimore dhe të fletëpalosjeve, broshurave, etj</p>	<p>P+M+R</p> <p>Aktivitet në vijimësi</p>	<p>Deri në vitin 2023, rreth 50% e nxënësve dhe prindërve janë të ndërgjegjësuar për LMDF dhe DHF</p>	<p>Institucioni Përgjegjës: Mekanizmi kordinues Institucione Partner: Drejtoria e arsimit, OJQ të</p>
	<p>1.2 Informimi i prindërve për mekanizmin kordinues nëpërmjet zyrtarëve të arsimit</p>	<p>P</p> <p>Aktivitet në vijimësi</p>		

	<p>1.3 Aktivitete informuese dhe edukuese në kuadër të programit të aktiviteteve shkollore me pjesëmarrjen e nxënësve (orë mësimore, fushata, postera)</p>	<p>P ASH + AM</p>	
<p>B.2 Ngritja profesionale e mësimitdhënësve të edukatës qytetare lidhur me DHF dhe trajtimin e saj</p>	<p>2.1 Organizimi i trajnimeve të mësimitdhënësve të edukatës qytetare për çështje të DHF</p>	<p>P Aktivitet në vijimësi</p>	<p>Deri në vitin 2023, 25% e orëve të edukatës qytetare do të kalojnë në tematika të DHF</p>
	<p>2.2 Ngritja e qendrave didaktike të integruara me programe të vecanta për trajnimin mbi çështje të DHF</p>	<p>P AM</p>	<p>Institucioni Përgjegjës: Drejtoria e Arsimit Institucione Partner: OJQ</p>
	<p>2.3 Organizimi i vizitave studimore për shkëmbimin e përvojave me vendet e rajonit</p>	<p>P AM</p>	

B.3 Ulja e numrit të nxënësve që braktisin shkollën e ulët dhe të lartë si rezultat i DHF, në zonat rurale apo komunitete të ndryshme	3.1 Kryerja e hulumtimeve sociologjike mbi shkaqet kryesore të braktisjes së shkollës prej nxënësve të familjeve ku ushtrohet dhunë	P+M+R ASH	Deri në vitin 2023, uljet numri i nxënësve që braktisin shkollën prej DHF	Institucioni Pergjegjës: Drejtoria e Arsimit
	3.2 Vetëdijësimi nëpërmjet lidërëve të komuniteteve dhe ndërmjetësuesve përmes takimeve dhe punës me familje të vecanta që shfaqin probleme të DHF	P+M+R ASH+AM		
	3.3 Monitorimi i aplikimit të masave ligjore që sanksionojnë braktisjen e shkollës	P+M ASH+AM		

FUSHA E VEPRIMIT – C. FUQIZIMI I BAZËS EKONOMIKE

Deri në vitin 2023, strategjia lokale synon në parandalimin, mbrojtjen dhe rinteprimin përmes mbështetjes ekonomike dhe dhënien e mundësive për mirëqënien e të mbijetuarave të DHF dhe të familjeve të tyre si dhe kryerësve të veprës penale

Drejtimi strategjik	Aktivitete	Lidhja me Strategjinë Kombëtare dhe Koha e zbatimit	Indikator i suksesit	Institucionet përgjegjëse për zbatim
C.1 Fuqizimi ekonomik i viktimave të dhunës në familje në përkrahjen për punësim dhe vetëpunësim	<p>1.1 Rregjistrimi, evidentimi dhe orientimi i viktimave të DHF pranë komunës</p> <p>1.2 Ofrimi i këshillave në prezantimin e dokumentacionit për aplikim të suksesshëm sipas tregut të punës</p> <p>1.3 Hartimi dhe aprovimi normave rregullative, përmes krijimit të politikave, për lirin nga taksat komunale në rastet e hapjes së një biznesi të ri</p>	<p>Sipas shtyllave: Parandalim, Mbrojtje, Riinteprim</p> <p>Sipas kohës së zbatimit: ASH – Afatshkurtër, AM – AfatMesëm; AGJ – Afat Gjatë</p> <p>M+R</p> <p>AM</p> <p>M+R</p> <p>Aktivitet në vijimësi</p> <p>M+R</p> <p>ASH</p>	Brenda 5 viteve sistemi i regjistrimit dhe orientimit bëhet funksional sipas standardeve kombëtare në përpunim	<p>Institucioni Përgjegjës: Komuna</p> <p>Institucione Partner: Sipas përcaktimit të standartit kombëtar</p>

2. Mbështetje socio ekonomike të mbijetuarave të DHF	2.1 Ofrimi i trajnimeve për ngritjen profesionale, informacioneve për mundësitë për biznes	M+R Aktivitet në vijimësi	25% e viktimave nga këto shërbimet në këtë kategori	Institucioni Përgjegjës: komuna Institucione Partner: Donatorët,
	2.2 Ofrimin e mbështetjes ekonomike me fond të vecantë prej komunës	M+R AM		
	2.3 Ndajja e subvencioneve për familjet në zonën rurale përmes ndarjes së farërave pranverore dhe vjeshtore	P+M+R AM		
	2.4 Përkrahje e strehimore "LIRIA" për kryerjen e shërbimeve dhe mbështetjen e të mbijetuarave të DHF	M+R Aktivitet në vijimësi		
3. Zgjidhje afatmesme e strehimit për rastet e të mbijetuarave të DHF	3.1 Pagesa e qirasë për vendstrehimin e viktimave të dhunës në familje	M+R Aktivitet në vijimësi		Institucioni Përgjegjës: Komuna Institucione Partner: Donatorë
	3.2 Ofrimin e mbështetjes ekonomike përmes pagesës së qerasë për rastet e pazgjedhura	M+R AM		

FUSHA E VEPRIMIT – D. FUQIZIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Deri në vitin 2023, strategjia lokale synon të ketë institucione funksionale dhe të mirëkordinuara për parandalimin, mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe riintegrimin e tyre dhe të familjeve në jetën ekonomike dhe sociale të komunës.

Drejtimi strategjik	Aktivitete	Lidhja me Strategjinë Kombëtare dhe Koha e zbatimit	Indikatori i suksesit	Institucionet përgjegjëse për zbatim
D.1 Institucionalizimi i Mekanizmit kordinues në nivel të komunës	<p>1.1 Takime me strukturat udhëheqëse të komunës për qartësimin e roleve dhe përgjegjësi</p> <p>1.2 Takime periodike të Mekanizmit Kordinues për shkëmbim informacioni dhe kordinimin e veprimeve konkrete..</p>	<p>P+M+R</p> <p>ASH</p> <p>P+M+R</p> <p>Aktivitet në vijimësi</p>	Të paktën 4 takime të organizuara cdo vit	Institucioni Përgjegjës: MK
D.2 Rritja e vetëdijes për identifikimin sa më të hershëm të situatave të rrezikut për DHF prej secilit institucion dhe planifikimin e	2.1 Hartimi i formularëve të posacëm për raportimin e rasteve të rrezikut për DHF dhe rasteve të identifikuar	P+M ASH	Deri në fund të vitit 2023 institucionet e komunës do të kenë të ngritur sistemin e identifikimit, regjistrimit dhe	Institucioni Përgjegjës: MK Institucione

masave parandaluese	2.3 Identifikimi i shkaqeve që paraprijnë rastet e DHF përmes analizimit me anë të anketimeve në shkollë, institucione shëndetësore, diskutimeve me mediatike me specialistë	P+M AGJ	vlerësimi të rasteve të DHF.	Partner: OJQ, shkolla
			Të dhënat për shkaqet dhe situatën janë të mbledhura në bazë periodike	
	2.4 Planifikim i punës dhe mbështetjes institucionale për grupet më vulnerabel për DHF (përfshirë pleqtë, të rinjtë dhe njerëzit me nevoja të vecanta)	P+M+R AGJ	Numri i raste të ndihmuara/rehabilituara	

09-03-2020
02-035/02-248



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË • OPŠTINA VITINA • MUNICIPALITY OF VITI



**DRAFT RREGULLORE KOMUNALE PËR
TRANSPARENCË**

Në bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja c) lidhur me nenin 58, paragrafi 1, shkronja h) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 10 paragrafit 2, pika 2.2, nenit 23 dhe 25 të Statutit të Komunës së Vitisë me nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna, dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna dhe duke u bazuar në kërkesën e MAPL-së për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të komunës së Vitisë të datës: 19.02.2020 me numër të protokollit 0-96/1, Kryetari i Komunës së Vitisë, Sokol Haliti i propozon Kuvendit të Komunës të miratoj këtë:

PROPOZIM RREGULLORE KOMUNALE PËR TRANSPARENCË

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Më këtë Propozim Rregullorë synohet që të arrihet:

1. Forcimi i transparencës në punën e organeve të Komunës: Kuvendit të Komunës, Kryetarit të Komunës, organeve të Administratës: drejtorive komunale, institucioneve arsimore dhe shëndetësore, punës së ndërmarrjeve publike komunale dhe rritjes së pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivel lokal;
2. Zbatimi i ligjit dhe praktikave më të mira administrative për qasje në dokumente publike.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Kjo Propozim Rregullorë, rregullon pjesëmarrjen e publikut në mbledhjen e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, obligimin për njoftim publik, konsultimet lidhur me aktet komunale, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe qasjen në dokumentet zyrtare të Komunës

Neni 3 Përkufizimet

1. Në hartimin e kësaj Propozim Rregullorë janë përdorur përkufizimet e mëposhtme:
2. **“Mbledhjet e Kuvendit të Komunës”** - nënkupton mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës;
3. **“Komitetet”** - nënkupton trupa ndihmëse që i ndihmojnë Kuvendit në përmbushjen e përgjegjësisë të

caktuara me LVL-në dhe me Statutin e Komunës;

4. **“Pjesëmarrja e publikut”** - nënkupton pjesëmarrjen e qytetarëve, OJQ-ve, etj..., në vendimmarrje;
5. **“Njoftimi i publikut”** - nënkupton njoftimin e publikuar në tabelën e shpalljeve në ndërtesën e Komunës, publikimin e njoftimeve në gazetatat e përditshme, medie lokale dhe ueb faqe të komunës për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit, komiteteve dhe organeve administrative, institucioneve arsimore, shëndetësore dhe ndërmarrjeve publike lokale;
6. **“Tubime publike”** - nënkupton tubimet e organizuara nga Komuna, administrata – drejtoritë, njësitë/zyrat dhe ndërmarrjet publike lokale, me qëllim të njoftimit për punën e bërë apo dhënien e propozimeve;
7. **“Peticioni”** - nënkupton kërkesën që i adresohet Komunës, konform përgjegjësisë së saj;
8. **“Konsultim publik i akteve komunale”** - nënkupton seancën dëgjimore dhe marrjen e propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të publikut para miratimit të aktit;
9. **“Qasja në dokumentet zyrtare”**- nënkupton shikimin dhe ofrimin e dokumenteve zyrtare të Komunës, në pajtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

Neni 4

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

1. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës janë të hapura për publikun, shoqërinë civile dhe përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.
2. Kuvendi i Komunës njofton publikun për mbajtjen e mbledhjeve përmes Zyrës për Marrëdhënie me Publikun, të paktën 7 ditë pune para mbledhjeve të rregullta, ose 3 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme dhe brenda ditës për mbledhjet urgjente.
3. Njoftimi publik bëhet përmes:
 - medieve të shkruara, elektronike, medieve sociale dhe
 - ueb-faqes së Komunës.
4. Njoftimi me shkrim për publikun përmban: (i) datën e mbajtjes së mbledhjes, (ii) kohën e mbajtjes së mbledhjes, (iii) vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe (iv) rendin e ditës të caktuar për atë mbledhje.
5. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës mund të jenë të mbyllura pjesërisht ose tërësisht, vetëm për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Në këto raste, me vendim të arsyetuar, Kuvendi i Komunës, i shpall mbledhjet pjesërisht ose tërësisht të mbyllura për publikun.
6. Aktet normative të komunës hyjnë në fuqi shatë (7) ditë pas publikimit të aktit në ueb-faqen zyrtare të komunës, përveç nëse me vetë aktin nuk është përcaktuar ndryshe.
7. Rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të Komunës publikohen në ueb-faqen e Komunës së Vitisë.
8. Transmetimi në ueb faqe të Komunës i seancave të KK-së, në bazë të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna.

Neni 5

Mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetet tjera

1. Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe komitetet tjera janë të hapura për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.
2. Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe komitetet tjera mund të jenë të mbyllura për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Vendimin për këtë e merr kryesuesi i mbledhjes.
 - a. Kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit të Komunës ose Komitetit përkatës, nëpërmes Zyrtarit për Informim, njofton publikun së paku shatë (7) ditë pune para mbledhjeve të rregullta dhe tre (3) ditë pune para mbledhjeve të jashtëzakonshme. Njoftimi duhet të përmbajë: datën e mbajtjes së mbledhjes, kohën e mbajtjes së mbledhjes, vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe rendin e ditës të caktuar për atë mbledhje.
 - b. Të gjitha propozimet e komiteteve, publikimi i të cilave nuk kufizohet nga legjislacioni në fuqi për qasje në dokumentet publike, duhet të jenë në dispozicion për publikun sipas kërkesës.

Neni 6

Peticioni

1. Secili qytetar dhe person juridik që ka interes në Komunë, ka të drejtë që, me vetiniciativë, përmes formës së peticionit, t'i propozojë Kuvendit të Komunës nxjerrjen e akteve juridike, me të cilat do të zgjidheshin çështjet e rëndësishme për qytetarët e komunës.
2. Subjektet e përmendura më lartë, mund t'i drejtojnë peticion Kuvendit të Komunës për çështjet që janë në kompetencën e tij, në mënyrë të pakufizuar, e që kanë të bëjnë me:
 - rregullimin e qytetit,
 - mirëmbajtjen e rendit dhe të infrastrukturës së komunës - qytetit,
 - urbanizimin e qytetit dhe të fshatit,
 - mirëmbajtjen e mjedisit jetësor,
 - zbatimin e vetëkontrollit dhe
 - çështje të tjera të rëndësishme për jetën e qytetarëve.
3. Një iniciativë e tillë e subjekteve fillon me nënshkrimin e tyre në formë të peticionit, me propozim të veçantë të çështjes së caktuar, dhe i drejtohet Kuvendit të Komunës përmes zyrës së drejtorit të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme.
4. Kuvendi i Komunës mund të delegojë shqyrtimin e peticioneve të tilla në komitetet e përhershme.
5. Kur një peticion nënshkruhet nga më shumë se 10% e qytetarëve të regjistruar në listën e votuesve, e që ka të bëjë me çështjet që janë të lidhura me qytetin, Kuvendi i Komunës duhet ta shqyrtojë çështjen. Për çështjet që kanë të bëjnë me fshatra apo lagje të caktuara, peticioni duhet të shqyrtohet nga Kuvendi i Komunës, nëse atë e nënshkruajnë së paku 10% e qytetarëve të regjistruar në listën e votuesve, banorë të atij fshati apo të asaj lagjeje.
6. Nëse një fshat, vendbanim apo lagje që, ka më pak se 4 500 banorë të regjistruar në listat e votuesve, peticioni do të jetë i vlefshëm nëse atë e nënshkruajnë 20 % e banorëve të regjistruar në regjistrat e votuesve.
7. Çdo peticion duhet të përmbajë emrin dhe adresën e parashtrues/it-ve, emrin dhe adresën e nënshkrues/it-ve, si dhe lëndën e peticionit. Lënda e peticionit duhet të ceket qartë në secilën faqe.

- Komunitetet mund t'i bëjnë peticione Kuvendit të Komunës përmes Komitetit të Komuniteteve. Përmbajtja e peticionit duhet të jetë ashtu siç është cekur më lartë. Një peticion i cili nuk përmban elementet e duhura, nuk konsiderohet i vlefshëm.
8. Drejtori i Drejtorisë së Administratës, në afat prej 30 ditësh nga dita që ai e pranon çdo peticion të vlefshëm, ia prezanton Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund t'ia referojë për shqyrtim të mëtejme komitetit të caktuar. Përfaqësuesit e parashtruesve të peticionit e kanë të drejtën e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në mbledhje të Komitetit dhe të Kuvendit të Komunës, me rastin e shqyrtimit të peticionit.
 9. Pas diskutimit në Kuvendin e Komunës, Kryetari i Komunës ose shërbimi përkatës, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e shqyrtimit i njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit.

Neni 7

Takimet me publikun

1. Komuna/Kryetari organizon takime publike periodike me qytetarë së paku dy herë në vit.
2. Në takimet me qytetarë, përfaqësuesit komunal i informojnë pjesëmarrësit për çështjet që i përkasin interesit të përbashkët për zhvillimin e jetës dhe politikës komunale.
3. Tubimet janë të karakterit të hapur dhe në to mund të marrin pjesë të gjithë të interesuarit.
4. Tubimet publike janë të hapura për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.
5. Pjesëmarrësit në këto tubime mund të marrin iniciativa, të japin propozime, sugjerime dhe të shprehin mendime për zgjidhjen e çështjeve të caktuara.
6. Njëri tubim duhet të mbahet në gjashtëmujorin e parë të vitit, ndërsa tjetri në gjashtëmujorin e dytë.
7. Nëse gjatë vitit mbahen vetëm dy takime me qytetarë, atëherë ndërmjet këtyre mbledhjeve duhet të ketë një interval kohor prej së paku tre muajsh.
8. Tubimet e tilla mund të organizohen edhe nëpër fshatra, vendbanime dhe lagje të caktuara urbane.
9. Vendi, data dhe koha kur do të mbahen takimet me qytetarë shpallen në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve në ndërtesën-at e Komunës dhe në vendet më të frekuentuara në qytet, në fshatra dhe në lagje urbane, si dhe në ueb-faqen e Komunës dhe atë 2 javë para mbajtjes së takimit.
10. Shpalljen publike e bën Zyra për Komunikim me Publikun.
11. Tubimet publike i udhëheq dhe i kryeson Kryetari i Komunës apo përfaqësuesi i tij.
12. Kryetari është i autorizuar ta caktojë rendin e ditës dhe procedurën për udhëheqje të diskutimeve. Në rast nevoje, ka të drejtë t'i ndërpresë diskutimet për çështjet që nuk kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe pushtetin e Komunës. Ai mund t'i refuzojë, t'i thërrasë ose t'i dëgjojë diskutuesit të cilët prezantojnë ose përsërisin pikëpamjet dhe mund ta caktojë kohën e paraparë për diskutim.
13. Nëse shtrohet ndonjë pyetje gjatë tubimit publik, për të cilën nuk mund të jepet përgjigje menjëherë, parashtruesi ka të drejtë të kërkojë përgjigje me shkrim brenda 30 ditësh pas mbajtjes së tubimit.
14. Për çdo tubim publik mbahet procesverbal, i cili përmban të gjitha informatat e dhëna nga përfaqësuesit komunal, propozimet e parashtruara nga publiku dhe reagimin ndaj tyre, si dhe të gjitha pyetjet dhe përgjigjet e dhëna.
15. Procesverbalin me të gjitha çështjet e diskutuara dhe propozimet e dhëna, në afat prej 30 ditësh nga dita e mbajtjes së tubimit, e shqyrton Komiteti për Politikë dhe Financa. Komiteti analizon çdo propozim të parashtruar në tubim dhe bën rekomandimet e nevojshme, të cilat ia propozon Kuvendit të Komunës për tubimin e radhës.

Neni 8 Konsultimi publik i akteve komunale

1. Rregulloret dhe dokumentet me interes të përgjithshëm të Komunës i nënshtrohen diskutimit publik para se ato të miratohen. Organi përgjegjës që propozon dokumentin, cakton mënyrën e konsultimit me grupet e interesit, seancat dëgjimore për publikun dhe forma tjera të pjesëmarrjes së publikut.
2. Zyra përgjegjëse për informim njofton publikun për pjesëmarrje të publikut për diskutim publik, përmes:
 - a. shpalljes publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës,
 - b. medieve të shkruar, elektronike dhe
 - c. ueb faqes së Komunës.
3. Njoftimi publik, sipas paragrafit të 8.2 të këtij neni, duhet të përmbajë datën e mbajtjes së mbledhjes, kohën e mbajtjes së mbledhjes, vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe rendin e ditës të paraparë për atë mbledhje.
4. Organi kompetent që ka propozuar aktin, duhet të marrë pjesë aktivisht dhe të sqarojë përmbajtjen e aktit para publikut.
5. Propozimet e dhëna nga publiku gjatë konsultimeve, duhet të evidentohen. Propozimet shqyrtohen brenda 15 ditëve nga përfundimi i konsultimeve.
6. Organi që ka propozuar aktin, duhet të informoj Kuvendin për propozimet e dhëna në diskutim publik, duke përfshirë propozimet e refuzuara, si dhe ato të marra parasysht. Me rastin e miratimit të aktit, Kuvendi kujdeset që propozimet e argumentuara të përfshihen në tekstin përfundimtar të projektit.

Neni 9 Caktimi i zyrtarit përgjegjës

Përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik është njësia/zyrtari për komunikim publik.

Neni 10 Parimet e konsultimit publik

1. Komuna organizon konsultimet publike me qytetarë në përputhje me parimin e:
 - 1.1. **Ligjshmërisë** - duke siguruar se procesi i konsultimit publik zhvillohet në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e përgjithshme të zbatueshme brenda kompetencave komunale;
 - 1.2. **Transparencës** - që nënkupton një qasje e hapur e Komunës për të garantuar se qytetarët dhe palët e interesuara janë të informuara dhe kanë qasje në të gjitha dokumentet në procesin e konsultimit publik dhe në gjuhët zyrtare;
 - 1.3. **Barazisë dhe mos diskriminimit** - në mënyrë që të gjitha palët e interesuara të kenë qasje të barabartë dhe jo diskriminuese në procesin e konsultimit publik;
 - 1.4. **Efikasitetit në procesin e konsultimit publik** - duke mundësuar aplikimin e formave dhe

teknikave më të përshtatshme për të kuptuar më lehtë përmbajtjen dhe ndikimin e pritur të projekt-propozimeve.

Neni 11

Dokumentet për konsultim publik

Komuna është e obliguar të ofroj konsultimin publik për të gjitha dokumentet e politikave lokale si ne vijim:

- 1.1. Projekt-Planin Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës / ekzekutivit;
- 1.2. Projekt-buxhetin e Komunës për vitin vijues, si dhe rishikimin buxhetor;
- 1.3. Korniza Afatmesme Buxhetore për 3 vitet e ardhshme;
- 1.4. Strategjitë Zhvillimore dhe Planet e Veprimit në nivel lokal në kuadër të fushave sektoriale;
- 1.5. Të gjitha projekt-planet hapësinore në nivel lokal, konform legjislacionit për planifikim hapësinor;
- 1.6. Të gjitha dokumentet e tjera për të cilat Komuna vlerëson se janë të nevojshme të kalojnë në konsultim publik.
- 1.7. Çfarëdo dokumenti tjetër të paraparë në legjislacionin e zbatueshëm që duhet t'i nënshtrohet procesit të konsultimit publik.

Neni 12

Format dhe teknikat e konsultimit publik

- 1.1. Publikimet dalin edhe në Platformën për Konsultime Publike të Qeverisë të integruar si lidhje ne ueb-faqen zyrtare të Komunës;

Neni 13

Planifikimi i konsultimeve publike

1. Planifikimi i përgjithshëm konsultimeve publike bëhet që në fazën e hershme gjatë hartimit të planit të punës së Komunës për vitin e ardhshëm kalendarik si dhe me rastin e hartimit të planit për komunikim publik.

Neni 14

Zbatimi i standardeve të konsultimit publik

1. Komuna bën publikimin e projekt-propozimeve ne ueb-faqet zyrtare të Komunave dhe ne Platformën e Konsultimeve Publike në nivel qendror.
2. Projekt-propozimet të cilat i nënshtrohen konsultimit publik duhet të jenë të qarta dhe

kompletuara me të gjitha dokumentet përcjellëse.

3. Komuna për politikën e caktuara të parapara në legjislacionin në fuqi, duhet të sigurojë konsultimin në fazat e hershme të hartimit palët e interesuara që ndikohen apo janë të interesuara të ndikojnë drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes.

4. Komuna është e obliguar të shpall rezultatet e procesit të konsultimit publik, të publikoj raportin më të gjitha propozimet e ofruara nga qytetarët, si dhe të jap sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve të tjera të interesuara;

Neni 15

Aktet nënligjore të Komunës për konsultim publik

1. Aktet e komunës që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik janë:
 - 1.1 Draft-Statuti i Komunës;
 - 1.2 Projekt-Rregulloret Komunale;
 - 1.3 Aktet tjera që parashihen me ligjet sektorial

Neni 16

Mbikëqyrja e procesit të konsultimit publik

- a). Kryetari i Komunës siguron që projekt propozimet e dorëzuara për aprovim në Kuvendin e Komunës të përmbushin standardet minimale për procesin e konsultimit publik.
- b). Kuvendi i Komunës refuzon aprovimin e projekt propozimeve në rastet kur nuk janë përmbushur standardet minimale të konsultimit publik sipas kriterëve të përcaktuara në këtë udhëzim administrativ.

Neni 17

Koordinimi, bashkëpunimi dhe raportimi

1. Komuna obligohet të koordinohet me MAPL dhe me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunal për konsultim publik.

Neni 18

Transparenca e vendimeve të organeve të Komunës

1. Aktet normative të komunës hyjnë në fuqi shatë (7) ditë pas publikimit të aktit në ueb-faqen zyrtare të komunës, përveç nëse me vetë aktin nuk është përcaktuar ndryshe.

2. Të gjitha vendimet e Kryetarit të Komunës pas nënshkrimit dhe pas konfirmimit të ligjshmërisë publikohen në faqen zyrtare të Komunës.
3. Aktet normative dhe vendimet e organeve të Komunës dërgohen në njësinë përgjegjëse për publikim në faqen zyrtare të Komunës në formën elektronike, në gjuhët zyrtare dhe në formatin e përcaktuar nga njësia/zyrtari përgjegjës/e për publikim të aktit normativ dhe vendimet e organeve të komunës.

Neni 19 **Transparenca financiare**

1. Komuna obligohet në transparencë të planifikimeve dhe shpenzimeve buxhetore duke ndërmarrë veprime konkrete në publikimin e tyre në faqen zyrtare të Komunës;
2. Plani i buxhetit pas aprovimit në Kuvendin e Komunës dhe vlerësimin e ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës;
3. Raportet tre mujore financiare sipas afateve të parashikuara me legjislacion sektorial;
4. Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) pas aprovimit në Kuvendin e Komunës dhe vlerësimin e ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës;
5. Raporti përmbledhës financiar për vitin e kaluar fiskal sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin sektorial;
6. Publikimi i Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Neni 20 **Transparenca në aktivitetet e prokurimit**

1. Komuna publikon në faqen zyrtare elektronike çdo aktivitet të prokurimit, publikimi i të cilave është i përcaktuar me legjislacionin sektorial.
2. Komuna publikon planin dhe raportin e prokurimit në faqen zyrtare elektronike, ashtu siç përcaktohet me legjislacionin sektorial.

Neni 21 **Qasja e drejtpërdrejtë në informata dhe dokumente publike**

1. Komuna siguron qasje në informata dhe dokumente publike përmes faqes zyrtare të saj:
 - 1.1 Planin e Punës së Kryetarit dhe Kuvendit të Komunës;
 - 1.2 Planin për Konsultim Publik
 - 1.3 Planin për Komunikim Publik
 - 1.4 Strategjitë dhe dokumentet e tjera të politikave të miratuara;
 - 1.5 Planin Zhvillimor Komunal, Hartat zonale dhe planet rregulluese urbane;
 - 1.6 Raportin Vjetor të Punës së Kryetarit dhe Kuvendit;
 - 1.7 Procesverbalet e takimit të Kuvendit të Komunës dhe komiteteve obligative;
 - 1.8 Të dhënat për biografitë e udhëheqësve të lartë të organeve të komunës dhe anëtarëve të KK-ve;

- 1.9 Emrin, numrin e telefonit zyrtar dhe adresën elektronike të drejtuesve të njësive brenda institucionit;
- 1.10 Listën e hollësishme të shërbimeve që ofron institucioni për publikun, si: licenca, leje, autorizime, certifikata, vërtetime apo shërbime publike të tjera, ku përfshihen edhe:
 - 1.10.1 Procedurat dhe kushtet e përfitimit të tyre;
 - 1.10.2 Afati i detyrueshëm për të marrë përgjigje për shërbimin e kërkuar.

Neni 22

Hartimi i Planeve Vjetore të Punës në Komuna

- 1. Komunat obligohen që të hartojnë Planet Vjetore të Punës së Kryetarit të Komunës dhe të Kuvendit.
- 2. Në përputhje me pikën 1 të këtij neni, Komunat obligohen të hartojnë Planin për Komunikim me Publik dhe Planin për Konsultim me Publikun.

Neni 23

Format e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje

- 1. Komuna siguron mekanizma të përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse në çdo fazë të procesit të hartimit dhe zbatimit të politikave lokale, duke filluar nga:
 - 1.1. Planifikimi;
 - 1.2. Diskutimi;
 - 1.3. Marrja e vendimit;
 - 1.4. Implementimi dhe
 - 1.5. Monitorimi.
- 2. Mekanizmat e lartpërmendura duhet të shfrytëzohen më qëllim të përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje, si:
 - 2.1 Informimi me kohë dhe komunikimi, përmes së cilëve qytetarët do të mund të shprehin sugjerimet, kërkesat dhe vërejtjet e tyre;
 - 2.2 Përfshirjen e qytetarëve në grupet punues;
 - 2.3 Organizimi i takimeve periodike me qytetarë në fshatra dhe lagje;
 - 2.4 Themelimi i Komiteteve konsultative për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, në veçanti për planifikimin hapësinor dhe buxhetin;
 - 2.5 Fuqizimi i bashkëpunimit mes Komunës dhe shoqërisë civile.
- 3. Duke promovuar qeverisje të mirë, komunat inkurajojnë personat me nevoja të veçanta të moshuarit, minoritetet, të rinjtë, gratë në procesin e vendimmarrjes duke gjetur forma dhe mekanizma shtesë.

Neni 24

Plani i Veprimit për Transparencë në Komunë

1. Komuna obligohet të hartojnë Planin katër (4) vjeçar të Veprimit për Transparencë në Komunë dhe pas miratimit në Kuvendin e Komunës, i njëjti publikohet në faqen zyrtare të komunës.
2. Plani i veprimit për transparencë në komuna ka për synim t'i ofroj publikut qasje në monitorim dhe zbatim të akteve të komunës, duke përfshirë edhe menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive, prokurimit dhe sferave tjera të cilat janë në interes për publikun.
3. Plani duhet të përfshijë:
 - 3.1 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës;
 - 3.2 Mbledhjet e Komiteteve;
 - 3.3 Takimet publike;
 - 3.4 Takimet konsultative;
 - 3.5 Takimet obligative në media për çështje që lidhen me shfrytëzimin e buxhetit të Komunës;
 - 3.6 Shpalljet publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit administrativ të Komunës;
 - 3.7 Takimet me grupet e interesit për të diskutuar çështje të sigurisë në bashkësi;
 - 3.8 Qasje të shpejtë dhe transparente të shërbimeve për qytetarët;
 - 3.9 Procedurat transparente të prokurimit;
 - 3.10 Procedurat transparente të punësimit;
 - 3.11 Publikimin e aktiviteteve ditore në faqe zyrtare;
 - 3.12 Përfshirja aktive e qytetarëve në vendimmarrje.

Neni 25

Gjuhët për komunikim zyrtar

1. Pjesëtarët e komunitetit pakicë kanë të drejtë të komunikojnë në gjuhët e tyre, në të gjitha organet e Komunës dhe me të gjithë nëpunësit civil të Komunës. Anëtarët e Kuvendit të Komunës kanë të drejtë të shprehen në gjuhët e tyre në mbledhjet e Kuvendit dhe në organet e tij.
2. Në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të komiteteve, të Këshillit të Drejtorëve dhe në të gjitha tubimet publike, diskutimet mund të bëhen në të dy gjuhët, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.
3. Aktet normative të Komunës shtypen në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Të gjitha dokumentet zyrtare të lëshuara nga organet e administratës, jepen në gjuhën e palës. Gjuhë e palës konsiderohet gjuha në të cilën pala fillimisht i drejtohet Komunës.
4. Rregulloret Komunale dhe vendimet mund të shtypen edhe në gjuhën e një komuniteti tjetër, nëse ai komunitet e kërkon atë.
5. Shenjat zyrtare që tregojnë emrat e fshatrave, të vendbanimeve, të rrugëve dhe të vendeve tjera publike, janë në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.
6. Komunikimi me institucionet komunale, institucionet e Republikës së Kosovës dhe organet e organizatave tjera, mund të bëhet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Gjuhët tjera mund të përdoren në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.
7. Çështjen e përdorimit të gjuhëve, Kuvendi i Komunës do ta rregullojë me rregullore për gjuhët.

Neni 26

E drejta e publikut për qasje në dokumente zyrtare të Komunës

1. Cilido person fizik apo juridik ka të drejtë në qasje të dokumenteve të organeve komunale, duke ju nënshtruar Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Qasjen në Dokumente Publike dhe Statutit të Komunës së Vitisë.
2. Kjo Rregullore vlen për të gjitha dokumentet që mbahen nga organet kompetente të Komunës, të hartuara apo të pranuar nga këto organe, për të gjitha fushat dhe aktivitetet e Komunës, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe.
3. Personat fizikë dhe ata juridik, nga paragrafi 10.2 të këtij neni, e gëzojnë të drejtën të jenë të informuar për politikën, vendimet dhe punën e organeve të administratës komunale.

Neni 27

Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare

1. Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare parashtrohet në formë të shkruar, duke u përshkruar informacioni që kërkohet, në mënyrë që Komuna ta identifikojë dokumentin. Parashtruesi nuk është i detyruar t'i japë arsyet për parashtrimin e kërkesës.
2. Nëse kërkesa nuk është e saktë lidhur me informacionin që kërkohet, organi kërkon nga parashtruesi që të qartësojë kërkesën.
3. Organet kompetente komunale e kanë për obligim që, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së kërkesë, t'i kthejnë përgjigje me shkrim parashtruesit të kërkesës. Nëse kërkesa refuzohet, pala e pakënaqur me përgjigjen ka të drejtë ankese. 15 pas pranimi të vendimit, mund të ushtrohet ankese e cila i dorëzohet Agjencisë për Informim dhe Privatësi, që në afat prej 7 ditësh pas pranimi të ankesës të ofrojë përgjigje me shkrim ndaj pretendimeve të ngritura nga ankuesi.
4. Nëse organet komunal nuk përgjigjen brenda afatit kohor të përcaktuar, parashtruesi ka të drejtë ta ushtrojë kërkesën konfirmuese. Në rast se kërkesa konfirmuese refuzohet plotësisht apo pjesërisht, organi komunal kompetent e njofton parashtruesin me mjete ligjore që i ka në dispozicion ai/ajo (nisja e procedurës gjyqësore ose parashtrimin e ankesës Avokatit të Popullit).

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 28

Me hyrjen e kësaj Rregullore në fuqi, shfuqizohet Rregullorja e mëparshme për Transparencë e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

HYRJA NË FUQI

Neni 29

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i Komunës së Vitisë dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.



Propozuesi

Kryetari i Komunës së Vitisë

Sokol Haliti



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

10.03.2020

02-035/02-251



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Vitina

Në bazë të nenit 58, pika **h** të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale me nr. 03/L-040, neni 13 i Udhëzimit Administrative (MAPL)nr. 04/2018 për Transparencën në Komuna, lidhur me nenin 6 të Udhëzimit Administrative (MAPL)nr. 06/2018, për standarde minimale të konsultimitit publik në Komuna dhe neni 50 shkronja (I) e Statutit të Komunës së Vitisë, nr. 01-013/491, të dt.21.04.2011 Kryetari i Komunës propozon këtë:

**PROPOZIM VENDIM
PËR SHPALLJEN NË DISKUTIM PUBLIK TË PLANIT KOMUNAL I
MENAXHIMIT TË MBETURINAVE**

I

Kryetari i Komunës , i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë, që të shpallë në diskutim publik draft planin komunal në menaxhimin e mbeturinave, 2020-2024

II

Propozimi në diskutim publik i draft planit komunal i menaxhimit të mbeturinave, 2020-2024 do të jepet në diskutim publik nga dt. 01.04.2020-30.04.2020, nga ora 8:00-16:00.

Propozimet, sugjerimet për plotësim ndyshim apo vërejtje eventuale paraqiten ditën e mbajtes së debatit publik , gjithashtu në formë të shkruar mundë të paraqitet gjatë kohëzgjatjesë së debatit publik në zyrën e Drejtories se shërbimeve Publike dhe Emergjencë në Komunën e Vitisë, ndërtesa shtëpia e kultures “ Gursel e Bajram Sylejmani në Viti si dhe në formë elektronike mundë të dërgohet emalin drilton.halabaku@hotmail.com, draft plani gjindet faqen elektronike të Komunës së Vitisë, kk.rks-gov.net/viti.

III

Debati publik do të mbahet me dt.01.05.2020 në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

IV

Të drejtë pjesëmarrje në diskutim publik kanë të gjithë qytetaret e interesuar , organet dhe institucionet e Komunës së Vitisë.

V

Qëllimi i këtij diskutimi publik është për të krijuar opinione pozitive për draft planin komunal i menaxhimit të mbeturinave, 2020-2024

VI

Ky propozim vendim hynë në fuqi ditën kur aprovohet nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Viti, dt. 09.03.2020

PROPOZUESI : KRYETARI I KOMUNËS

/ Sokol Haliti /





PLANI KOMUNAL I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE
KOMUNA E VITISË
2020-2024

Një falenderim i veçantë shkon për stafin e GIZ Kosovë Zj. Drita BINAJ, Zj. Vjollca BEHLULI, Z. Kemal HADZAGIC, dhe për stafin e asistencës teknike të EcoDES Studio Z. Konalsi GJOKA, Zj. Teida SHEHI, Z. Alfred LAKO, Zj. Keida YMERAJ dhe stafin e CEAE (Qendra për Mjedis dhe Energji Alternative) Z. Arben NIKA dhe Z. Tahir KRASNIQI që kontribuan dhe asistuan Komunën e Vitisë për hartimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave.

Me përkushtim të madh punuan për hartimin e planit edhe grupi punues i Komunës së Vitisë Z. Alban SOKOLI, Z. Afrim SULEJMANI, Z. Ajet SALLAHU, Z. Nexhmedin JAKUPI, Z. Deston ABDYLI nga Kompania "Eco Higjeni sh.p.k Gjilan, Njësia Operative Viti" Z. Haxhi QERIMI.

Gjithashtu, një falenderim i veçantë shkon për bashkëpunimin dhe mbështetjen e kryetarit të Komunës së Vitisë Z. Sokol HALITI.

TABELA PËRMBAJTJES

I. HYRJE	5
1.1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI KOMUNËN.....	5
1.1.1 Të dhëna demografike.....	6
II. ASPEKTET LIGJORE DHE INSTITUCIONALE NE MENAXHIMIN E MBETURINAVE	6
2.1 INFORMACION PËRMBLEDHËS MBI LEGJISLACIONIN.....	6
2.1.1 Instrumentat dhe mjetet në nivel vendor.....	6
2.1.2 Struktura organizative në komunë për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave.....	8
2.1.3 Qeveria qendrore.....	9
2.1.4 Pushteti lokal.....	10
2.1.5 Kompanitë rajonale të menaxhimit të mbeturinave.....	10
2.1.6 Kompanitë e tjera.....	10
III. ASPEKTEVE TEKNIKE NE MENAXHIMIN E MBETURINAVE	10
3.1 TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI MBETURINAT.....	10
3.1.1 Sasia e prodhuar e mbeturinave.....	10
3.1.2 Përbërja e fraksioneve të mbeturinave.....	11
3.1.3 Trendi i prodhimit të mbeturinave në komunë.....	12
3.2 SHËRBIMI I GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE.....	13
3.2.1 Skemat e grumbullimit të mbeturinave.....	13
3.3 TRAJTIMI DHE ASGJESIMI I MBETURINAVE.....	16
3.3.1 Riciklimi dhe kompostimi.....	16
3.3.2 Deponia.....	17
3.3.3 Deponitë ilegale.....	17
IV. ASPEKTET FINANCIARE NE MENAXHIMIN E MBETURINAVE	19
4.1 KOSTO E PLOTË E SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE.....	19
4.2 SISTEMI I TARIFAVE TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE.....	21
V. PLANIFIKIMI I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE	22
5.1 OBJEKTIVAT DHE TARGETAT E STRATEGJISE DHE PLANIT NACIONAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE.....	22
5.2 OBJEKTIVAT E LIGJIT PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE.....	24
5.3 VIZIONI I PLANIT KOMUNAL.....	24
5.4 OBJEKTI I PLANIT.....	26
VI. HARTIMI DHE PERSHKRIMI I MASAVE PËR TË ARRITUR OBJEKTIVAT	28

6.1	AKTIVITETET KYESORE PËR TË PËRMBUSHUR OBJEKTIVIN I TË PLANIT	28
6.1.1	<i>Miratimi i planit lokal të menaxhimit të mbeturinave</i>	29
6.1.2	<i>Konsolidimi i strukturës brenda komunës</i>	29
6.1.3	<i>Ngritja e kapaciteteve brenda komunës</i>	29
6.1.4	<i>Hartimi i një sistemi monitorimi për matjen e performancës të shërbimit</i>	30
6.2	AKTIVITETET KYESORE PËR TË PËRMBUSHUR OBJEKTIVIN II TË PLANIT.....	33
6.3	AKTIVITETET KYESORE PËR TË PËRMBUSHUR OBJEKTIVIN III TË PLANIT.....	38
6.4	AKTIVITETET KYESORE PËR TË PËRMBUSHUR OBJEKTIVIN IV TË PLANIT	42
6.4.1	<i>Forcimi i kapaciteteve për inkasimin e tarifës</i>	42
6.5	AKTIVITETET KYESORE PËR TË PËRMBUSHUR OBJEKTIVIN V TË PLANIT	47
6.5.1	<i>Menaxhimi i mbeturinave spitalore</i>	48
6.5.2	<i>Menaxhimi i mbeturinave inerte (Prioritet)</i>	48
6.5.3	<i>Menaxhimi i mbeturinave të vëllimshme, elektrike/elektronike, vajrave të përdorura</i>	48
6.6	AKTIVITETET KYESORE PËR TË PËRMBUSHUR OBJEKTIVIN VI TË PLANIT	49
6.7	AKTIVITETET KYESORE PËR TË PËRMBUSHUR OBJEKTIVIN VII TË PLANIT	49
VII.	HARTIMI I PLANIT OPERACIONAL, OBJEKTIVAT, INDIKATORET DHE AKTIVITETET	56
VIII.	RISHIKIMI I PLANIT	67
8.1	MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT	67
8.2	RAPORTIMI	68
IX.	REFERENCAT E PLANIT	70

Lista e Figurave

Figura 1	Pozita Gjeografike e Komunës së Vitisë	6
Figura 2	Sasia e mbeturinave të prodhuara gjatë katër viteve në Komunën e Vitisë.....	11
Figura 3	Përqindja e fraksioneve të mbeturinavenë nivel Kombëtar	12
Figura 4	Përqindja e fraksioneve të mbeturinavenë në Komunë e Vitisë.....	12
Figura 5	Trendi i rritjes së popullsisës dhe sasisë së mbeturinave gjatë 10 viteve të ardhshme	13
Figura 6	Niveli i ofrimit të shërbimit në territorin e Komunës së Vitisë.....	16
Figura 7	Deponitë ilegale të identifikuar në Komunën e Vitisë.....	18
Figura 8	Madhësia e deponive ilegale	18
Figura 9	Karakteristikat e deponive ilegale	19
Figura 10	Kosto e plotë e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave	20
Figura 11	Përqindja e inkasimit të tarifës së mbeturinave kundrejt faturimit.....	22
Figura 12	Procesi i diskutimeve me grupin e punës për hartimin e planit.....	25
Figura 13	Objektivat e planit të menaxhimit të mbeturinave.....	26
Figura 14	Skema e rrymës të mbeturinave komunale	27
Figura 15	Aktivitetet e Objektivit I	28
Figura 16	Detyrat e programit të parandalimit të mbeturinave	31
Figura 17	Kategoritë e Strategjisë për parandalimin e mbeturinave	32
Figura 18	Shporta 240 litra	35
Figura 19	Sasia e mbeturinave të riciklueshme që parashikohet të largohet nga rryma e mbeturinave	39
Figura 20	Sasia e mbeturinave organike që parashikohet të largohet nga rryma e mbeturinave.....	40

Figura 21	Komposter për mbeturinat organike.....	40
Figura 22	Opsionet e mbulimit të kostos së shërbimit të menaxhimit të integruar të mbeturinave ...	44
Figura 23	Përshkrimi i opsioneve të mbulimit të kostos	44
Figura 24	Hapat që duhen ndjekur për të zbatuar politikën e rikuperimit të kostos	45
Figura 25	Strategjia për vjeljen e tarifave	46
Figura 26	Indikatorët e performancës.....	68
Figura 27	Struktura e rishikimit të planit.....	69

Lista e Tabelave

Tabela 1	Konsumatorët në Komunën e Vitisë.....	6
Tabela 2	Situata e klientëve në Komunë e Vitisë	13
Tabela 3	Frekuanca e ofrimit të shërbimit në Komunën e Vitisë.....	15
Tabela 4	Kalendari i ofrimit të shërbimit në territorin e Komunës së Vitisë.....	15
Tabela 5	Kosto e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në Komunë e Vitisë	20
Tabela 6	Niveli i tarifave të pastrimit sipas kategorive të konsumatorëve.....	21
Tabela 7	Niveli i inkasimit të tarifave të konsumatorëve.....	21
Tabela 8	Përmbledhja e kostove për konsolidimi i strukturës brenda komunës për sistemin e menaxhimit të mbeturinave.....	33
Tabela 9	Përmbledhja e kostove për investimet për konsolidimin dhe zgjerimin e shërbimit.....	38
Tabela 10	Projeksioni i gjenerimit të mbeturinave dhe minimizimit të tyre gjatë 5 viteve të ardhshme	39
Tabela 11	Kosto e investimit për minimizimin e mbeturinave	42

I. HYRJE

1.1 Informacion i përgjithshëm mbi komunën

Komuna e Vitisë si pozicion gjeografik shtrihet në zonën jug lindore të Kosovës. Komuna ka një sipërfaqe prej 267km², ku 89% e popullsisë jeton në zona rurale. Komuna kufizohet me Komunat e Kaçanikut, Ferizajt dhe Gjilanit si dhe me Republikën e



Maqedonisë së Veriut.



Figura 1 Pozita Gjeografike e Komunës së Vitisë
[Burimi: zhvilluar nga autori]

1.1.1 Të dhëna demografike

Sipas ASK (Agjensisë të Statistikave të Kosovës), Komuna e Vitisë ka një popullsi prej 46,987 banorësh, nga të cilët 89.5% e tyre jetojnë në zona rurale (42,063 banorë) dhe pjesa tjetër jeton në zona urbane 4,924 banorë. Drejtoria përgjegjëse që merret me menaxhimin e mbeturinave është Drejtoria për Urbanizimin dhe Mbrojtjen e Mjedisit. Komuna ka nën administrimin e saj 38 fshatra. Nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, aktualisht në Komunën e Vitisë janë këto konsumatorë kryesorë përgjegjës për gjenerimin e mbeturinave komunale:

KOMUNA VITISË		<i>Nr. i popullsisë 46,987 banorë</i>
Numri i amvisërive		7,520
Numri i bizneseve		800
Numri total i institucioneve	47 (44 institucione shkollore, 1 Qendër Kryesore për Mjekësi Familjare)	
Numri i tregjeve të gjelbërta		2
Numri i fermave lektorale dhe prodhimtarisë të kulturave bimore		1,770 fermerë për kultura lavërtare dhe blegtori

Tabela 1 Konsumatorët në Komunën e Vitisë
[Burimi: Komuna Vitisë]

II. ASPEKTET LIGJORE DHE INSTITUCIONALE NE MENAXHIMIN E MBETURINAVE

2.1 Informacion përmbledhës mbi legjislacionin

2.1.1 Instrumentat dhe mjetet në nivel vendor

Kuadri ligjor për Republikën e Kosovës në lidhje me menaxhimin e mbeturinave përbëhet nga kjo kornizë ligjore me specifikimet përkatëse:

Ligji nr. 03/I-040 "Për vetqeverisjen lokale", 2008 - Në nenin 17 të këtij ligjit përcaktohet që aktorët lokalë (Komunat) kanë kompetencë të plotë dhe ekskluzive për ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike, siç është ai i menaxhimit të mbeturinave.

Ligji nr. 04/I-060 "Për menaxhimin e mbeturinave", 2012 – ky ligj, i cili është i amenduar rishtazi, paraqet bazën ligjore për përcaktimin e kompetencave komunale në Republikën e Kosovës për menaxhimin e mbeturinave. Sipas këtij ligji komunat duhet të: i) hartojnë planin komunal për menaxhimin e mbeturinave, i cili duhet të jetë në harmoni me planin nacional; ii) të zbatojnë planin komunal për menaxhimin e mbeturinave; iii) përcaktimin e tarifave dhe mënyrën e inkasimit të

mjeteve financiare për shërbimet komunale; iv) sipas ligjit dy ose më shumë komuna mund të bashkëpunojnë për menaxhimin e mbeturinave.

Sipas ligjit këto plane komunale duhet të fokusohen kryesisht tek: i) skemat/ programi për mbledhjen e mbeturinave; ii) propozimet për teknikat e duhura në lidhje me ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave; iii) programin për ngritjen e vetëdijes publike dhe edukimin në lidhje me menaxhimin e mbeturinave; iv) vlerësimin dhe llogaritjen e kostove për menaxhimin e mbeturinave.

Ligji përcakton që plani komunal do të hartohet për një periudhë 5 vjeçare dhe do të adresojë kapacitetet ekzistuese dhe ato në të ardhmen për mbledhjen e mbeturinave, trajtimin dhe deponimin e tyre, ku do të përcaktohet edhe nevoja për veprim për shërbimin cilësor ndaj qytetarëve, si dhe draftimin e një rregullore komunale të menaxhimit të mbeturinave

Gjithashtu sipas ligjit të amenduar, menaxhimi i mbeturinave komunale nga komunat duhet të bëhet përmes kontratave të veçanta me një ose më shumë operator publik ose privat të licencuar¹ për administrimin e mbeturinave.

Ligji nr. 04/I-111 "Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të ndërmarrjeve publike", 2012 – Sipas këtij ligji Komunitat kanë të drejtë të krijojnë ndërmarrje publike komunale për menaxhimin e mbeturinave.

Ligji nr. 04/I-045 "Për partneritetin publiko-privat – dispozitat e këtij ligji rregullojnë ofrimin e shërbimeve publike dhe /ose infrastrukturën publike për menaxhimin e mbeturinave, ku përfshihet mbledhja, deponimi, dhe riciklimi i tyre.

Draft rregullore për menaxhimin e mbeturinave në Komunë e Vitisë – Kjo draft rregullore është hartuar në Nëntor të vitit 2018, por nuk është miratuar ende. Sipas kësaj rregullore përcaktohen si më poshtë:

- a. **Qëllimi i rregullores:** rregullimi i çështjeve të menaxhimit të mbeturinave komunale, tarifat e klientëve për mbeturinat, si dhe krijimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar për menaxhimin e mbeturinave;
- b. Në rregullore përcaktohen përgjegjësitë e Komunës për Menaxhimin e mbeturinave: i) krijimin e një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave të ngurta komunale; ii) krijimin e sistemit të monitorimit të cilësisë të ofrimit të shërbimit; iii) promovimin e sistemeve të minimizimit të mbeturinave 3R (reduktimi, riciklimi, ripërdorimi); iv) planifikimi buxhetor dhe faturimi i taksës për mbeturinat; v) përpilimi i raporteve për menaxhimin e mbeturinave dhe shkallën e inkasimit të taksës.
- c. Të drejtat dhe detyrat e gjeneruesve të mbeturinave;
- d. Detyrimet për pagesat e faturës së taksave të mbeturinave nga gjeneruesit në katër këste në vit. Në rast se gjeneruesit e mbeturinave nuk paguajnë dy këste të njëpasnjëshme, ata nuk do të mundësohen me shërbim nga kompania.
- e. Dispozitat ndëshkuese për të gjithë ata që shkelin nenet e rregullores. Këto gjoja vendosen nëse inspektori – zyrtari i mjedisit evidenton këto shkelje;

¹ Licencën për menaxhimin e mbeturinave e lëshon Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, respektivisht Komisioni i Licënsimit

- f) Niveli i tarifave përkatëse për kategoritë e konsumatorëve: i) Amvisëritë për zonat urbane dhe zonat rurale; ii) tarifat për bizneset në varësi të sipërfaqes që ata kanë; iii) kosto për institucionet publike në varësi të zbrazjeve të tyre

2.1.2 Struktura organizative në komunë për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave

Aktualisht në Komunën e Vitisë, nën varësi të Kryetarit të Komunës janë 7 Drejtori, ku në varësi të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës është 1 zyrtar për menaxhimin e mbeturinave, i cili merret me çështjet e shërbimit dhe të menaxhimit të mbeturinave. Ndërkohë në lidhje me vendosjen e gjobave mandatore për keq menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës, është përgjegjëse Drejtorja e Inspeksionit, ku aktualisht janë 2 inspektorë.

Ndërkohë drejtori të tjera në komunë kanë disa funksione të caktuara të cilat lidhen me aspektet e menaxhimit të mbeturinave:

- Drejtorja për Shërbime Publike dhe Emergjencë, si përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha shërbimeve në pronat publike dhe komunale, është përgjegjëse për të monitoruar punët e kompanive të angazhuara për mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve dhe hapësirave të tjera komunale, ku ndër to janë edhe kompanitë për menaxhimin e mbeturinave komunale, të kontraktuara nga komuna apo regjionale.
- Drejtorja për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim është përgjegjëse për caktimin e tarifave të shërbimit dhe mënyrën e vjeljes së saj.
- Drejtorja për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, është përgjegjëse për hartimin e rregullores lokale për kontrollin e mbeturinave dhe hedhurinave brenda territorit të Komunës, si dhe siguron mbështetje në zhvillimin e projekteve në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit.
- Drejtorja e Inspeksionit, e cila është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe dispozitave të rregulloreve komunale në lëmin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Mjedisit, Bujqësisë dhe Pylltarisë, si dhe dhe task forca për zbatimin e gjobave mandatore kundrejt atyre që nuk zbatojnë ligjin.

Komuna e shikon si shumë të nevojshme, nisur edhe nga detyrimet dhe përgjegjësitë ligjore që ia ngarkon kuadri ligjor, të ngrihet një sektor i veçantë për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave në varësi të kësaj drejtorie. Sektori do të jetë i dedikuar plotësisht sistemit të menaxhimit të mbeturinave, duke ndjekur hap pas hapi zbatimin e planit dhe monitorimin e vazhdueshëm të kompanive publike dhe private për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave.

Ndonëse kuadri ligjor i delegon të drejta komunës në lidhje me shërbimin e menaxhimit të mbeturinave, mungesa e një sektori për menaxhim të mbeturinave ka çuar në një situatë, ku cilësia e shërbimit të ofruar nga kompania nuk është gjithmonë në standardin e kërkuar, si pasojë e mos kontrollit dhe monitorimit rigoroz nga komuna.

2.1.3 Qeveria qendrore

Kuvendi i Republikës së Kosovës, si organi legjislativ i vendit, është përgjegjës për pjesën e miratimit të ligjeve, në këtë rast në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe në monitorimin e zbatimit të tyre nga komisionet ligjore. Më konkretisht ai është përgjegjës për: i) miratimin e ligjit për mjedisin, ligjit për mbeturinat dhe kuadrin ligjor relevant për fushën përkatëse; ii) nxjerrjen e strategjive për mbrojtjen e mjedisit; iii) dhënien e rekomandimeve dhe monitorimin e zbatimit të ligjeve nga komisionet e kuvendit.

Qeveria e Republikës së Kosovës, është organi përgjegjës për miratimin e Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturinave si dhe për nxjerrjen e udhëzimeve administrative qeveritare.

Ministria e Infratsukturës është organi, i cili propozon, harton dhe mbikqyr zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e menaxhimit të mbeturinave. *Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit* pranë kësaj ministrie, është organi përgjegjës për aspektet e politikës kombëtare dhe kuadrin ligjor dhe rregullator për menaxhimin e mbeturinave. Konkretisht detyrat e këtij departamenti janë:

- Propozon, harton dhe siguron bazën për krijimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit;
- Harton dokumente Strategjike dhe legjislacionin për fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- Propozon masa dhe projekte për rehabilitimin e zonave të "nxehta";
- Përcakton dhe propozon investimet dhe financimin në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- Kryen aktivitete administrative dhe profesionale për anëtarësim në Konventa, Traktate, Marrëveshje dhe Organizata ndërkombëtare, për mbrojtjen e mjedisit;
- Ofron mbështetje profesionale, për çështjet që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e burimeve natyrore;
- Shqyrton dhe përgatit propozim-vendime për kërkesat e palëve, për çështje të ndryshme mjedisore;
- Përgatit raporte të ndryshme për çështjet mjedisore.

Ky departament në strukturën e tij ka katër divizione në varësi të tij:

- i. Divizioni për Edukimin dhe Ndërgjegjësimin Mjedisor;
- ii. Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale;
- iii. Divizioni për Mbeturina dhe Kimikate;
- iv. Divizioni për Mbrojtjen e Natyrës.

Divizioni i cili është drejtëpërdrejtë përgjegjës për sektorin e mbeturinave është *Divizioni për Mbeturina dhe Kimikate*. Ky divizion ndër detyrat dhe përgjegjësitë më të rëndësishme ka:

- Hartimin e Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Plan Veprimin për Menaxhimin e Mbeturinave;
- Përgatitjen e programeve për monitorim dhe raportet për gjendjen ekzistuese të mbeturinave;
- Dhënien e licensave për menaxhimin e mbeturinave dhe dhënien e lejeve për eksport, import dhe tranzit të mbeturinave;
- Mbikqyrjen e zbatimit të kuadrit ligjor dhe menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme.

2.1.4 Pushteti lokal

Pushteti lokal, ose organi ekzekutiv në nivel lokal (**Komuna**), është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikës lokale për menaxhimin e mbeturinave, cila duhet të jetë në harmoni me Strategjinë Kombëtare dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të mbeturinave. Konkretisht ato janë përgjegjëse për:

- Hartimin dhe miratimin e planeve lokale për menaxhimin e mbeturinave;
- Përcaktimet e lokacioneve, bazuar tek plani hapsinor, sipas nevojave përkatëse për menaxhimin e mbeturinave komunale;
- Përcaktimin e tarifave për shërbimet e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave komunale;
- Caktimin dhe mbikqyrjen e zbatimit të standardeve të shërbimit për ndërmarrjet e kontraktuara për grumbullimin e mbeturinave.

2.1.5 Kompanitë rajonale të menaxhimit të mbeturinave

Këto kompani janë kompani publike përgjegjëse për kryerjen e shërbimeve të grumbullimit, bartjen nga vendbanimet dhe deri tek deponitë e mbeturinave. Kompanitë rajonale publike e ofrojnë shërbimin për disa komuna në një rajon të caktuar dhe komunat që mundësohen me shërbim nga këto kompani kanë përfaqësuesin e tyre në bordin e kompanisë.

2.1.6 Kompanitë e tjera

Kompanitë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës – KMDK –Këto kompani janë kompani shtetërore dhe janë përgjegjëse për menaxhimin e deponive regjionale të mbeturinave të komunave.

Në bazë të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK SH. A.), është kompani e legalizuar dhe e licencuar për menaxhimin e deponive sanitare regjionale të mbeturinave Komunale në Republikën e Kosovës, e korporatizuar dhe e regjistruar si Shoqëri Aksionare konform Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare.

Kompanitë e licensuara, apo sektori privat, janë kompani të cilat licensohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe ofrojnë shërbimet për grumbullimin, trajtimin, riciklimin, transportimin dhe deponimin e llojeve të ndryshme të mbeturinave.

III. ASPEKTEVE TEKNIKE NE MENAXHIMIN E MBETURINAVE

3.1 Të dhëna të përgjithshme mbi mbeturinat

3.1.1 Sasia e prodhuar e mbeturinave

Komuna e Vitisë, në kuadër të bashkëpunimit me PPP, ka kontraktuar kompaninë Eco-Higjena sh.p.k Gjilan – Njësia punuese Viti, i cili ofron shërbimin e menaxhimit të mbeturinave komunale dhe disa shërbime sekondare si, mirëmbajtjen e hapsirave publike (të gjelbërta), fshirjen e rrugëve dhe trotuarave dhe zonat e tregut të gjelbërt. Kjo kompani grumbullon dhe transporton mbeturinat e

Komunës së Vitisë në Deponinë rajonale të Velekincës. Në grafikët më poshtë tregohet tendenca e sasisë së prodhuar të mbeturinave gjatë muajve të vitit 2018:



Figura 2 Sasia e mbeturinave të prodhuara gjatë katër viteve në Komunën e Vitisë [Burimi: „Eco-Higjena sh.p.k Gjilan Njësia Punuese Viti“]

Nga grafiku shohim se sasia më e madhe e mbeturinave të grumbulluara në komunën e Vitisë është në periudhën e muajve të verës, ku totali vjetor shkon në 5,106 ton mbeturina në vit. Sipas të dhënave të mundësuar nga Raporti për Mbeturinat dhe Kimikatet, AMMK 2014, vlerësohet se Komuna e Vitisë gjeneron rreth 42 ton në ditë mbeturina komunale dhe rreth 70 ton në ditë gjithësej të gjitha llojet e mbeturinave (inerte, mbeturina komunale, mbeturina të rrezikshme, medicinale, biomasë etj). Komuna e Vitisë i dërgon mbeturinat në deponinë rajonale të Velekincës në Gjilan, kundrejt një tarife 5.7-6.6 €/ton.

3.1.2 Përbërja e fraksioneve të mbeturinave

Në vitin 2011 GIZ² në Kosovë ka kryer studim për përbërjen e fraksioneve të mbeturinave dhe në nivel kombëtar mbeturinat organike përbëjnë **43%** të rrymës së mbeturinave. Ndërsa fraksione të tjera të mbeturinave si lënda drusore, letra, plastika, qelqi, metalet, materialet e përbëra, tekstilet, mbeturinat EEE, si dhe kategori të tjera të papërcaktuara përbëjnë rreth **37%** të përbërjes së mbeturinave. Pjesa tjetër e fraksioneve të mbeturinave janë fraksione të parikuperueshme si mbeturina të higjenës, apo mbeturina ambulatorë, të cilat mund të bashkohen me pjesën e mbeturinave komunale, si dhe kategori të tjera mbeturinash.



Figura 3 Përqindja e fraksioneve të mbeturinave në nivel Kombëtar
[Burimi: zhvilluar nga autori]

Ndërkohë në vitin 2011, Komuna e Vitisë ka zhvilluar një ushtrim për mbledhjen e mostrave në 4 lokacione në territorin e saj dhe kryerjen e ndarjes së fraksioneve të mbeturinave. Nga matjet e kryera, ka rezultuar se rreth 50% e fraksioneve të mbeturinave që përfundojnë në deponi janë organike, me prejardhje kryesisht nga mbeturina të kuzhinës, të ndjekura nga plastika, imtësira të tjera, dhe produktet higjienike. Në grafikun më poshtë tregohen më të zgjeruara përfundimet e këtij ushtrimi:




Figura 4 Përqindja e fraksioneve të mbeturinave në Komunën e Vitisë
[Burimi: Komunan e Vitisë]

Siç mund ta shohim nga grafiku, 49.6% e mbeturinave janë organike dhe potencial për t'u kompostuar, si dhe 19.8% e fraksioneve të mbeturinave janë potencial për t'u ricikluar.

3.1.3 Trendi i prodhimit të mbeturinave në komunë

Bazuar në dokumentet zyrtare të Republikës së Kosovës, në nivel kombëtar, koeficienti i rritjes së popullsisë parashikohet të jetë 1.2%³. Në tabelën mëposhtë parashikohet një trend i rritjes së popullsisë dhe sasisë së mbeturinave komunale në Komunën e Vitisë gjatë 10 viteve të ardhshme:

³ Agjësia e Statistikave të Kosovës 2015, Vlerësim Popullsisë e Kosovës 2015

Viti		2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029
Projeksioni i rritjes së popullsisë (1.2%)	nr.	46,987	47,551	48,121	48,699	49,283	49,875	50,473	51,079	51,692	52,312
Projeksioni i rritjes së sasisë së mbetjeve (ton) (1.2%)	% sipas rrymave	10,290	10,414	10,539	10,665	10,793	10,923	11,054	11,186	11,321	11,456




Figura 5 Trendi i rritjes së popullsisës dhe sasisë së mbeturinave gjatë 10 viteve të ardhshme [Burimi: zhvilluar nga autori]

3.2 Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave

3.2.1 Skemat e grumbullimit të mbeturinave

Komuna e Vitisë, në kuadër të bashkëpunimit me PPP, ka kontraktuar kompaninë Eco-Higjena sh.p.k Gjilan – Njësia punuese Viti, i cili ofron shërbimin e menaxhimit të mbeturinave komunale dhe disa shërbime sekondare si, mirëmbajtjen e hapsirave publike (të gjelbërta), fshirjen e rrugëve dhe trotuareve dhe zonat e tregut të gjelbërt. Kjo kompani kryen faturimin dhe inkasimin e të hyrave nga tarifat e pastrimit nga amvisëritë, bizneset dhe institucioneve publike, të cilat i ka në sistem në sajë të kontratës „në shtëpi“. Nga të dhënat e mundësuar nga komuna, nga 8,369 konsumatorë në territorin e komunës (ekonomi familjare, biznese dhe institucione), vetëm 3,768 prej tyre janë në sistem, ku specifikisht 45% e ekonomive familjare janë në sistem, 39% e bizneseve janë në sistem dhe 100% e institucioneve janë në sistem, siç tregohet edhe në tabelën më poshtë:

Komuna	Klientë gjithsej në zonën kadastrale				Klientë të faturua = shërbyer			
	Ekonomi familjare	Biznese	Institucione	Gjithëse	Ekonomi familjare	Biznese	Institucione	Gjithëse
Viti	7,520	800	49	8,369	3,404	315	49	3,768

Tabela 2 Situata e klientëve në Komunë e Vitisë

[Burimi: Kompani „Eco-Higjena sh.p.k Gjilan, Njësia Operative Viti“]

Grumbullimi i mbeturinave në Komunën e Vitisë, sipas të dhënave të mundësuar nga komuna, kryhet me kontenierë të përbashkët të vendosura në 6 pika kolektive në qytetin e Vitisë me kapacitet 1.1m³, rreth 60 kontenierë pika të ndryshme të qytetit. Këto pika kolektive në pjesën më të

madhe të rasteve janë të bizneseve apo institucioneve, të cilat kanë një kontratë me kompanië dhe marrin shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave. Ndërsa në shërbimin derë më derë në amviseri komuna nuk ka shpërndarë shporta apo qese. Ato janë pronë dhe zgjedhje e konsumatorit.

Ndërkohë Komuna e Vitisë në varësi të tipologjisë të zonave ku ka pika për grumbullimin e mbeturinave, ka evidentuar disa lloje të pikave të grumbullimit:

Grumbullimi Derë më derë në të gjitha ekonomitë familjare që janë pjesë e sistemit me shporta ose qese të cilat janë pronë e komunitetit

Në pikat institucione (kontenier 1.1m³)



Në Pika kolektive të përbashkëta (kontenier 1.1m³)



Në pikat biznese (kontenier 1.1m³)



Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në Komunën Vitisë kryhet gjatë 8 orarit 06:00-14:00, si në tabelën më poshtë:

Frekuenca

Lokacioni & orari

6 ditë në javë

Qyteti i Vitisë (06:00 – 14:00)

1 herë në javë

Në 28 fshatrat e komunës

Tabela 3 Frekuanca e ofrimit të shërbimit në Komunën e Vitisë
[Burimi: Kompani „Eco-Higjena sh.p.k Gjilan, Njësia Operative Viti“]

Komuna ofron shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në 6 ditë të javës në qytetin e Vitisë, dhe 1 ditë të javës në 28 fshatra. Sipas të dhënave të deklaruara nga komuna 10 fshatrat e tjerë nuk janë të mbuluar me shërbim.

Në tabelën më poshtë tregohet më qartë se në cilat njësi administrative kryhet shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave gjatë 6 ditëve të javës:

Zona	E Hënë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E Shtunë	E Dielë
Qyteti Viti	Viti (qendra e parë+rrugët dytësore)	Viti (qendra dhe zona e dytë)	Viti (qendra)	Viti (qendra + zona e parë)	Viti (qendra)	Viti (qendra)
Fshatrat	Drobeshe Smirë Begunca	Pozhoran (zona e parë) Qifllak Terpez (zona e parë) Kabashe Binça Lubishte Potgorc/deponi	Sllatina e ulët dhe e Epërme Terpeza (pjesa e dytë) Fshat i Ri Germov Sadovin Qerkezve Trestenik Zhiti Balance Verban	Rruga Kllokot Viti Budrik Radivojc Remik Ramishte Stublla		Goshicë Gjylekare

Tabela 4 Kalendar i ofrimit të shërbimit në territorin e Komunës së Vitisë
[Burimi: Kompani „Eco-Higjena sh.p.k Gjilan, Njësia Operative Viti“]

Ndërkonë në hartën më poshtë tregohet se si është i shpërndarë shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në Komunë e Vitisë, të mundësuar nga AMMK dhe GIZ:

KOMUNA E VITISË

Shtirja e shërbimit të menjshmit të mbeturinave




Figura 6 Niveli i ofrimit të shërbimit në territorin e Komunës së Vitisë
[Burimi: GIZ, AMMK]

Kompania ka angazhuar 3 vozitës dhe 6 punëtorë pastrimi (gjithësej 9 punonjës), për të kryer shërbimin e grumbullimit dhe transportin e mbeturinave në Komunën e Vitisë. Kompania ka 3 mjete (2 kompaktorë 12ton dhe 9 ton) dhe një kamion i hapur me kapacitet 1.5 ton për të kryer shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave për konsumatorët që janë pjesë e sistemit.

3.3 Trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave

3.3.1 Riciklimi dhe kompostimi

Sot tregu i mbeturinave të riciklueshme në Kosovë është në hapat e para të zhvillimit të tij. Megjithatë, në shumë komuna kanë filluar aktivitetin kompani të ndryshme, të cilat grumbullojnë, paketojnë ose përpunojnë fraksione të ndryshme të mbeturinave të riciklueshme, si letrën, plastikë, alumini etj. Furnizuesi kryesor të këtyre kompanive është sektori informal. Ky sektor vepron mbi baza

individuale dhe në kushte aspak higjens – sanitare, duke grumbulluar mbeturinat e riciklueshme, kryesisht në konteinerët publik apo në deponitë ilegale. Kompanitë private grumbullojnë lëndën e parë nga sektori informal, kundrejt një çmimi të caktuar për cilin fraksion: **i)** 17-23 cent/kg plastika; **ii)** 3-6.5 cent/kg letra dhe kartoni; **iii)** 80 cent/kg alumini. Zakonisht sasia mesatare e fraksioneve të grumbulluara nga këto kompani varion nga 8-10 ton mbeturina për secilin fraksion.

Kryesisht këto kompani kryejnë disa procese në stabilimentet e tyre: **i)** në rastin e plastikës ata mund ta kompresojnë dhe më pas e shesin, ose mund ta përpunojnë në formën e petezave dhe e shesin si lëndë të parë tek sektori i ambalazheve; **ii)** në rastin e letrës apo të kartonit, kryesisht grumbullohet dhe presohet për t'u shitur në treg. Pjesa më e madhe e produkteve të këtyre kompanive furnizon tregun e brendshëm.

Ndërkohë në komunë Vitisë nuk evidentohen raste të riciklimit. Gjithashtu për sa i takon kompostimit, në këtë komunë nuk evidentohen iniciativa në nivel komunë. Mund të ketë raste sporadike në banesat private, ku vetë banorët kompostojnë kryesisht mbeturinat nga kopshtet.

3.3.2 Deponia

Kompania private Eco – Higjena sh.p.k Gjilan – Njësia punuese Viti i deponon mbeturinat në deponinë regionale të Velekincës në Gjilan, kundrejt një pagese **5.7-6 €/ton**. Komunitat të cilat i deponojnë mbeturinat në këtë deponi janë: Gjilani, Kamenica, Vitia, Novobërda, Kaçaniku, Shtimja dhe Ferizaj. Hapësira e deponisë është 24 ha dhe jetëgjatësia është 15 vite. Kapaciteti i përgjithshëm është 1,200 000 m³, ndërsa kapaciteti mujor është 4,000 ton. Deponia është kthyer në një vatër të nxehtë mjedisore pasi sistemi i instaluar nuk siguron asgjësim të sigurtë të mbeturinave dhe për këtë arsye, kjo deponi ka nevojë për një plan rehabilitimi për të ulur edhe ndotjen mjedisore dhe problemet që mund të shkaktohen në komunitetin përreth.

3.3.3 Deponitë ilegale

Sipas Ligji për Mbeturinat, komunitat janë të detyruara që të nxjerrin një regjistër të deponive ilegale në territorin e tyre, brenda një periudhe njëvjeçare, siç përcaktohet në nenin 81. Kjo detyrë duhet të kryhet nga inspektorët komunalë të mjedisit (neni 62), të cilët shpesh herë bashkëpunojnë me stafin përkatës të Ndërmarrjeve Publike. Ushtrimi i zhvilluar në Komunën e Vitisë për evidentimin e deponive ilegale, me mbështetjen e GIZ, ka evidentuar 35 deponi të tilla. Ekipi identifikues në terren ka fotografuar pikat ilegale, ka shënuar koordinatën përkatëse dhe ka përcaktuar vëllimin përkatës të tyre si dhe ka përcaktuar fraksionet e mbeturinave që gjendeshin në deponiëtë ilegale. Në hartën më poshtë tregohet shpërndarja e deponive ilegale të evidentuara në Komunën e Vitisë:



Figura 7 Deponitë ilegale të identifikuara në Komunën e Vitisë
[Burimi: GIZ, AMMK]

Sipas evidencave të marra në terren në grafikët më poshtë tregohen kategoritë e deponive ilegale sipas vëllimit të tyre dhe llojit të fraksioneve të mbeturinave që ndodhen në to:



Figura 8 Madhësia e deponive ilegale
[Burimi: zhvilluar nga autori]




Figura 9 Karakteristikat e deponive ilegale
[Burimi: zhvilluar nga autori]

Siç mund të shohim nga grafikët, deponitë më të shumta në komunë janë nga mbeturinat organike, ku sipërfaqet më të zakonshme krahasohen me sasi mbi 5 qese prej 200litra.

IV. ASPEKTET FINANCIARE NE MENAXHIMIN E MBETURINAVE

4.1 Kosto e plotë e sistemit të menaxhimit të mbeturinave

Në llogaritjen e plotë të kostonë së shërbimit të menaxhimit të mbeturinave Komuna duhet të sigurojë të gjithë zërat e nevojshëm për tre shërbimet kryesore të sistemit të menaxhimit të mbeturinave: i) grumbullimi dhe transporti i mbeturinave; ii) deponia; iii) autoparku, ashtu siç janë paraqitur në diagramën më poshtë:

KOSTO E PLOTË E SHËRBIMIT TË MBETURINAVE		
I. KOSTO PËR GRUMBULLIMIN E MBETURINAVE	II. KOSTO PËR DEPONINË	III. KOSTO E AUTOPARKUT




Figura 10 Kosto e plotë e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave
[Burimi: metodologjia e GIZ, përshtatur nga autori]

Në rastin e Komunës të Vitisë, Komuna nuk deklaron të ketë llogaritur një kosto të plotë të shërbimit të grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave. Komuna ndonëse nuk e ofron vetë shërbimin e menaxhimit të mbeturinave në sajë të detyrimeve që ja përcakton ligji për menaxhimin e mbeturinave, ka për detyrë të llogarisë dhe të njohë koston e plotë të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave sipas zërave të përcaktuar më lart. Në këtë mënyrë komuna arrin të kuptojë realisht kostot specifike të të gjitha shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, dhe mund të përcaktojë qartësisht nivelin e tarifave të pastrimit me synim mbulimin e plotë të koston.

Ndërkohë kompania regjionale, e cila ofron shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në 50% të klientëve të komunës, ka llogaritur disa kosto të cilat kryesisht janë kosto operative dhe ato të stafit. Në tabelën më poshtë tregohen këto kosto, të cilat më pas do të krahasohen me inkasimet e deklaruar nga kompania, për të kuptuar se sa potencial ka komuna për të mundur shërbimin (me prokurim ose me mjetet e veta) nëse ajo do të marrë përsipër inkasimin e tarifës, edhe pse vetëm 50% e klientëve janë në sistem.

Zërat e buxhetit sipas kompanisë	€/vit
Shpenzimet për karburant	31,697.00
Kostot për deponimin e mbeturinave	29,259.63
Kosto operative për stafin direkt të punëtorëve (15)	58,440.00
Kosto për stafin indirekt të punëtorëve (6)	26,640.00
Kostot indirekte administrative	1,420.00
Gjithësej	147,456.63

Tabela 5 Kosto e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në Komunë e Vitisë
[Burimi: Kompani „Eco-Higjena sh.p.k Gjilan, Njësia Operative Viti“]

4.2 Sistemi i tarifave të menaxhimit të mbeturinave

Autoriteti i vetëm për caktimin e tarifave të shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave pas shuarjes së veprimtarisë së ZRRUM-it (Zyra Rregullative për Ujin dhe Mbeturinat), sipas bazës ligjore janë Komunitet dhe Republikës së Kosovës.

Komuna e Vitisë ka këtë nivel të tarifave sipas kategorive të konsumatorëve që janë në sistem dhe kanë një kontratë me kompaninë rajonale që kryen shërbimin në territorin e komunës:

Kategoritë e konsumatorëve	Tarifa e pastrimit €/muaj (pa TVSH)	Tarifa e pastrimit €/muaj (me TVSH)
Amvisëritë	4.63	5.00
Kiosqet, argjent. fotograf. avak. etj	7.57	8.18
Serviset, butikat, këmbimoret, etj	5.40	5.83
Furrat, ordinancat, sh. ushqimore, etj	11.91	12.86
Shitje ushqim & tekstilit, etj. -zona 2	9.74	10.52
Restaurantet, podruktet e pijeve, etj. zona 2	20.23	21.85
Pompat e benz., restaurantet, etj. zona 2	18.13	19.58
Depo materiale ushqimore, Supermarketet, etj	25.78	27.84
Mishtore, kopështet bujqësore, etj.	20.23	21.85
Bizneset & institucionet me Kontenier 1.1 m ³	11.19	12.08
Bizneset & institucionet me Kontenier 4.5 m ³	29.17	31.50

Tabela 6 Niveli i tarifave të pastrimit sipas kategorive të konsumatorëve
[Burimi: Kompani „Eco-Higjena sh.p.k Gjilan, Njësia Operative Viti“]

Kompania Publike KRM “Eco-Higjena sh.p.k Gjilan, Njësia Operative Viti” bën inkasimin e tarifës së mbeturinave dhe nga të dhënat e mundësuar prej saj, në tabelën dhe grafikun më poshtë jepet përqindja e inkasimit të 50% të klientëve të komunës të cilët janë në sistem, gjatë vitit të fundit:

Kategoritë e konsumatorëve	Faturuar (€/vit)	Inkasuar (€/vit)	%
Amvisëritë	194,091.69	188,597.45	97%
Bizneset	36,382.98	40,705.01	112%
Institucionet	25,613.62	21,184.12	83%
Totali	256,088.29	250,486.58	

Tabela 7 Niveli i inkasimit të tarifave të konsumatorëve
[Burimi: Kompani „Eco-Higjena sh.p.k Gjilan, Njësia Operative Viti“]




Figura 11 Përqindja e inkasimit të tarifës së mbeturinave kundrejt faturimit
[Burimi: zhvilluar nga autori]

Nga grafiku shohim se niveli i grumbullimi të tarifave për të tre kategoritë e konsumatorëve është relativisht i lartë, pothuajse 100%. Nëse do ta krahasojmë me koston e mundur nga kompania, mund të themi që ajo mbulohet plotësisht nga inkasimi i tarifave, por përsëri ky përfundim bazohet vetëm për 50% të konsumatorëve të cilët mundësohen me shërbim.

Ndonëse kemi një informacion në lidhje me nivelin e inkasimit të tarifës, komuna duhet të dijë sa është kosto reale e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, për të kuptuar që ndonëse ka një performancë relativisht të mirë të grumbullimit të tarifës, njohja e koston së plotë do t'i japë mundësinë komunës të kuptojë nëse realisht mbulohet apo jo kosto nga inkasimi i tarifave.

V. PLANIFIKIMI I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE

5.1 Objektivat dhe targetat e Strategjisë dhe Planit Nacional për Menaxhimin e Mbeturinave

Sipas Strategjisë dhe Planit Nacional të Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave qëllimi i kryesor është krijimi i një kornize masash, të cilat do të synojnë zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që krijohen në burim, zvogëlimin e sasisë së tyre që shkojnë në deponi dhe zhvillimin e një infrastrukture për ngritjen e një sistemi të integruar për menaxhimin e mbeturinave. Gjatë periudhës kohore 10 vjeçare 2013-2022 të zbatimit të saj, strategjia ka vendosur tre periudha kohore të rëndësishme (2015 – 2019 – 2022) dhe targetat përkatëse:

i. Grumbullimi i mbeturinave komunale



ii. Ndarja në fraksione e mbeturinave komunale



iii. Trajtimi i mbeturinave



iv. Sasia e mbeturinave të hedhura në deponi



v. Sasia e mbeturinave të biodegradueshme të hedhura me mbeturinat komunale



Siç mund ta shohim, strategjia synon rritjen e shkallës të mbulimit me shërbim, rritjen e përqindjes të ndarjes dhe grumbullimin e ndarë të mbeturinave, rritjen e përqindjes të trajtimit të mbeturinave, si dhe zvogëlimin e sasisë të mbeturinave që shkojnë në deponi dhe zvogëlimin e sasisë të mbeturinave të biodegradueshme që grumbullohen me ato komunale. Trajtimi i mbeturinave në deponitë mbetet një nga mënyrat përfundimtare të trajtimit të mbeturinave në Republikën e Kosovës deri në fund të dhjetëvjeçarit të strategjisë (2022).

5.2 Objektivat e Ligjit për Menaxhimin e Mbeturinave

Në Ligjin nr.04/l-060 "Për menaxhimin e mbeturinave", 2012, i amenduar, përcaktohet detyrimi për hartimin dhe zbatimin e planit lokal të menaxhimit të mbeturinave si dhe rregulloreve përkatëse për të gjithë komponentët e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave nga Komuna. Konkretisht komuna ka si detyrim ligjor:

1. Hartimin e planin komunal për menaxhimin e mbeturinave, i cili duhet të jetë në harmoni me planin nacional;
2. Zbatimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave;
3. Hartimin e rregulloreve me përgjegjësitë dhe detyrimet për organizimin dhe ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave në territorin e tyre;
4. Krijimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi për informimin e publikut dhe raportimin mbi punën e bërë dhe përgatitjen e një raporti vjetor për menaxhimin e mbeturinave;
5. Identifikimin e deponive të egra në territorin e tyre dhe zhvillimin e projekteve për rehabilitimin e tyre;
6. Përcaktimin e tarifave dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve financiare për shërbimet komunale;
7. Aplikimin e procedurave të prokurimit për përzgjedhjen e personave të licensuar për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave në territorin e tyre;
8. Mbikqyrjen dhe kontrollin e aktiviteteve të menaxhimit të mbeturinave në territorin e tyre përmes inspektorëve të mjedisit në komunë;
9. Bashkëpunimin ndërvendor midis dy ose më shumë komunave për menaxhimin e mbeturinave;
10. Përcaktimin e sasisë dhe llojit të mbeturinave që pritet të krijohen duke identifikuar llojin dhe origjinën e tyre;
11. Hartimin e skemave dhe programeve për mbledhjen e mbeturinave (nga amvisëritë, bizneset dhe industria);
12. Hartimin e programeve për grumbullimin e ndarë, sidomos grumbullimin e rrymave të rrezikshme;
13. Hartimin e propozimeve teknike të duhura në lidhje me ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave;
14. Hartimin e programeve për ngritjen e vetëdijes publike dhe edukimin në lidhje me menaxhimin e mbeturinave;
15. Vlerësimin dhe llogaritjen e kostove për aktivitetet/projektet e planifikuara për menaxhimin e mbeturinave dhe identifikimin e fondeve për zbatimin e tyre.

5.3 Vizioni i planit komunal

Gjatë procesit të hartimit të planit lokal për menaxhimin e mbeturinave, grupi i punës nga Komuna e Vitisë, përfaqësues të KRM "Eco-Higjen sh.p.k Gjilan Njësia Punuese Viti", grupi i punës i EcoDES Studio, organizata CEAE dhe GIZ Pristine zhvilloi një proces analizimi dhe diskutimesh për të formëzuar vizionin e planit.



Figura 12 Procesi i diskutimeve me grupin e punës për hartimin e planit
[Burimi: zhvillimi nga autori]

Duke iu referuar statusit aktual të menaxhimit të mbeturinave, prioritetëve të përgjithshme dhe konkrete si dhe pritshmërive lokale për zhvillimin e këtij sektori, vlerave dhe normave qytetare, realiteteve dhe sfidave, dhe dëshirës e bindjes për ndryshim, u ra dakord që vizioni i komunës të formëzohet si më poshtë:

“Komuna e Vitisë, një komunë që ofron shërbime efikase të menaxhimit të mbeturinave në të gjithë territorin e saj, duke siguruar një qëndrueshmëri financiare, mjedisore dhe sociale në komunitet”.

Nga diskutimet dhe takimet e zhvilluara me përfaqësues të Komunës së Vitisë, në sajë të analizës të gjendjes ekzistuese të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave, sëbashku me komunën u dakortësuan këto objektiva të planit:




Figura 13 Objektivat e planit të menaxhimit të mbeturinave
[Burimi: zhvillimi nga autori]

5.4 Objekti i Planit

Në bazë të legjislacionit ekzistues⁴, ky plan do të fokusohet në rrymën e mbeturinave komunale për të cilën Komuna e Vitisë është drejtëpërdrejtë apo pjesërisht përgjegjëse. Në varësi nga **ekspozimi i rrezikshmërisë** mbeturinat, sipas këtij ligji kategorizohen si: i) mbeturina inerte; ii) mbeturina të parrezikshme; iii) mbeturina të rrezikshme; dhe në varësi të **llojit mbeturinat** klasifikohen në: i) Mbeturina komunale; ii) mbeturina komerciale; iii) mbeturina industriale; iv) mbeturina medicinale.

Në lidhje me **burimet e gjenerimit të mbeturinave**, mbeturinat komunale ndahen në dy rryma mbeturinash, sipas burimit të origjinës: (MA) mbeturinat e prodhuara nga amvisëritë; (MB) mbeturinat e prodhuara nga bizneset dhe industritë, ku përbërja e mbeturinave nuk ndryshon nga karakteristikat e mbeturinave urbane.

⁴ Ligjin nr. 04/I-060 "Për menaxhimin e mbeturinave", 2012, Kreu III "Llojet – Klasifikimi dhe karakterizimi i mbeturinave", neni 6 "llojet e mbeturinave"

Plani do të fokusohet drejtëpërdrejtë në dhënien e zgjidhjes për mbeturinat e parrezikshme nga amvisëritë dhe bizneset e vogla komerciale, të cilat prodhojnë mbeturina komunale (inerte, komunale, komerciale, të vëllimshme, dhe mbeturinat nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore brenda territorit të tyre). Në lidhje me kategoritë e tjera të mbeturinave, plani do të japë disa konsiderata të përgjithshme, të cilat duhet t'i ketë parasysh për të siguruar që ato të mos hidhen nga gjeneruesit e tyre në kontenerët kolektivë.

Në diagramën më poshtë jepet skema e mbeturinave komunale, përgjegjësi e komunës për t'u menaxhuar:




Figura 14 Skema e rrëmës të mbeturinave komunale
[Burimi: zhvilluar nga autori]

Ky ligj gjithashtu, në *Kreun VI të tij "Përgjegjësitë dhe Detyrimet për Menaxhimin e mbeturinave"* përcakton përgjegjësitë dhe detyrimet për aktorët e mëposhtëm të cilët janë pjesë e ciklit të menaxhimit të mbeturinave:

- **Përgjegjësitë dhe detyrimet e zotëruesit të mbeturinave** – zotëruesi i mbeturinave është personi i licensuar përgjegjës për mbledhjen, grumbullimin, transportimin, trajtimin, përpunimin, magazinimin, riciklimin dhe deponimin e mbeturinave;
- **Përgjegjësitë dhe detyrimet e prodhuesit dhe importuesit e produkteve** - Prodhuesi i mbeturinave dhe importuesi i mallrave me potencial për krijimin e mbeturinave janë përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave të krijuara nga produktet e tij;
- **Përgjegjësitë dhe detyrimet e prodhuesit të mbeturinave** – përgjegjës për menaxhimin e plotë të mbeturinave që prodhon ose dorëzimin e tyre për trajtimin dhe deponim tek personat e licensuar;
- **Përgjegjësitë dhe detyrimet e transportuesit të mbeturinave** – ata duhet të jenë të licensuar për transportin e mbeturinave, dhe duhet të kryejnë këtë proces bazuar në kushtet e licensës për transport;

- Përgjegjësitë dhe detyrimet e operatorit për trajtimin dhe përpunimin e mbeturinave – këta operatorë duhet të jenë të licensuar për trajtimin dhe përpunimin e mbeturinave në impiantin e tyre bazuar në kushtet e licensës;
- Përgjegjësitë dhe detyrimet e operatorit në deponi të mbeturinave - këta operatorë duhet të jenë të licensuar për deponimin e mbeturinave në impiantin e tyre bazuar në kushtet e licensës.

VI. HARTIMI DHE PERSHKRIMI I MASAVE PËR TË ARRITUR OBJEKTIVAT

Plani lokal për menaxhimin e mbeturinave bazohet në 7 objektiva kryesorë, të cilët do të detajohen në aktivitete konkrete sipas afateve kohore dhe përgjegjësi përkatëse. Bazuar në analizën e kryer të gjendjes ekzistuese dhe planeve që ka komuna në të ardhmen, në plan propozohet ndarja e komunës në pesë zona funksionale të ofrimit të shërbimit.

6.1 Aktivitetet kryesore për të përmbushur OBJEKTIVIN I të planit

Si objektivi i parë, Komuna e Vitisë ka hartimin e një kuadri ligjor dhe rregullator për menaxhimin e mbeturinave. Ky kuadër do të konsistojë në konsolidimin e strukturës brenda komunës për sistemin e menaxhimit të mbeturinave, duke filluar që në vitin e parë të zbatimit të planit (viti 2020), bazuar në 5 aktivitetet kryesore si në diagramën më poshtë:




Figura 15 Aktivitetet e Objektivit I

[Burimi: zhvilluar nga autori]

Ky objektivi për komunën, konkretisht do të thotë që ajo duhet të zbatojë një sërë aktivitete dhe nën aktivitete duke filluar nga viti 2020 të listuara si më poshtë:

6.1.1 Miratimi i planit lokal të menaxhimit të mbeturinave

Aktualisht Komuna e Vitisë, në kuadër të asistencës teknike nga EcoDES Studio, si një financim i GIZ Kosovë, ka filluar procesin e hartimit të planit, ku është ngritur grupi i punës me përfaqësues nga të gjitha palët dhe kanë përfunduar analizat teknike dhe financiare të gjendjes ekzistuese. Gjithashtu janë hartuar objektivat dhe plani i veprimit, dhe plani aktualisht është në fazën e miratimit në kuvend. Duke qënë që plani ka një afat 5 vjeçar, dhe duhet të rishikohet çdo 5 vjet, është e rëndësishme ngritja e një strukture institucionale, e cila do të sigurojë hartimin, zbatimin, monitorimin dhe rishikim e tij.

6.1.2 Konsolidimi i stukturës brenda komunës

Kjo strukturë që do të krijohet në komunë do të jetë përgjegjëse për hartimin e një sërë instrumentash, të cilët do të drejtojnë organizimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave. Këto instrumenta do të fokusohen në krijimin e një inventari të plotë të klientëve (gjeneruesit e mbeturinave) në territorin e Komunës, duke u pasuar më pas në hartimin e programeve rregullatore, planifikuese dhe vetëdijësuese. Konkretisht instrumentet që duhet të zhvillojë komuna janë si më poshtë:

- Krijimi i një databaze për shërbimin/hartimi i indikatorëve
- Hartimin e fushatave vetëdijësuese
- Hartimin e projekteve për minimizimin e mbeturinave
- Hartimin e rregulloreve të brendshme/fraksione të veçanta
- Përditësimin e planit lokal të menaxhimit të mbeturinave në varësi të zhvillimeve të ndryshme
- Monitorimin e shërbimit nga zyrtari për menaxhimin e mbeturinave.

Konkretisht Komuna parashikon që në periudhën 2020-2021 të formojë Njësinë (Sektorin) për menaxhimin e mbeturinave komunale nën varësinë e Drejtorisë për Shërbimet Publike duke e plotësuar stafin e kësaj njësie me të paktën 3 zyrtarë. Në lidhje me këtë objektiv komuna duhet të parashikojë një kosto të përafërt për ngritjen e këtij sektori me stafin përkatës në shumën deri në **17,000 euro**, mjete këto që do të sigurohen qoftë nga Komuna ose ndonjë donator eventual i mundshëm.

6.1.3 Ngritja e kapaciteteve brenda komunës

- Përshkrimi i punës për çdo specialist, konkretisht për zyrtarin/zyrtarët e ambientit në komunë
- Ngritje kapacitetesh me anë të trajnimeve në vendin e punës në lidhje me aspekte të ndryshme në fushën e menaxhimit të mbeturinave:
 - a. **Moduli 1:** Planifikimi i grumbullimit, magazinimit dhe transportit të mbeturinave komunale

- b. **Moduli 2:** Minimizimi i mbeturinave: i) Minimizimi/reduktimi i mbeturinave; ii) Reduktimi i mbeturinave në burim; iii) Kompostimi i mbeturinave; iv) Ndarja dhe riciklimi i mbeturinave
- c. **Moduli 3:** Aspektet ekonomike të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave: i) Financimi i menaxhimit të mbeturinave komunale; ii) Planifikimi i sistemit të financimit të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave; iii) Hartimi i buxhetit vjetor të menaxhimit të mbeturinave; iv) Strategjia për përcaktimin e tarifave dhe mbulimin (stragjia për optimizimin e kostos)
- d. **Moduli 4:** Organizimi i shërbimeve, aspektet institucionale, rregullatore, informuese dhe monitoruese të menaxhimit të mbeturinave: i) Organizimi lokal i menaxhimit të mbeturinave; ii) Kontrolli i cilësisë së shërbimit; iii) Rregullat dhe rregullore; iv) Informimi dhe komunikimi.

Për secilin nga këto Module, mund të zhvillohen dy seanca trajnimi 2 ditore, të ndarë në pjesën teorike dhe në pjesën praktike për secilin modul. Zhvillimi i këtyre moduleve do të kërkojë angazhimin e ekspertizës së jashtme për hartimin e tyre (dy ditë përgatitore për secilin modul) si dhe zhvillimin e këtyre trajnimeve, mesatarisht 2 ditë për trajnim në varësi të kërkesës dhe nevojës. Një kosto e përafërt që komuna duhet të parashikojë për hartimin dhe organizimin e këtyre moduleve, duke llogaritur edhe kostot logjistike, llogaritet të jetë **7,200 euro**.

6.1.4 Hartimi i një sistemi monitorimi për matjen e performancës të shërbimit

- Hartimi i indikatorëve të cilësisë së shërbimit
- Krijimi i formateve të raportimit
- Krijimi i një sistemi për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave në GIS, ku do të rregjistrohen:
 - i. Të gjithë konsumatorët që janë pjesë e sistemit të inkasimit dhe mundësohen me shërbim
 - ii. Të gjitha pikat e grumbullimit kolektiv të mbeturinave, deponitë e depozitimin e mbeturinave
 - iii. Modelimi i itinerarëve që mjetet teknologjike do të kryejnë në komunë

6.1.5 Hartimi i një programi vetëdijësimi për minimizimin e mbeturinave

Komunitetet dhe nevoja për të ndryshuar sjelljen janë çështjet kyçe të një programi për parandalimin e gjenerimit të mbeturinave, megjithatë depërtimi në sjelljen e konsumatorit dhe biznesit do të rrisin efikasitetin e masave të zgjedhura. Një përjasje e integruar e këtyre masave është e domosdoshme, që në mënyrë substanciale të adresohet problemi i menaxhimit të mbeturinave dhe të ndryshohet mentaliteti dhe mënyra e menaxhimit të burimeve deri tani.

Një program për parandalimin e gjenerimit të mbeturinave në nivelin komune duhet të jetë një plan i detajuar, i cili integron interesat dhe shqetësimet e palëve të interesuara dhe të prekura (aktorëve), bazuar në një angazhim të tyre për të marrë pjesë në këtë program. Detyra kryesore e një programi për parandalimin e gjenerimit të mbeturinave është të ofrojë një vizion të përgjithshëm dhe një përjasje që mbështetet mbi iniciativat ekzistuese, duke harmonizuar dhe integruar masat plotësuese efikase dhe efektive. Për të hartuar një program të tillë është e këshillueshme që komuna të ndjekë një përjasje me hapat e mëposhtëm:

- i. Vizioni se si sistemi i përgjithshëm ekonomik i komunës, i cili gjeneron mbeturina mund dhe duhet të punojë në një periudhë - për shembull 10 vjeçare;
- ii. Objektivat të cilat do të drejtojnë programin;
- iii. Zonat prioritare se ku do të fokusohet programi;
- iv. Zgjedhja dhe kombinimi i masave që do të sjellin me efikasitet ndikime më të ulta në sistemet mjedisore.

Në secilin prej hapave fokusi fillimisht duhet të jetë i hapur për të përfshirë të gjitha opsionet efikase dhe pastaj duhet të ngushtohet drejt filtrimit të opsioneve më të efektshme. Ndërkohë që objektivat dhe masat e përzgjedhura duhet të lejojnë programin për parandalimin e gjenerimit të mbeturinave të përmbushin detyrën e tij, siç përmbledhet në figurën e mëposhtme.




Figura 16 Detyrat e programit të parandalimit të mbeturinave
[Burimi: adoptuar nga Jackon 2005⁵]

⁵Jackon, T. (2005): Motivating sustainable consumption. Sustainable Development Commission, Stirling, UK.

Nisur nga sa më lart komuna duhet të hartojë dhe promovojë një strategji për parandalimin e gjenerimit të mbeturinave bazuar në tre shtylla kryesore: i) Programet e informimit; ii) Programet e promovimit; iii) Programet rregullatore. Në figurën më poshtë mundësohet një informacion më i zgjeruar në lidhje me tre shtyllat e kësaj strategjie:




Figura 17 Kategoritë e Strategjisë për parandalimin e mbeturinave [Burimi: zhvilluar nga autori]

Disa prej masave kryesore që komuna mund të zhvillojë janë:

- Ndërtimi i kapaciteteve brenda komunës për të asistuar aktivitetet e parandalimit të gjenerimit të mbeturinave për komunitetin dhe aktivitetet tregëtare
- Analiza e gjenerimit të mbeturinave në territorin e komunës
- Përgatitja e fushatave për parandalimin e mbeturinave bazuar në kushtet lokale
- Hartimi dhe prezantimi i iniciativave drejtuar amvisërive, bizneseve dhe autoriteteve lokale për reduktimin e gjenerimit të mbeturinave
- Programi për parandalimin e mbeturinave nga ambalazhi – ndihmon bizneset për të minimizuar përdorimin e materialeve të ambalazhit
- Programi për minimizimin e mbeturinave në ambientet e punës dhe për të rritur përdorimin e materialeve të ndërtimit dhe riciklimin e tyre
- Prezantimi i skemave të menaxhimit mjedisor për bizneset lokale për të mbështetur reduktimin e mbeturinave
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e një platforme në faqen e internetit të komunës për parandalimin e gjenerimit të mbeturinave, duke dhënë informacionin e mëposhtëm:
 - Shpjegime për principin e parandalimit të gjenerimit të mbeturinave: (përkufizimi, mjetet, instrumentat dhe mekanizmat për arritjen e tij)
 - Udhëzues për parandalimin e gjenerimit të mbeturinave në shtëpi dhe në zyra
 - Udhëzues për realizimin e kompostit individual

- Promovimi i përmirësimit të infrastrukturës për ripërdorimin e produkteve të ndryshme (ndërtimi i një rrjeti dyqanesh të dorës së dytë) shoqëruar me publikimin e udhëzuesëve për riparimin, riciklimin dhe rishitjen e produkteve.

Në lidhje me fushatën e ndërgjegjësimit, një kosto e përafërt e llogaritet të jetë **2,400 euro** në vit, ku komuna duhet të: i) parashikojë anagazhimin e asistencës së jashtme për hartimin e tre programeve (informim, promovim dhe rregullator) për një periudhë kohore 30 ditë pune; ii) realizimin e këtyre programeve gjatë gjithë vitit kalendarik, duke angazhuar 2 persona staf, të cilët duhet të dedikojnë 5 ditë pune në muaj për realizimin e secilit program.

Në tabelën më poshtë përmbledhen këto kosto sipas afatave kohore të prioriteteve:

Kosto 6.1 Aktiviteti	Konsolidimi dhe shtrirja e shërbimit	
	Kosto (euro)	Koha e zbatimit
Konsolidimi i strukturës brenda komunës (ngritja e Sektorit për menaxhimin e mbeturinave)	17,000 €	2020
Ngritja e kapaciteteve brenda komunës (module trajnimi)	7,200 €	2020-2021
Fushatë ndërgjegjësimi	2,400 €	2021
Kosto totale	26,600 €	

Tabela 8 Përmbledhja e kostove për konsolidimi i strukturës brenda komunës për sistemin e menaxhimit të mbeturinave
[Burimi: zhvilluar nga autori]

6.2 Aktivitetet kryesore për të përmbushur objektivin II të planit

Objektivi i dytë i planit lidhet me konsolidimin e shërbimit në zonat ku ofrohet dhe zgjerimi i shërbimit në zonat ku aktualisht nuk ofrohet shërbim (në masën 100%) gjatë periudhës 5 vjeçare të planit (2020-2024). Aktualisht 10 fshatra të komunës nuk kanë fare shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave, dhe në total në të gjithë territorin e komunës 50% e klientëve nuk janë në sistem dhe nuk mbulohen me shërbim. Dy mënyrat për të matur realizimin e këtij objektivi lidhen me sasinë e mbeturinave të gjeneruara kundrejt atyre të grumbulluara, ose me numrin e klientëve të shërbyer kundrejt totalit të tyre:

- A. Përqindja e sasisë së mbeturinave të grumbulluara kundrejt sasisë totale të mbeturinave të prodhuara.

$$Obj. 2 = \frac{\text{Sasia e mbet. te grumbulluara} \left(\frac{ton}{vit}\right)}{\text{Sasia e mbet. te prodhuara} \left(\frac{ton}{vit}\right)} \times 100$$

- B. Përqindja e nr. të klientëve të shërbyer kundrejt nr. të përgjithshëm të klientëve.

$$Obj. 2 = \frac{\text{Nr i klienteve te sherbyer}}{\text{Nr e te gjithë klienteve}} \times 100$$

Aktualisht në Komunën e Vitisë, nga 7,520 klientë (amviseri, biznese dhe institucione), 3,404 janë në sistem dhe marrin shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave, ose 45% e klientëve. **Aktivitetet konkrete** që propozohen për këtë skenar kanë të bëjnë me një sërë masash për të zgjeruar shërbimin aty ku nuk ofrohet, dhe konsolidimin e tij në zonat ku ofrohet shërbimi.

6.2.1 Zgjerimi i shërbimit të ofruar në amvisëritë të cilat nuk mundësoheshin me shërbim

Veprimet konkrete që do të kryejë komuna në këtë rast janë:

- a. Analizimi i mundësive dhe mjeteve financiare të nevojshme që i nevojiten kompanisë për të zgjeruar shërbimin kundrejt të ardhurave që do të gjeneronin.
- b. Analizimi i klientëve dhe efektivitetit (propabilitetit) në mbledhjen e të ardhurave në zonat ku do të zgjerohet shërbimi.
- c. Bazuar mbi rezultatet e dy studimeve të mësipërme, komuna orienton kompaninë dhe bashkëpunon me të se ku do të zgjerohet shërbimi sipas një kalendari të planifikuar (harton kalendarët dhe strategjitë e ndërhyrjes). Ky mund të jetë rasti ku komuna mund të krijojë terren për të kërkuar nga Kompania që t'i rrisë kapacitetet njerzore dhe mekanike nëse shihet si e nevojshme
- d. Përcaktimi i numrit të konteinerëve, koshave, shportave, tipi dhe kapaciteti i tyre, numri i makinave, kapaciteti, tipi i tyre dhe puntorëve shtesë që nevojiten.

Bazuar në të dhënat e Komunës dhe Kompanisë 10 fshatra në territorin e komunës aktualisht janë pa shërbim. Komuna parashikon që gjatë 5 vjeçarit në vazhdim, të shtrijë shërbimin në këto fshatra plotësisht deri në fillim të vitit 2024. Ky zgjerim shërbimi do të konsistojë në një fushatë masive për futjen në sistem të klientëve që ende nuk janë në sistem si dhe zhvillimin e fushatave për vetëdijësimin e komunitetit për të paguar tarifën e shërbimit.

Bazuar në këtë objektiv Komuna ka parashikuar një sërë masash konkrete në lidhje me zgjerimin e shërbimit, për të cilat është përcaktuar edhe buxheti përkatës:

- Komuna parashikon riorganizimin e pikave të grumbullimit të mbeturinave në zonën urbane, bazuar në udhëzimet kombëtare dhe lokale. Ndonëse sipas komunës komuniteti është përgjegjës vetë në lidhje me mënyrën se si ai i grumbullon mbeturinat në banesën e tij, për komunën ka interes që ky shërbim të jetë i rregulluar dhe sa më i qëndrueshëm. Për këtë arsye, komuna kërkon që të shtrijë shërbimin në të gjithë territorin e saj, duke përfshirë në sistem të gjithë klientët që operojnë në territorin e saj. Aktualisht komuna do të shtrijë shërbimin në 4,116 amvisëri dhe në 485 biznese, të cilat nuk janë në sistem. Nisur nga mënyra e organizimit të shërbimit në komunë, për të siguruar qëndrueshmëri të shërbimit dhe cilësi sa më të lartë, komuna do të duhet të shpërndajë shporta 240 litra amviserive që nuk janë në sistem, si dhe të mundësojë konteinerë 1.1 m³ për bizneset që do të hyjnë në sistem. Konkretisht më poshtë shpjegohet se si komuna do të kryejë këtë proces:

Shtrirja e shërbimit në amviseri:

- Në këtë kuadër komuna duhet të prioritarizojë shtrirjen e shërbimit në ato fshatra, ku aktualisht ofrohet shërbimi, por jo në të gjitha amvisëritë e zonës, dhe më pas ta shtrijë në fshatrat ku

aktualisht nuk ka shërbim. Komuna mund të zgjedhë që investimin, të cilin mund ta kryejë vetë, ose me donatorë⁶, për këta klientë ta ndajë në katër faza, gjatë 5 vjeçarit të zbatimit të planit:


- Shtirja e shërbimit në 1,000 amviseri në fshtatrat në të cilat shërbimi kryhet 2020-2021
- Shtirja e shërbimit në 1,000 amviseri në fshtatrat në të cilat shërbimi kryhet 2021-2022
- Shtirja e shërbimit në 1,000 amviseri në fshtatrat të cilat aktualisht nuk kanë shërbim 2022 -2023
- Shtirja e shërbimit në 1,116 amviseritë e mbetura në territorin e Komunë së Vitisë 2023-2024

Në skemat mëposhtë jepen kostot e investimit që potencialisht komuna, kompania, donatorët apo vetë komuniteti duhet të alokojë për të përmbushur objektivin për shtirje e shërbimit me infrastrukturë grumbulluese me kontenierë 240 litra:



Figura 18 Shporta 240 litra
[Burimi: faqe interneti]

Rasti I



Rasti II

⁶ Komuniteti mund të zgjedhë që investimin ta kryejë vetë dhe të jetë pjesë e sistemit

Amvisëri me shërbim: 4,404	Amvisëri me shërbim në të ardhmen: 5,404	Nevoja totale për shporta 240litra: 1,000 shporta
Kosto mesatare e një shporte 240litra		25euro/copa
Kosto totale e investimit për amviseritë që janë në sistem $25\text{euro/copa} \times 1,000 = 25,000 \text{ euro}$		

Rasti III

Amvisëri me shërbim të pajisur me shporta: 5,404	Amvisëri me shërbim në të ardhmen: 6,404 amvisëri	Nevoja totale për shporta 240litra: 1,000 shporta
Kosto mesatare e një shporte 240litra		25euro/copa
Kosto totale e investimit për amviseritë që janë në sistem $25\text{euro/copa} \times 1,000 = 25,000 \text{ euro}$		

Rasti IV

Amvisëri me shërbim të pajisur me shporta: 6,404	Amvisëri me shërbim në të ardhmen: 7,520 amvisëri	Nevoja totale për shporta 240litra: 1,116 shporta
Kosto mesatare e një shporte 240litra		25euro/copa
Kosto totale e investimit për amviseritë që janë në sistem $25\text{euro/copa} \times 1,116 = 27,900 \text{ euro}$		

Shtrirja e shërbimit në biznese dhe institucione:

Ndërkohë 485 biznese në komunë nuk janë në sistem dhe nuk marrin shërbim. Në kuadër të objektivit për të shtrirë shërbimin në të gjithë territorin e saj dhe për të futur në sistem edhe këto biznese, komuna duhet të mundësojë pajisjen me kontenerë 1.1 m^3 , siç aplikohet edhe në bizneset që aktualisht janë në sistem. Potencialisht komuna, kompania ose me fonde të donatorëve duhet të

bëjë një investim për të paktën 485 kontenerë 1.1 m^3 , për të ofruar shërbimin në këto biznese dhe institucione që do të hyjnë në shërbim për periudhën 2020 - 2023

Biznese me shërbim të pajisur me kontener 1.1m^3 : 315	Biznese me shërbim në të ardhmen: 800 amvisëri	Nevoja totale për kontenerë 1.1m^3 : 485 konteneirë
Kosto mesatare e një konteneri 1.1m^3		300 euro/copa
Kosto totale e investimit për amviseritë që janë në sistem $300 \text{ euro/copa} \times 485 = 145,500 \text{ euro}$		

- 6.2.2 Konsolidimi i shërbimit të ofruar, në zonat ku aktualisht ai afrohet. Veprimet konkrete në këtë rast do të jenë:
- Analizimi i kohës së nevojshme për grumbullim dhe transportin e mbeturinave.
 - Analizimi i distancave të përshkruara dhe ri-modelimi i intenerarëve dhe optimizimi i rrugës së transportit (kontener – deponi).
 - Standartizimi i shërbimit (grumbullim derë më derë me konteinerë 240 litra; dhe grumbullimi kolektiv me konteinerë 1.1m^3). Përmirësime në infrastrukturën e pikave të grumbullimit (konteinerë të rinj/riparuar, shporta individuale, bazamente për mbajtjen e konteinerë ve, makina të reja... etj).

Ndonëse Komuna e Vitisë e ofron shërbimin në 3,404 amvisëri, këto amviseri nuk janë të pajisura me shporta, dhe grumbullimin e mbeturinave në ambientet e tyre e bëjnë sipas mënyrës së tyre. Komuna ka si objektiv konsolidimin e shërbimit në këto zona, duke ofruar një infrastrukturë sa më bashkëkohore dhe të qëndrueshme. Për këtë arsye komuna, në sajë të fondeve të saja, të kompanisë, donatorëve të ndryshëm, apo edhe vetë investimeve që mund të bëjë komuniteti, do të duhet të bëjë një investim, për të pajisur këto klientë me infrastrukturën grumbulluese të mbeturinave. Në skemën më poshtë jepet një llogaritje e koston potenciale investimi për mbullimin me infrastrukturë, për grumbullimin e mbeturinave në amviseritë që janë në sistem në Komunën e Vitisë për periudhën 2021-2024. Komuna mund të zgjedhë që këtë investim ta bëjë në vitin e fundit të zbatimit të planit, duke prioritarizuar investimet në ato amviseri të cilat nuk janë në sistem, dhe më pas të zgjedhë investimin në këto zona që janë në sistem:

Amvisëri me shërbim por pa shporta: 3,404	Amvisëri me shërbim në të ardhmen me shporta: 3,404	Nevoja totale për shporta 240litra: 3,404 shporta
Kosto mesatare e një shporte 240litra		25euro/copa
Kosto totale e investimit për amvisëritë që janë në sistem 25euro/copa x 3,404 =85,100 euro		

Në tabelën më poshtë përmblihen këto kosto sipas afatave kohore të prioriteteve:

Kosto 6.2 Aktiviteti	Konsolidimi dhe shtrirja e shërbimit	
	Kosto (euro)	Koha e zbatimit
Raundi I: Futja në sistem e 1000 amviserivë të reja (shporta 240 litra)	25,000 €	2020-2021
Raundi II: Fitja në sistem e 1000 amviserive të reja (shporta 240 litra)	25,000 €	2021-2022
Raundi III: Futja në sistem e 1,116 amviserive të reja (shporta 240 litra)	27,900 €	2022-2023
Futja në sistem e 485 bizneseve dhe institucioneve që nuk janë në sistem (konteneir 1.1m ³)	145,500 €	2020-2023
Konsolidimi i shërbimit në amvisëritë që janë në sistem (shporta 240 litra)	85,100 €	2021-2024
Kosto totale	305,600 €	

Tabela 9 Përmbledhja e kostove për investimet për konsolidimin dhe zgjerimin e shërbimit [Burimi: zhvilluar nga autori]

6.3 Aktivitetet kryesore për të përmbushur objektivin III të planit

Ky objektivi ka si qëllim nxitjen e iniciativave për minimizimin e mbeturinave përmes stimulimit të grumbullimit të diferencuar dhe kompostimit individual në familjet rurale. Komuna parashikon që të ulë sasinë e mbeturinave që shkojnë në deponi me 20% deri në fund të vitit 2024. Bazuar në numrin e popullsisë, shtimit natyror të popullsisë 1.2%, normës së gjenerimit të mbeturinave (0.6 kg/banorë/ditë), dhe përqindjet e fraksioneve të rrymës së mbeturinave, në tabelën më poshtë është bërë një llogaritje e sasisë së mbeturinave që komuna mund të largojë nga rryma e përgjithshme gjatë periudhës 2020-2024, në zona të caktuara, kryesisht në qytetin e Vitisë për riciklimin, dhe në fshatra për kompostimin e mbeturinave organike. Komuna në varësi të prioriteteve të saja, mund të zgjedhë që këtë objektivi ta fillojë ta zbatojë në vitet e fundit të planit, pasi kërkon një shtrirje dhe konsolidim të shërbimit në territorin e saj, përsa kohë vetëm 50% e klientëve mbulohet me shërbim. Megjithatë, për komunën ka rëndësi të dijë se si do të jetë projeksioni i

minimizimit të mbeturinave deri në fund të vitit 2024, nëse kërkon të plotesoje objektivin për të reduktuar me 20% sasinë e mbeturinave që shkon në deponi:

Viti		2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Projeksioni i rritjes së popullsisë (1.2%)	n.r.	46,987	47,551	48,121	48,699	49,283	49,875	50,473
Projeksioni i rritjes së sasisë së mbetjeve (ton) (1.2%)	% sipas rrymave	10,290	10,414	10,539	10,665	10,793	10,923	11,054
%e riciklimit në vit			5%	10%	15%	20%	20%	20%
Organike	42.66%	4,390	4,442	4,496	4,550	4,604	4,660	4,715
Organi për kompostim (ton/vit)			222	450	682	921	932	943
Organike për depozitim (ton në vit)			4,220	4,046	3,867	3,683	3,728	3,772
Të riciklueshme (ton/vit)	37.3%	3,834	3,880	3,927	3,974	4,021	4,070	4,119
Të riciklueshme për riciklim (ton/vit)			194	393	596	804	814	824
Të riciklueshme për depozitim (ton/vit)			3,686	3,534	3,378	3,217	3,256	3,295
Mbeturina të tjera (ton/vit)	15.16%	1,560	1,579	1,598	1,617	1,636	1,656	1,676

Tabela 10 Projeksioni i gjenerimit të mbeturinave dhe minimizimit të tyre gjatë 5 viteve të ardhshme [Burimi: zhvilluar nga autori]




Figura 19 Sasia e mbeturinave të riciklueshme që parashikohet të largohet nga rryma e mbeturinave [Burimi: zhvilluar nga autori]




Figura 20 Sasia e mbeturinave organike që parashikohet të largohet nga rryma e mbeturinave [Burimi: zhvilluar nga autori]

Komuna duhet të përcaktojë grupin e saj të punës, i cili do të jetë përgjegjës për: i) Hartimin dhe zhvillimin e planit të veprimit për skenarët e minimizimit të mbeturinave, si riciklimi dhe kompostimi; ii) Hartimin e fushatave vetëdijësuese/programë edukimi/informimi. Konkretisht Komuna duhet të fokusohet në dy drejtime në lidhje me zbatimin e këtij objekti: i) Hartimi i projekteve pilote për minimizimin e mbeturinave; ii) Hartimi i programit të minimizimit të mbeturinave.

6.3.1 Hartimi i projekteve pilote për minimizimin e mbeturinave

- Kompostimi individual tek amviseritë në zonën ku shërbimi jepet derë më derë. Projektet pilot për minimizimin e mbeturinave, për Komunën e Vitisë më të preferuarat janë ato që lidhen me kompostimin e fraksioneve organike të mbeturinave sesa riciklimi i mbeturinave (plastika, qelqi, letra, alumini) në njësitë familjare.*

Më konkretisht për komunën propozohet: i) Përcaktimi i zonave (të paktën 3 - 5 fshatra/zona periferike) ku do të aplikohet komposti individual; ii) Hartimi i fushatës së komunikimit dhe konsultimit me banesat ku do të aplikohet kompostimi – vlerësimi i gadishmërisë dhe njohurive të tyre; iii) Hartimi i termave të referencës dhe përgatitja e tenderit për investimet në infrastrukturë (komposterët individualë); iv) Identifikimi i klientëve të interesuar për t'u përfshirë në skemën e kompostimit dhe ndërtimi i një database; v) Hartimi i politikave lehtësuese dhe stimuluese për shtimin e klienteve në skemë.




Figura 21 Komposter për mbeturinat organike [Burimi: zhvilluar nga autori]

6.3.2 Hartimi i programit të minimizimit të mbeturinave

- b. *Riciklimi – Hartimi i një programi riciklimi për bizneset si supermarketet/qendra tregtare/kafenetë etj.* Komuna duhet të ketë një program konkret në lidhje me subjektet tregtare, të cilët janë të disponueshme të bëhen pjesë e projektit pilot për riciklimin e mbeturinave. Më konkretisht propozohet: i) Caktimi i subjekteve të cilat do të grumbullojnë në mënyrë të diferencuar mbeturinat; ii) Caktimi i rrymave që do të grumbullohen (leter, karton, plastikë, alumin); iii) Analizimi i sasisë dhe ndërtimi i skemës së grumbullimit; iv) Përcaktimi i subjektit që do të bëjë grumbullimin dhe magazinimin e materialeve të riciklueshme; v) Hartimi i një fushate informuese për mënyrën e funksionimit. Këto programe janë pjesë e programit të komunës për vetëdijësimin, ku kostot janë parashikuar në pikën 6.1.5.

Komuna ka parashikuar si objektiv afat mesëm hartimin e një politike, e cila do të përcaktojë infrastrukturën për fillimin e riciklimit. Ky aktivitet parashikohet të fillojë në fillim të vitit 2021 me një buxhet fillestar prej **1,000 euro**.

Në të njëjtën kohë komuna mund të parashikojë fillimin e këtij projekti pilot, në 30 biznese të caktuara, të cilët janë më të predispozuar për të ricikluar fraksione të mbeturinave si letër, karton, plastikë, qelq apo alumin, dhe t'i mundësojë atyre një bashkëpunim me kompaninë, duke i mundësuar nga 1 kontenier 240litra. Kosto e investimit për kontenierë parashikohet të jetë 30x30euro/copa = 900 euro. Ndërkohë nisur nga fakti që aktualisht kompania nuk ka një mjet për grumbullimin e veçantë të këtyre mbeturinave, komuna së bashku me kompaninë duhet të parashikojë edhe blerjen e një mjeti të ri me një vlerë të përafërt **40,000 euro**.

- c. *Riciklimi – hartimi i një programi Drop off system në qytetin e Vitisë.* Këto pika do të shërbejnë si pika grumbullimi, ku bizneset apo njësitë tregtare, të cilët janë të interesuar për riciklimin e mbeturinave, mund t'i sjellin ato në këto pika/qendra. Si fillim rekomandohet që komuna të ngrejë vetëm një qendër në një zonë shumë pranë njërive tregtare për të testuar këtë iniciativë. Më konkretisht propozohet: i) Caktimi i pikave ku do të grumbullohen materialet e riciklueshme të thata/hartimi i projektit për ndërtimin e tyre dhe mënyrën e funksionimit; ii) Caktimi i rrymave që do të grumbullohen (letër, karton, plastikë, alumin); iii) Analizimi i sasisë dhe çmimit për çdo rrymë; iv) Hartimi i një fushate informuese për mënyrën e funksionimit; v) Përcaktimi i subjektit që do të bëjë grumbullimin dhe magazinimin e materialeve të riciklueshme.

Në lidhje me këtë sistem, komuna mund të zgjedhë për ndërtimin e një pike grumbullimi, ku duhet të parashikojë kosto në lidhje me platformën/ndërtesën e pikës së grumbullimit, 3-4 kontenierë për grumbullimin e mbeturinave që vijnë në sistem, peshoren, si dhe kosto administrative që lidhen me punonjësit që do të anagazhohen dhe kosto të konsumit të energjisë etj. Gjithësej ky investim nuk duhet të kalojë një vlerë më shumë se **15,000 euro**.

- d. Pasi të hartohet politika dhe të vihet në funksionim sistemi i riciklimit, Komuna parashikon që të fillojë organizimin dhe mbikqyrjen e procesit të riciklimit dhe ndarjes në burim të mbeturinave, me një kosto fillestare **2,800 euro**.

Në tabelën më poshtë përmbledhet kosto e plotë për Objektivin III:

Kosto 6.3 Aktiviteti	Minimizimi i mbeturinave	
	Kosto (euro)	Koha e zbatimit

Hartimi i politikës për minimizimin e mbeturinave	1,000 €	Fillon në Janar 2021
Zbatimi i projektit pilot për riciklimin	40,900 €	Fillon në Janar 2021
Ndërtim i sistemit drop off	15,000 €	Fillon në Janar 2022
Procesi i monitorimit të riciklimit	2,800 €	2023-2024
Kosto totale	59,700 €	

Tabela 11 Kosto e investimit për minimizimin e mbeturinave
[Burimi: zhvilluar nga autori]

6.4 Aktivitetet kryesore për të përmbushur objektivin IV të planit

Nisur nga sa u tha me lart dhe evidentimit të situatës ekzistuese në Komunë e Vitisë, niveli i inkasimeve gjatë vitit 2019 ishte pothuajse 100% nga të gjithë konsumatorët që janë në sistemin e inkasimit. Rritja e nivelit të inkasimeve nga tarifat në zonat ku ofrohet shërbimi deri në masën 100% gjatë periudhës 2020 – 2021 është një ndër objektivat, të cilin komuna përpiqet që çdo vit ta zbatojë, duke u fokusuar në forcimin e kapaciteteve për grumbullimin e tarifës dhe në rritjen e numrit të klientëve që paguajnë tarifën. Gjithashtu, komuna në sajë të objektivit për të shtrirë shërbimin në zonat ku aktualisht nuk ofrohet, duke futur klientë në sistem, ajo synon që të arrijë një inkasim të tarifës në masën 100% në fund të pesëvjeçarit të planit në vitin 2024. Në lidhje me këtë objektivi propozohen që të zhvillohen veprimet konkrete si mëposhtë:

6.4.1 Forcimi i kapaciteteve për inkasimin e tarifës

- a. Për çdo zonë kompania/komuna do të krijojë/konsolidojë rregjistrat e përfitueseve të shërbimit, me kontratat ekzistuese, duke i kategorizuar dhe përditësuar ato çdo vit
- b. Kompania/komuna identifikon dëshirën për të paguar (cilët janë faktorët që i motivojnë ose dekurajojnë për të paguar) nga konsumatorët, duke realizuar fushata me pyetësorë, ose takime individuale me konsumatorët komercialë
- c. Krijimin e grupeve të këshillimit, të cilët veprojnë në çdo fshat përmes takimeve me komunitetin
- d. Analizimin e skenarëve për mbulimin e kostos nga të ardhurat e tarifave të mbeturinave, duke marrë në konsideratë grupet e marginalizuara
- e. Komuna përcakton tarifën për mbeturinat bazuar në koston e plotë të llogaritur të shërbimit në territorin e saj.
- f. Funkcionalizimin i sistemit të faturimit dhe inkasimit në kuadër të Njesisë (Sektorit) për Menaxhimin e Mbeturinave, nën varësi të Drejtorisë për Shërbime Publike – ky është një objektivi që komuna e ka parashikuar ta realizojë deri në fund të vitit të pestë të planit, duke parashikuar një buxhet vjetor prej **10,000 euro**, që do të mundësojë pagesën dhe ambientet për inkasantët.

6.4.2 Rritja e numrit të klientëve që paguajnë tarifat

- a. Krijimin e një sistemi të qartë procedurash për mbledhjen e tarifave si dhe bërja transparente e tarifave për çdo grup që përfiton shërbimin në mënyrë të personalizuar

- b. Ndërmarrja e fushatave vetëdijësuese për rritjen e inkasimeve
- c. Ndërimi dhe funksionalizimi i mekanizmit që mundëson faturimin e të gjithë klientëve që marrin shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbeturinave
- d. Përgatitja e një studimi mbi sistemet e grumbullimit të tarifave për amvisëritë, bizneset dhe institucionet (p.sh. komuna mbledh taksat vetë ose përmes agjentëve)
- e. Stimulimi i pagesve të rregullt përmes politikës fiskale lehtësuese
- f. Dizajni dhe prezantimi i logos së gjelbër për bizneset që riciklojnë/kompostojnë/që paguajnë rregullisht.

Objektivat e përmendur më lart janë objektiva afatshkurtër dhe afatmesëm, të cilat komuna angazhohet që t'i zbatojë gjatë 5 vjeçarit të zbatimit të planit. Ndërkohë gjatë këtyre 5 viteve që komuna do të konsolidojë kapacitetet për llogaritjen e plotë të kostos, grumbullimin e tarifës dhe rritjen numrit e klientëve në sistem, ajo ka krijuar bazën për të kaluar në fazën e hartimit të një politike për mbulimin e kostos dhe startegjinë për vjeljen e tarifës. Konkretisht ajo çfarë duhet të bëjë komuna si pjesë e angazhimit të saj afatgjatë në këto dy drejtime sqarohet më poshtë:

Politika e mbulimit të kostos: 'Mbulimi i kostos përfshin një sistem tarifash dhe taksash, të cilat kanë si qëllim specifikisht të mbulojnë disa ose të gjitha kostot e ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave nga përdoruesit e këtij shërbimi, në përputhje me principin "ndotësi – paguan". Avantazhet e sistemit të mbulimit të kostos qëndrojnë në faktin se të gjitha kategoritë e klientëve të shërbimit njihen me koston e plotë të tij, janë të përfshirë në mënyrë më të drejtëpërdrejtë me problemet e cilësisë së shërbimit, vlerësojnë peshën që merr pagesa e tarifës së tyre në inkasimin e të ardhurave si dhe mundësitë reale të komunave për t'u ofuar klientëve këtë shërbim. Hartimi i politikave të mbulimit të kostos është përgjegjësi e komunave dhe synon të përcaktojë nivelin e rikuperimit të kostos që duhet të arrihet për një periudhë të caktuar kohore, duke përcaktuar më parë:

- Llogaritjen e kostos së plotë të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave komunale
- Planifikimin e buxhetit të komunës mbi këtë kosto
- Përcaktimin e tarifave për kategoritë e ndryshme që përfitojnë shërbimin bazuar mbi nivelin e rikuperimit të kostos të përcaktuar
- Procedurat e zbatimit dhe monitorimit

Ndërkohë që literatura dhe eksperiencia tregojnë shtatë opsionet për objektiva të ndryshme të mbulimit të kostos, komuna duhet të hartojë objektivat e saj të rikuperimit të kostos duke vlerësuar më parë kushtet në të cilat ndodhen (analiza e plotë financiare) si dhe më pas duke u konsultuar në mënyrë të vazhdueshme me ofruesin e shërbimit për të përcaktuar në mënyrë të qartë çfarë do të thotë kosto e plotë e shërbimit.

Në figurën e mëposhtme është paraqitur në një rend progresiv i opsioneve të mbulimit të kostos:




Figura 22 Opsionet e mbulimit të kostos së shërbimit të menaxhimit të integruar të mbeturinave [Burimi⁷: përshtatur nga autori]

Konkretisht komuna duke analizuar gjendjen e saj mund të kuptojë se në cilat nga këto opsione ajo është aktualisht dhe ku ajo kërkon të shkojë, në sajë të objektivave që ajo do të vendosë:




Figura 23 Përshkrimi i opsioneve të mbulimit të kostos [Burimi: zhvilluar nga autori]

⁷Eilson D. Ehitman A. Tormin A. 2001 Strategic Planning Guide for Municipal Solid Waste management. DFID and World Bank Version 2 March 2001

Megjithatë për të ndërtuar një politikë të qëndrueshme dhe mbi të gjitha të zbatueshme të rikuperimit apo mbulimit të plotë të kostos, komuna ka nevojë për një bashkëpunim me nivelin qendror të politikë bërjes. Kështu në nivelin qendror duhet të zhvillohen standartet e ofrimit të shërbimit për të pasur një kuptim të përbashkët për të gjitha komunat për nivelin e ofrimit të shërbimit. Vetëm në këtë mënyrë mund të kemi procedura të standartizuara për monitorimin e shërbimit si dhe nivele të standartizuara (klasa) të krahasueshme në ofrimin e tij. Gjithashtu duhet të hartohen guidat e reja të përgatitjes së buxhetit sipas "qëndrave të buxhetimit apo të kostos" për elemente të veçantë të shërbimit të mbeturinave (grumbullim, transport, riciklim, programe ndërgjegjësimi etj). Vetëm në këtë mënyrë komuna do të ketë mundësi të njohë koston e plotë të shërbimit që ajo ofron.




Figura 24 Hapat që duhen ndjekur për të zbatuar politikën e rikuperimit të kostos
[Burimi: zhvilluar nga autori]

Strategjia për vjeljen e tarifave: Bazat për qëndrueshmërinë financiare të shërbimeve të mbeturinave mund të arrihen nëpërmjet sigurimit të shërbimeve efektive dhe me kosto eficiente, si dhe me sigurimin e një sistemi të qëndrueshëm financiar të bazuar në një politikë të drejtë dhe efektive të rikuperimit të kostos. Aspektet financiare janë thelbësore për shërbimet dhe për qëndrueshmërinë. Performanca financiare është e lidhur me përmbushjen e objektivave mbi çështjet financiare dhe matet nëpërmjet disa treguesve financiarë që shqyrtohen përmes pyetjeve të mëposhtme:

- *Sa i mbulon buxheti vjetor shpenzimet që rezultojnë nga nevojat (përkatësisht kostot kapitale, kostot operative, apo kostot e amortizimit)?*
- *Sa të ndryshme janë tarifat e miratuara në krahasim me ato që janë parashikuar në procesin e planifikimit?*
- *Sa inkasohet dhe sa është pjesa e të hyrave nga shuma e faturuar?*
- *Sa nga buxheti në përqindje mbulohet prej të hyrave?*
- *Cili është raporti i mbulimit të shpenzimeve nga tarifat e mbeturinave dhe të hyrave specifike komunale?*

- Sa të gatshëm janë konsumatorët (amvisëritë, bizneset etj.) për të paguar për një shërbim më të mirë?

Në figurën e mëposhtme paraqitet në mënyrë të detajuar strategjia për mënyrën e vjeljes së tarifave që Komuna Vitisë mund të zbatojë:




Figura 25 Strategjia për vjeljen e tarifave
[Burimi: zhvilluar nga autori]

- *Regjistrimi i konsumatorëve*, që është edhe hapi i parë, përfshin identifikimin e të gjitha subjekteve që përfitojnë shërbimin e menaxhimit të mbeturinave, kategorizimin e tyre sipas karakteristikave (tipi, madhësia, natyra e mbeturinave që gjenerojnë, sasia, etj.) duke synuar ngritjen dhe mirëmbajtjen e një sistemi të përditësuar të dhënash brenda kufijve të komunës. Ky sistem duhet të kontrollohet rregullisht të paktën *një herë në vit* për të reflektuar të gjitha lëvizjet e popullsisë si dhe regjistrimin e të gjitha bizneseve të reja.
- *Komunikimi me konsumatorët* që përfitojnë shërbimin është një moment tjetër shumë i rëndësishëm në ndërtimin e një sistemi efikas në vjeljen e tarifave. Ky hap synon diferencimin e tarifave për konsumatorët e ndryshëm të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave si dhe lidhja e tarifës me nivelin e cilësisë të shërbimit. Marrja e opinionit qytetar përmes pyetësorëve në lidhje me cilësinë e shërbimit të ofruar synon jo vetëm evidentimin e problemeve, por ka për qëllim

edhe matjen e dëshirës dhe mundësive për të paguar duke kontribuar në krijimin e një sistemi të qartë procedurash për hartimin dhe vjeljen e tarifave. Një pikë tjetër e rëndësishme përsa i përket komunikimit me konsumatorët është bërja transparente e tarifave përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit (media e shkruar dhe vizive, ëeb site etj).

- Pjesa më e madhe e autoriteteve vendore e kryejnë vetë procesin e *vjeljes së tarifave* nëpërmjet zyrave të tyre vendore të taksave apo drejtorisë vendore të taksave dhe tarifave. Ndonjëherë tarifën e mbeturinave vendosen së bashku me tarifën e tjera vendore (të tilla si fatura e furnizimit me ujë) apo taksa të tjera vendore (tatimi mbi pronën) brenda së njëjtës fature. Megjithatë komuna mund të caktojë përgjegjësinë e mbledhjes së tarifave një agjenti të jashtëm publik ose privat. Në këtë rast është shumë e rëndësishme hartimi i marëveshjeve dhe monitorimi i tyre. Si shërbime publike bazë, për të aplikuar një faturim të kombinuar mund të jenë: për shembull: energjia elektrike, telefonia, ose ujësjellësi. Faturat e dërguara tek konsumatori përfshijnë dy vija buxhetore detyrimi për të paguar, një për shërbimin e infrastrukturës të ofruar nga shoqëria e shërbimeve "bazë" dhe zëri tjetër për tarifën e mbeturinave. Për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit është e rëndësishme që të hartohen edhe disa mekanizma të rëndësishëm, duke filluar me mjetet e njoftimit për t'i bërë konsumatorët më të vetëdijshëm për përgjegjësinë ose detyrimin për të paguar, deri në aplikimin e mjeteve të zbatimit të tilla si sanksionet, gjobat, etj.
- Hapi i fundit, por jo më pak i rëndësishëm është edhe *detyrimi* i cili përfshin ngritjen e një sistemi me struktura adekuate kontrolli, të cilat do të hartojnë masat dhe sanksionet në rastet e mospagimit. Krijimi i strukturave të tilla me detyra dhe përgjegjësi të qarta duhet të jetë subjekt i çdo plani vendor për menaxhimin e mbeturinave. Të gjitha masat dhe sanksionet duhet të hartohen në përputhje me legjislacionin nacional dhe politikat lokale të menaxhimit të mbeturinave. Gjithësesi shumë e rëndësishme për ekzekutimin efikas është që këto masa dhe sanksione të miratohen me Vendimin e Asamblesë Komonale dhe t'i komunikohen të gjithë konsumatorëve të shërbimit përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit. Komuna duhet të ndër marrë një fushatë të fuqishme sensibilizimi për të gjithë konsumatorët, veçanërisht për banorët, duke reklamuar shërbimin e grumbullimit të mbeturinave, rregullat dhe përgjegjësitë.

6.5 Aktivitetet kryesore për të përmbushur objektivin V të planit

Objektivi 5 ka të bëjë me *"Grumbullimi i ndarë i fraksioneve të ndryshme të mbeturinave, duke evituar hedhjen e tyre në konteinerët e mbeturinave komunale"*. Në konteinerët e mbeturinave komunale nuk lejohet që të hidhen fraksione të mbeturinave të tjera, si ato spitalore, inerte, mbeturina shtazore, vëllimshme, mbeturina nga vajrat e përdorur, mbeturina nga pajisjet elektrike dhe elektronike. Nisur nga ky fakt, komuna ndonëse nuk është përgjegjëse e drejtëpërdrejtë për menaxhimin e këtyre fraksioneve të mbeturinave, duhet të mundësojë instrumenta për grumbullimin e ndarë të këtyre fraksioneve për të evituar hedhjen e tyre në konteinerët e mbeturinave komunale/deponi. Përgjatë 5 vjeçarit të hartimit të planit përcaktohen objektivat e mëposhtëm për grumbullimin e ndarë të mbeturinave spitalore të rrezikshme:

Reduktimi i mbeturinave spitalore të rrezikshme
80% deri në 2021
100% pas 2023

Reduktimi i mbeturinave shtazore
40% deri në 2021
80% pas 2023

Reduktimi i mbeturinave inerte
50% deri në 2021
70% pas 2023

Reduktimi i mbeturinave vëllimshme
20% deri në 2021
40% pas 2023

Reduktimi i vajrave të përdorur
50% deri në 2021
80% pas 2023

Reduktimi i mbeturinave elektrike elektronike
20% deri në 2021
40% pas 2023

Veprimet konkrete që duhet të kryejë komuna janë:

6.5.1 Menaxhimi i mbeturinave spitalore

- Përcaktimi i sasive të prodhuara të mbeturinave të rrezikshme medicinale
- Caktimi i protokolleve për grumbullimin, magazinimin dhe transportin e sigurt të tyre
- Furnizimi me infrastrukturën e nevojshme për grumbullimin e ndarë të mbeturinës medicinale në klinikat dhe qendrat spitalore
- Identifikimi i mundësisë për asgjësimin në nivel rajonal ose brenda spitalit.

6.5.2 Menaxhimi i mbeturinave inerte (Prioritet)

- Formulimi dhe publikimi i një fushate vetëdijësimi për mbeturinat inerte
- Zbatimi i legjislacionit dhe përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit
- Vendosja e protokolleve të veçanta për grumbullimin dhe transportin për gjeneruesit e mbeturinave inerte
- Hartimi i një rregulloreje të veçantë për këtë lloj mbeturine (roli detyrat përgjegjësitë, protokollet e grumbullimit, transportit dhe asgjësimit)
- Caktimi i një pike në rajon për depozitimin dhe asgjësimin e kësaj mbeturine
- Kushtëzimet në lejen e ndërtimit.

6.5.3 Menaxhimi i mbeturinave të vëllimshme, elektrike/elektronike, vajrave të përdorura

- Caktimi i pikave për grumbullimin e këtyre llojeve të mbeturinave (ku çdo prodhues i sjell vetë mbeturinat që prodhon)
- Hapja pranë këtyre pikave të dyqaneve të dorës së dytë (riparim dhe ripërdorim i mbeturinave vëllimshme dhe elektronike)

- c. Simulimi i bizneseve dhe lidhja e marrëveshjeve me to për grumbullimin e rymave të vecanta siç mund të jenë (bateritë, vajrat e përdorura, makinat në fund të jetës së tyre)
- d. Mundësia e asgjësimit të mbeturinave shtazore në nivel rajonal/furnizimi i prodhuesëve me konteinerë të veçantë dhe përcaktimi i masave për transportin dhe asgjësimin e kësaj rryme
- e. Hartimi i rregulloreve të veçanta për menaxhimin e çdo rryme (roli detyrat përgjegjësitë, protokollet e grumbullimit, transportit dhe asgjësimit).

6.6 Aktivitetet kryesore për të përmbushur objektivin VI të planit

Sipas programit të hartuar nga komuna në bashkëpunim me GIZ, të 35 deponitë ilegale të evidentuara në territorin e komunës do të pastrohen brenda vitit 2020. Veprimet konkrete që komuna ka parashikuar në lidhje me mbylljen e deponive ilegale janë si më poshtë:

- a. Vlerësimi i terrenit dhe përcaktimi i buxhetit për pastrimin e deponive ilegale - **16,000 euro**
- b. Në sajë të bashkëpunimit me Kompaninë "Eco-Higjena sh.p.k Gjilan, Njësia Operative Viti" do të bëhet largimi i vazhdueshëm i deponive, duke edukuar komunitetin për të mos hedhur mbeturinat në këto zona;
- c. Fillimi i një fushate vetëdijësimi, duke vendosur mbishkrime si "Ndalohet hudhja e mbeturinave", si dhe takime me banorët që jetojnë afër deponive ilegale.

Ndonëse komuna në bashkëpunim me kompaninë regjionale do të zbatojë planin për mbylljen e deponive aktuale, është shumë e rëndësishme që ajo të hartojë protokolle për të siguruar mospërsëritjen e këtyre pikave ilegale në të ardhmen. Këto protokolle do të konsistojnë në masat e mëposhtme:

1. Sigurimi i deponive duke i rrethuar me gardh pas pastrimit të tyre, për të eviduar rikrijimin e tyre
2. Pas pastrimit të tyre dhe rrethimit me gardh, komuna mund të vendosë që këto zona t'i kthejë në zona rekreative, si gjelbërimi i tyre duke i mbjellë me barë
3. Vendosja e disa tabelave informuese pranë zonave të deponive të egra "Mos hudhni mbeturina" apo "Ndalohet hudhja e mbeturinave"
4. Monitorimi i vazhdueshëm i pikave të nxehta, duke shtuar aktivitetin e inspektorëve në këto zona. Raportime të rregullta mujore në lidhje me gjendjen e deponive të egra, duke angazhuar edhe komunitetin për të evidentuar dhe raportuar raste të hudhjeve ilegale
5. Njoftimi i komunitetit që në rast se ata identifikohen që kanë deponuar mbeturina në atë zonë, do të merren masa ndëshkuese.

6.7 Aktivitetet kryesore për të përmbushur objektivin VII të planit

Ky program, do t'iu vijë në ndihmë jo vetëm komunitetit, i cili do të njihet me skemat e reja dhe iniciativat pilot të kompostimit, por edhe nxënësve të shkollave, të cilët do të marrin iniciativën për të zhvilluar procesin e kompostimit, në nivel komuniteti apo në ambientet e shkollave.

Objektivat e fushatës vetëdijësuese dhe informuese do të konsistojnë si më poshtë:

1. Vetëdijësimin dhe informimin e qytetarëve në komunë në lidhje me skemat e reja të menaxhimit të mbeturinave, si do të kryhen, si dhe angazhimin e tyre konkret në aplikimin e tyre;
2. Vetëdijësimin dhe rritjen e numrit të qytetarëve që paguajnë tarifën për shërbimet e mbeturinave;
3. Mbështetje në aplikimin e skemave nxitëse për tarifa më të ulta të mbeturinave në sajë të angazhimit të komunitetit në aplikimin e skemave të kompostimit, duke përmirësuar në këtë mënyrë edhe shërbimin dhe cilësinë e mjedisit;
4. Rritja e numrit të qytetarëve dhe nr. nxënësve të shkollave të informuar në lidhje me procesin e kompostimit, dhe njëkohësisht që janë gati të ndërmarrin iniciativën për kompostimin e mbeturinave organike;
5. Vetëdijësimin dhe informimin e qytetarëve në komunë në lidhje me procesin se si do të kryhet kompostimi, si dhe angazhimi i tyre konkret në aplikimin e skemave të kompostimit;
6. Prezantimin e skemave të ndryshme të kompostimit për kategori të ndryshme të qytetarëve dhe aktorëve që do të përfshihen në këtë iniciativë;
7. Prezantimin e modeleve/metodave që do të ndihmojnë në informimin dhe trajnimin e aktorëve të interesuar në aplikimin konkret të kompostimit të mbeturinave organike;
8. Prezantimin e skemave nxitëse për rritjen e pjesëmarrjes të aktorëve që do të aplikojnë skemat e kompostimit;
9. Promovimi i mbrojtjes së mjedisit urban dhe rural.

Fushata vetëdijësuese dhe komunikuese do të jetë pjesë e programit të komunave dhe do të jenë ato, të cilat do të zbatojnë këtë program në territorin e tyre. Konkretisht me anë të këtij programi stafet lokale të komunave do të synojnë që periodikisht (ashtu siç është përcaktuar edhe në hapat më poshtë) gjatë gjithë vitit, të zhvillojë fushata intensive vetëdijësimi dhe informimi për komunitetin dhe specifikisht për nxënësit e shkollave. Komunitat apo kompania duhet të sigurojnë burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore për të realizuar periodikisht gjatë vitit këtë program.

Në lidhje me burimet financiare komunitat apo kompania duhet të parashikojë linjat e buxhetit që lidhen me elementet më poshtë:

1. Përgatitja e materialeve informuese, si kalendari periodik i fushateve vetëdijësuese, si broshura, postera apo stenda për në ambientet e komunave dhe shkollave
2. Përgatitja e spotit publicitar informues për fushatat intensive periodike gjatë vitit kalendarik
3. Hedhja e informacioneve informuese në faqen e internetit të komunave dhe shpërndarja e informacionit në rrjete sociale
4. Përfshirja e ekspertëve/ trajnuesve të jashtëm që do të kryejnë sesionet e trajnimit në shkollat dhe në komunitet
5. Përgatitja dhe printimi i materialeve trajnuese për shkollat dhe komunitetin

Si fillim përfaqësuesit e komunave do të jenë pjesë e punëtorëve që do të zhvillohen në kuadër të projektit, ku do të njihen fillimisht me skemën e re të menaxhimit të mbeturinave dhe skema specifike e kompostimit të mbeturinave në komunitet të kompostimit të mbeturinave, mundësitë që ka zona për të zhvilluar këto skemë, grupet e interesit që realisht kanë mundësi dhe interes, përfitimet ekonomike të tregut nga aplikimi i skemës, vendosja e sistemit të tarifave për të përfituar

shërbime më të mira mjedisore si dhe paraqitja e një plani informues dhe vetëdijësues për komunitetin.

PROGRAMI I: PROGRAMI I FUSHATËS VETËDIJËSUESE DHE INFORMUESE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Rritja e njohurive të komunitetit dhe nxënësve në lidhje me skemat e menaxhimit të mbeturinave



HAPI 1- VEPRIMTARITË PARAPRAKE TË VETËDIJËSIMIT

Komuna duhet të promovojnë në komunitet apo në zonat pilot, ide dhe mënyra të reja për menaxhimin e mbeturinave, si prezantimi i skemave të reja për grumbullimin e mbeturinave (në burim), ndarjen e mbeturinave, ripërdorimi i mbeturinave, metodat alternative të dorëzimit të mbeturinave, etj., duke ndërmarrë fushata ndërgjegjësimi për publikun e gjerë, të fokusuar për disa konsumatorë apo në një zonë pilot.

Synimi për këtë fazë është t'i informojë njerëzit se është marrë një vendim për aplikimin e një skeme të re; apo se ekziston një mënyrë tjetër më e preferueshme për menaxhimin e mbeturinave në krahasim me mënyrën tradicionale; dhe se ekzistojnë arsye të mira për të ndërmarrë një ndryshim në praktikën aktuale të menaxhimit të mbeturinave. Shpërndarja e këtij informacioni në publik duhet të vijë jo vetëm si një vendim i marrë në nivel bashkie, por edhe në formën e një kërkese (me anë të një pyetësoi, i cili do të vlerësojë nevojat e komunitetit dhe mendimi që ka komuniteti për aplikimin e skemave të reja të menaxhimit të mbeturinave).

Nisur nga ky fakt, komuna mund të fillojë fushatën e vetëdijësimit me anë të një pyetësoi, i cili mund të përsëritet periodikisht (**1-2 herë në vit**), për të vlerësuar si fillim opinionin e tyre në lidhje me gjendjen ekzistuese të menaxhimit të mbeturinave dhe prezantimit të metodave të reja të menaxhimit të mbeturinave, si ndarja në burim, riciklimi, kompostimi i mbeturinave. Në këtë pyetësor do të parashikohet edhe një pjesë në lidhje me opinionin/sjelljen e banorëve kundrejt **tarifës së mbeturinave**, a janë ata të informuar në lidhje me shërbimet të cilat ata paguajnë, mendimi i tyre në lidhje me propozimin e tarifave të reja për mbetjet etj.

Metodat më të preferuara të vetëdijësimit publik, të cilat mund të përdoren nga Komuna si fazë fillestare e vetëdijësimit të komunitetit për menaxhimin e mbeturinave është **metoda derë më derë** duke përfshirë vullnetarë apo studentë të interesuar të bëhen pjesë e fushatave aktive.




HAPI 2- RRRITJA E INTERESIT

Një një fazë të dytë, komuniteti që tashmë është informuar dhe vetëdijësuar për çështjet e menaxhimit të mbeturinave, si dhe për idetë apo programet e reja, do të kërkojë informacione të tjera shtesë, ose do të jetë në pritje për të kërkuar informacione shtesë, përderisa komuna do të vendosë që të zbatojë këto skema të menaxhimit të mbeturinave në territorin që ata administrojnë.

Qëllimi është që t'i bëjnë ata më shumë me dije psh. **për praktikën e kompostimit dhe riciklimit të mbeturinave ose për praktikën e ndarjes së mbeturinave**. Kryesisht në zonën e përzgjedhur do të zbatohen skemat e kompostimit të mbeturinave në nivel komuniteti dhe shkollash⁸. Gjatë kësaj faze duhet që Komuna të fillojë të hartojë një program të detajuar, i cili duhet të ketë si qëllim jo vetëm informimin e komunitetit në lidhje me iniciativat e reja që janë ndërmarrë për menaxhimin e mbeturinave, por edhe konkretisht ku do të konsistojnë, infrastruktura e nevojshme, cili do të jetë roli i tyre në këto iniciativa, përfitimet konkrete që ata do të kenë, niveli i tarifave dhe metodat nxitëse financiare etj.

Kjo fazë e rritjes së interesit do të propozojë konkretisht hapat që do të ndjekë njësia vendore për të realizuar këtë fushatë ndërgjegjësimi, ku do të parashikohet të organizohen takime, seminare, vizita në terren, në impiantet e mbeturinave apo të riciklimit, etj., me pjesëmarrjen e individëve dhe grupeve të interesit duke përfshirë profesionistë dhe menaxherë të mbeturinave.



HAPI 3- VLERËSIMI DHE PËRMIRËSIMI

Në këtë fazë, drejtuesit e programeve, që janë përfaqësuesit e komunave, duhet të jenë në gjendje të vlerësojnë programin dhe rezultatet e tij të për një periudhë **çdo 3 muaj**, për të parë nëse programi është realizuar sipas parashikimeve, nëse ka rezultuar i suksesshëm, i përshtatshëm dhe financiarisht i përballueshëm për të përmbushur mjaftueshmërisht pritshmëritë dhe objektivat. Falë vlerësimit mund të përmirësohen aktivitetet, grafikët ose rrugët e operimit, të merren vendime nëse do të vazhdohet me programin, apo merren vendime për përmirësimin dhe mbështetjen e tij etj. Nga ana tjetër, komuna synon të përfshijë njerëzit më pranë programit, të rrisin pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre.

⁸ Në pjesën më poshtë ka informacion të zgjeruar në lidhje me programe konkrete ndërgjegjësimi dhe informimi për kompostimin në nivel komuniteti dhe shkollash.

Ky vlerësim mund të zhvillohet në fund të çdo fushate aktive (1 herë në muaj ose 1 herë në 3 muaj), ku komuna përcakton disa forma të kontrollit si më poshtë:

1. **Vlerësim vizual** në zonat, të cilat kanë filluar të zbatojnë skemat e reja të menaxhimit të mbeturinave;
2. **Vlerësim sasior**, në lidhje me sasinë e mbeturinave të cilat janë reduktuar nga rryma e përgjithshme e mbeturinave (pra kanë shkuar për riciklim apo kompostim);
3. **Vlerësim cilësor** i zonave në të cilat janë vendosur infrastruktura të posaçme për trajtimin e mbeturinave, si kosha për riciklim apo për kompostimin e mbeturinave, nëse ato janë funksionale apo jo dhe nëse janë të mirëmbajtura apo jo;
4. **Vlerësim i opinionit të qytetarëve**, kryesisht të atyre të cilët kanë filluar zbatimin e skemave të reja të menaxhimit të mbeturinave me anë të një pyetësoi të shkurtër, i cili duhet të nxjerrë në pah: i) **A është e përshatshme skema për qytetarët**; ii) **A janë ata të vetëdijësuar dhe informuar mjaftueshëm për operimin e suksesshëm të skemës**; iii) **Sistemi i aplikuar i tarifave a justifikon mjaftueshëm skemën e re të menaxhimit të mbeturinave etj.**

Gjatë kësaj faze, si autoritetet ashtu edhe konsumatorët do të kërkojnë prova të qëndrueshmërisë nga partneriteti i tyre i deritanishëm, me qëllim që palët të sigurohen se kontributi i gjithësecilit ka vlerë dhe se pala tjetër tregon përkushtimin e duhur. Në këtë fazë rekomandohen intervistat, takimet publike dhe seminarët për të treguar rezultatet dhe për të prezantuar hapat për të ardhmen.

PROGRAMI II: INFORMIMI PËR SISTEMIN E RI TË TARIFAVE

Komuna me fillimin e aplikimit të skemave të reja të menaxhimit të mbeturinave, apo me shtrirjen e shërbimit në territorin e saj, do të fillojnë të aplikojnë edhe një sistem të ri të tarifave të mbeturinave, për një shërbim i cili do të ofrohet në një territor më të madh, ku në disa raste nuk ekzistonte më parë. Nisur nga ky fakt, Komuna do të duhet të fillojë një fushatë vetëdijësimi për sistemin e ri të tarifave për mbetjet, e cila do të prekë qytetarët në dy nivele: i) ata që e paguanin më parë tashmë tani do të kenë një sistem të ri; ii) ata të cilët nuk kanë patur shërbim do t'u duhet së pari të njihen dhe të kuptojnë se si funksionon sistemi, ku ata do të bëhen pjesë, dhe më pas të njihen me detyrimin për të paguar rregullisht.

Në fushatën vetëdijësuese për sistemin e tarifave, e cila do të jetë pjesë e fushatës për promovimin e skemës së re, Komuna duhet të marrë në konsideratë këto parime:

1. **Alokimin eficient të burimeve që ka në dispozicion për të marrë përsipër inkasimin e tarifës së mbeturinave**
2. **Ofrimi në mënyrë sa më eficiente të shërbimit - krijimi i incentivave për të ofruar shërbimin me kosto sa më të ulët**
3. **Përdorimi eficient i burimeve natyrore - përmbushja e objektivave mjedisore, si promovimi i skemave të riciklimit dhe kompostimit**

4. **Mbulimi i kostos – tarifat e vendosura duhet të reflektojnë të gjitha shërbimet që kryhen për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave**
5. **Qëndrueshmëria financiare – tarifat e vendosura duhet të reflektojnë një qëndrueshmëri të sistemit të menaxhimit të mbeturinave**
6. **Barazi horizontale mes përdoruesve, të cilët duhet të paguajnë të njëjtën shumë për të njëjtin nivel shërbimi të ofruar**
7. **Zbatimi i parimit “Ndotësi Pagan”**
8. **Parimi i “Proporcionalitetit” – sasia e tarifës duhet të reflektojë sasinë e shërbimit të ofruar**
9. **Parimi i “Transparencës” – vendosja e tarifës duhet të jetë e qartë dhe nëse ka incentiva ato duhet të qartësohen për publikun**

Procesi i vendosjes së tarifës së mbeturinave duhet të kalojë në 9 hapa kryesorë, të cilat duhet të jenë pjesë e fushatës vetëdijësuese për tarifat e mbeturinave:

1. **Njohja me konsumatorët** – komuna duhet të identifikojë kategoritë dhe numrin e konsumatorëve që gjenerojnë mbeturina në territorin e saj. Ky informacion duhet të paraqitet në broshurat informuese.
2. **Sasia e mbeturinave që gjenerohen në komunë** – Pasi janë përcaktuar kategoritë dhe numri i konsumatorëve, komuna duhet të përcaktojë edhe sasinë e mbeturinave që gjenerohen në territorin e saj (sipas kategorive) dhe normat e gjenerimit të mbeturinave për kategoritë e konsumatorëve. Ky informacion që duhet të paraqitet në broshurat informuese do t'i japë mundësi konsumatorëve që të kuptojnë realisht sasinë e mbeturinave që gjenerohen në njësinë e tyre dhe sa e rëndësishme është pagesa e tarifës për të siguruar këtë shërbim.
3. **Vlerësimi i opsioneve teknike** – Skema e re do të parashikojë edhe aspekte të reja teknike për mënyrën e ofrimit të shërbimit. Ky informacion, në lidhje me aspektet e reja teknike të shërbimit (nr. i kontenierëve, lloji i tyre për mbeturinat e përziera apo të diferencuara, numri i makina për transport, stabilimentet për depozitim të mbeturinave etj) duhet t'i vihet në dispozicion komunitetit, që ai të kuptojë realisht teknologjinë e ofrimit të shërbimit të ri.
4. **Vendosja e marrëdhënies institucionale** – Komuniteti duhet të njihet me ndarjen e përgjegjësive dhe detyrave në skemën e re të ofrimit të shërbimit të mbeturinave. Cila do të jetë përgjegjësia dhe roli i secilit territor administrativ në skemën e re të menaxhimit të mbeturinave? Në këtë mënyrë ai do të kuptojë edhe dinamikat përkatëse në territorin ku ai ndodhet.
5. **Njohja me koston e ofrimit të shërbimit** – Për të vendosur tarifa sa më realiste duhet të përcaktojmë koston e plotë të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave sipas shërbimeve që do të ofrohen: i) për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave; ii) fshirjen dhe larjen e rrugëve; iii) trajtimin e ndërmjetëm të mbeturinave; iv) trajtimin final të mbeturinave; v) kostot operative; vi) kostot kapitale; vii) kostot indirekte etj. Në këtë mënyrë komuniteti e ka më të qartë koston e shërbimeve që ai do të marrë.
6. **Identifikimi i burimit të të ardhurave** – Komuniteti duhet të njihet edhe me burimet financiare të cilat do të sigurojnë ofrimin e shërbimit sipas standardeve.

7. **Përzgjedhja e niveleve të duhura për tarifën dhe llogaritja e tyre** – Pasi komuna ka përcaktuar numrin dhe kategoritë e konsumatorëve, kosot e shërbimit dhe burimet e të ardhura, ajo ka mundësinë që të përcaktojë edhe nivelet e duhura të tarifave për kategoritë e ndryshme të konsumatorëve. Ky informacion është mëse i rëndësishëm për t'u ndarë me konsumatorët, ku ata njihen specifikisht se për cilat shërbime, me një kosto të caktuar, ata do të paguajnë.
8. **Vendim-marrja strategjike** – Në sajë të karakteristikave të komunës merren disa vendime strategjike për vendosjen e nivelit të tarifave për kategoritë e konsumatorëve, ku përcaktohet sa përqind e koston pritët që të mbulohet nga mbledhja e tarifave.
9. **Komunikimi i sistemit të ri të tarifave** – Komuna mund të përcaktojë mënyrën më të mirë për informimin e publikut në lidhje me 8 hapat më lart, **të cilat mund të realizohen me anë të punëtorive periodike, standave në hyrje të njësive vendore apo edhe me broshura informuese, ku japin rezultatet e 8 hapave më lart.**

VII. HARTIMI I PLANIT OPERACIONAL, OBJEKTIVAT, INDIKATORET DHE AKTIVITETET

Objektivi	Aktivitete konkrete	Përshkrimi i aktiviteteve	Indikator	Përgjegjësia	Afati kohor	Kosto
Objektivi I: Hartimi i kuadrit ligjor dhe rregullator lokal për menaxhimin e mbeturinave – Konsolidimi i strukturës brenda komunës për sistemin e menaxhimit të mbeturinave	1.1 Miratimi i planit lokal të menaxhimit të mbeturinave					
	1.2 Konsolidimi i strukturës brenda komunës	<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i një database për shërbimin/hartimi i indikatorëve • Hartimin e fushatave vetëdijësuese • Hartimin e projekteve për minimizimin e mbeturinave • Hartimin e rregulloreve të brendshme/rryma të veçanta • Përditësimin e planit lokal të menaxhimit të mbeturinave në varësi të zhvillimeve të ndryshme • Monitorimin e shërbimit nga zyrtari i ambjentit apo zyrtari për mbeturinat 		Komuna Vitisë	2020	17,000 €
	1.3 Ngritja e kapaciteteve brenda komunës	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkrimi i punës për çdo specialist, konkretisht për zyrtarin/ zyrtarët e ambjentit në komunë • Ngritje kapaciteteve me anë të trajnimeve në vendin e punës në lidhje me aspektet të ndryshme në fushën e menaxhimit të mbeturinave: <i>Moduli 1: Planifikimi i grumbullimit, magazinimit dhe transportit të mbeturinave të ngurta urbane; Moduli 2: Minimizimi i mbeturinave; Moduli 3: Aspektet ekonomike të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave; Moduli 4: Organizimi i</i> 		Komuna Vitisë	2020-2021	7,200 €

		shërbimeve, aspektet institucionale, rregullatore, informuese dhe monitoruese të menaxhimit të mbeturinave		Komuna Vitisë	2020-2021	
1.4 Hartimi i një sistemi monitorimi për matjen e performancës të shërbimit	<ul style="list-style-type: none"> • Hartimi i indikatorëve të cilësisë së shërbimit • Krijimi i formateve të raportimit • Krijimi i një sistemi për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave në GIS, ku do të rregjistrohen: <ul style="list-style-type: none"> i. Të gjithë konsumatorët që janë pjesë e sistemit të inkasimit dhe mundësohen me shërbim; ii. Të gjitha pikat e grumbullimit kolektiv të mbeturinave, deponitë e depozitimit të mbeturinave; iii. Modelimi i itinerarëve që mjetet teknologjike do të kryejnë në komunë 					

	1.5 Hartimi i një programi vetëdijësimi për minimizimin e mbeturinave	<ul style="list-style-type: none"> • Programe për informimin i. Fushata vetëdijësimi për informim mbi teknikat e parandalimit të prodhimit të mbeturinave ii. Prezantimi i etiketimeve ekologjike të produkteve • Programe për promovimin i. Mbështetje për hartimin e marrëveshjeve me bizneset ii. Promovimi i ripërdorimit dhe riparimit iii. Promovimi i grumbullimit të diferencuar iv. Promovimi i incentivave për konsumimin e produkteve të pastra...etj • Programe rregulatore i. Vendosija e diferencuar e taksave për të stimuluar riciklimin/kompostimin ii. Informimi dhe zbatimi i politikave për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit iii. Hartimi dhe zbatimi i protokolleve për rrymat e ndryshme të mbeturinave (inerte, voluminoze etj). 	% e mbeturinave të riciklueshme që largohet nga rryma kryesore e mbeturinave	Komuna Vitisë	2021	2,400 €
Objektivi II: Konsolidimi i shërbimit në zonat ku ofrohet dhe zgjerimi i shërbimit në zonat ku aktualisht nuk ofrohet shërbim (në masën 100%)	2.1 Zgjerimi i shërbimit të ofruar në amvisëritë të cilat nuk mundësoheshin me shërbim	<ul style="list-style-type: none"> • Analizimi i mundësive dhe mjeteve financiare të nevojshme që i nevojiten kompanisë (të dyja kompanive) për të zgjeruar shërbimin • Analizimi i klientëve dhe efektivitetit në mbledhjen e të ardhurave në zonat ku do të zgjerohet shërbimi • Përcaktimi i numrit të kontenerëve, koshave, shportave, tipi dhe kapaciteti i tyre, numri i makinave, kapaciteti, tipi i tyre dhe puntorëve shtesë që nevojiten Riorganizim pikash grumbullimi në zonën urbane 	% e sasisë së mbeturinave të grumbulluara kundrejt sasisë totale të mbeturinave të prodhuara % e nr. të klientëve të shërbyer kundrejt nr. të	Komuna Vitisë dhe kompania "Eco-Higjena sh.p.k Gjilan, Njësia Operative Viti"	2021-2024	305,600 €

		<ul style="list-style-type: none"> • Përfshirja e ekonomive familjare në shërbim. 	përgjithshëm të klientëve		
Objektivi III: Nxitja e iniciativave për minimizimin e mbeturinave përmes stimulimit të	3.1 Hartimi i projekteve pilote për minimizimin e mbeturinave	<p>a. Kompostimi individual tek amviseritë në zonën ku shërbimi jepet derë më derë. i) Përcaktimi i zonave (të paktën 3 - 5 fshatra/zona periferike - fshati Llughaxhi) ku do të aplikohet kompostimi individual; ii) Hartimi i fushatës së komunikimit dhe konsultimi me banesat ku do të aplikohet kompostimi – vlerësimi i gadishmërisë dhe njohurive të tyre; iii) Hartimi i termave të referencës dhe përgatitja e tenderit për investimet</p>	% e sasisë së mbeturinave të riciklueshme që largohen nga rryma kryesore e mbeturinave 5% e mbeturinave të riciklueshme	Komuna Vitisë dhe kompania "Eco-Higjena sh.p.k Gjilan, Njësia Operative Viti"	2020-2024 59,700 €
	2.2 Konsolidimi i shërbimit të ofruar, në zonat ku aktualisht ai afrohet	<p>a. Analizimi i kohës së nevojshme për grumbullim dhe transportin e mbeturinave. b. Analizimi i distancave të përshkruara dhe rirregullimi i intererareve dhe optimizimi i rrugës së transportit c. Standardizimi i shërbimit (grumbullim derë më derë me kontenerë 120 litra; dhe grumbullimi kolektiv me kontenerë 1.1m3 dhe kontenerë nëtokësorë 5m3).</p>		Komuna Vitisë dhe kompania "Eco-Higjena sh.p.k Gjilan, Njësia Operative Viti"	2021-2024

<p>grumbullimit të diferencuar dhe kompostimit. Minimizimi i mbeturinave urbane që shkojnë në landfill me 5% gjatë periudhës</p>		<p>në infrastrukturë (komposterët individual); iv) Identifikimi i klientëve të interesuar për t'u përfshirë në skemën e kompostimit dhe ndërtimi i një database; v) Hartimi i politikave lehtësuese dhe stimuluese për shtimin e klienteve në skemë.</p> <p>b. Riciklimi – Hartimi i një programi riciklimi për bizneset si supermarketet/qendra tregtare/kafenetë etj: i) Caktimi i subjekteve të cilat do të grumbullojnë në mënyrë të diferencuar mbeturinat (30 të tilla); ii) Caktimi i rrymave që do të grumbullohen (leter, karton, plastikë, alumin); iii) Analizimi i sasisë dhe ndërtimi i skemës së grumbullimit; iv) Përcaktimi i subjektit që do të bëjë grumbullimin dhe magazinimin e materialeve të riciklueshme; v) Hartimi i një fushate informuese për mënyrën e funksionimit.</p> <p>c. Riciklimi – hartimi i një programi Drop off system në zonën A ose B: i) Caktimi i pikave ku do të grumbullohen materialet e riciklueshme të thata/hartimi i projektit për ndërtimin e tyre dhe mënyrën e funksionimit; ii) Caktimi i rrymave që do të grumbullohen (leter, karton, plastikë, alumin); iii) Analizimi i sasisë dhe çmimit për çdo rrymë; iv) Hartimi i një fushate informuese për mënyrën e funksionimit; v) Përcaktimi i subjektit që do të bëjë grumbullimin dhe magazinimin e materialeve të riciklueshme.</p> <p>d. Organizimi dhe mbyqyrja e procesit të riciklimit</p>	<p>largohe nga rryma kryesore e mbeturinave</p>		
--	--	---	---	--	--

<p>Objektivi IV: Rritja e nivelit të inkasimeve nga tarifatat në zonat ku ofrohet shërbimi me 100% deri në vitin 2024</p>	<p>4.1 Forcimi i kapaciteteve për grumbullimin e tarifës</p>	<p>a. Për çdo zonë kompani/komuna do të krijojnë/konsolidojnë rregjistrat e përfitueseve të shërbimit, me kontratat ekzistuese, duke i kategorizuar dhe përditësuar ato çdo vit;</p> <p>b. Firmat/komuna identifikon dëshirën për të paguar nga konsumatorët, duke realizuar fushata me pyetësorë, ose takime individuale me konsumatorët komercialë;</p> <p>c. Krijimin e grupeve të këshillimit, të cilët veprojnë në çdo fshat përmes takimeve me komunitetin;</p> <p>d. Analizimin e skenarëve për mbulimin e kostos nga të ardhurat e tarifave të mbeturinave, duke marrë në konsideratë grupet e marginalizuara;</p> <p>e. Komuna përcakton tarifën për mbeturinat bazuar në koston e plotë të logaritit të shërbimit në territorin e saj.</p> <p>f. Funkcionalizimin i sistemit të faturimit dhe inkasimit në kuadër të Njësisë (Sektorit) për Menaxhimin e Mbeturinave, nën varësi të Drejtorisë për Shërbime Publike</p>	<p>% e klientëve që hyjnë në sistemin e inkasimit</p> <p>niveli i inkasimit rritet me 100% deri në fund të vitit 2024</p>	<p>Komuna Vitisë</p>	<p>2021-2024</p>	<p>10,000 €</p>
<p>6.4.2 Rritja e numrit të klienteve që paguajnë tarifën</p>		<p>a. Krijimin e një sistemi të qartë procedurash për mbledhjen e tarifave, bëren transparente për çdo grup që përfiton shërbimin;</p> <p>b. Ndërmarrja e fushatave vetëdijësuese për rritjen e inkasimeve;</p> <p>c. Ndërrimi dhe funksionalizimi i mekanizmit që mundëson faturimin e të gjithë klientëve që marrin shërbimin ;</p> <p>d. Përgatitja e një studimi mbi sistemet e grumbullimit të tarifave për amviseritë, bizneset dhe institucionet;</p> <p>e. Stimulimi i pagesve të rregullta përmes politikës fiskale lehtësuese;</p>		<p>Komuna Vitisë</p>	<p>2021-2024</p>	

<p>Objektivi V: Grumbullimi i diferencuar i fraksioneve të ndryshme të mbeturinave, duke evituar hedhjen e tyre në kontenierët e mbeturinave komunale</p>	<p>5.1 Menaxhimi i mbeturinave spitalore</p>	<p>f. Dizenjimi dhe prezantimi i logos së gjelbër për bizneset që riciklojnë/kompostojnë/që paguajnë rregullisht</p> <p>a. Përcaktimi i sasive të prodhuara të mbeturinave të rrezikshme spitalore; b. Caktimi i protokolleve për grumbullimin, magazinimin dhe transportin e sigurt të tyre; c. Furnizimi me infrastrukturën e nevojshme për grumbullimin e diferencuar të kësaj rryme i qendrave spitalore; d. Identifikimi i mundësisë për asgjësimin në nivel rajonal ose brenda spitalit</p>	<p>80% e tyre reduktohen</p>	<p>Komuna Vitisë në bashkëpunim me institucionet e ordinancës</p>	<p>2023</p>	
	<p>5.2 Menaxhimi i mbeturinave inerte (Prioritet)</p>	<p>a. Formulimi dhe publikimi i një fushate vetëdijësimi për mbeturinat inerte; b. Zbatimi i legjislacionit dhe përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit; c. Vendosja e protokolleve të veçanta për grumbullimin dhe transportin për gjeneruesit e mbeturinave inerte; d. Hartimi i një rregulloreje të veçantë për këtë rrymë (rol i detyrat përgjegjësitë, protokollet e grumbullimit, transportit dhe asgjësimit) e. Caktimi i një pike në rajon për depozitimin dhe asgjësimin e kësaj rryme; f. Kushtëzimet në lejen e ndërtimit.</p>	<p>50% e tyre reduktohen</p>	<p>Komuna Vitisë</p>	<p>2023</p>	

<p>Objektivi VI: Eliminimi i 35 deponive të egra të evidentuara në territorin e Komunës Vitisë</p>	<p>5.3 Menaxhimi i mbeturinave voluminoze, elektrike/elektronike, vajrave të përdorura</p>	<p>a. Caktimi i pikave për grumbullimin e këtyre rrymave; b. Hapja pranë këtyre pikave të dyqaneve të dorës së dytë; c. Simulimi i bizneseve dhe lidhja e marrëveshjeve me to për grumbullimin e rymave të vecanta siç mund të jenë (bateritë, vajrat e përdorura, makinat në fund të jetës së tyre); d. Mundësia e asgjësimit të mbeturinave shtazore në nivel rajonal/furnizimi i prodhuesëve me kontenerë të veçantë dhe përcaktimi i masave për transportin dhe asgjësimin e kësaj rryme; e. Hartimi i rregulloreve të veçanta për menaxhimin e çdo rryme (roli detyrat përgjegjësitë, protokollet e grumbullimit, transportit dhe asgjësimit).</p>	<p>20% e tyre reduktohen</p>	<p>Komuna Vitisë</p>	<p>2023</p>	
	<p>6.1 Pastrimi i deponive aktuale</p>	<p>a. Vlerësimi i terrenit dhe përcaktimi i buxhetit për pastrimin e deponive ilegale; b. Në sajë të një bashkëpunimi me Kompani Eco-Higjeni sh.k.p Gjilan, Njësia Operative Viti; c. Fillimi i një fushate vetëdijësimi, duke vendosur mbishkrime si "Ndaloheh hudhja e mbeturinave", si dhe takime me banorët që jetojnë afër deponive ilegale.</p>	<p>% e deponive të pastruara kundrejt atyre të pa pastruara</p>	<p>Komuna Vitisë</p>	<p>2020-2021</p>	<p>16,000 €</p>

	6.2 Parandalimi i krijimit të deponive	1. Sigurimi i deponive duke i rrethuar me gardh pas pastrimit të tyre, për të eviduar rikrijimin e tyre; 2. Pas pastrimit të tyre dhe rrethimit me gardh, komuna mund të vendosë që këto zona t'i kthejë në zona rekreative, si gjelbërimi i tyre duke i mbjellë me barë; 3. Vendosja e disa tabelave informuese pranë zonave të deponive të egra "Mos hudhni mbeturina" apo "Ndalohet hudhja e mbeturinave"; 4. Monitorimi i vazhdueshëm i pikave të rxehta, duke shtuar aktivitetin e inspektorëve në këto zona. Raportime të rregullta mujore në lidhje me gjëndjen e deponive të egra, duke angazhuar edhe komunitetin për të evidentuar dhe raportuar raste të depozitimeve ilegale; 5. Njoftimi i komunitetit që në rast se ata identifikohen që kanë deponuar mbeturina në atë zonë, do të merren masa ndëshkuese. 6. Ndërtimi i stacionit të transferimit	% e deponive të rikrijuara në vendet ekzistuese	Komuna Vitisë	

Objektivi VII: Hartimi i një strategjie komunikimi me qytetarët për çështjet e menaxhimit të mbeturinave komunale në territorin e komunës	7.1 Planifikimi i strategjisë dhe hartimi i programeve për vetëdijësim dhe informim të komunitetit	<ul style="list-style-type: none"> Vetëdijësimin dhe informimin e qytetarëve në komunë në lidhje me skemat e reja të menaxhimit të mbeturinave, si do të kryhen, si dhe angazhimin e tyre konkret në aplikimin e tyre Vetëdijësimin dhe rritjen e numrit të qytetarëve që paguajnë tarifën për shërbimet e mbeturinave Mbështetje në aplikimin e skemave nxitëse për tarifa më të ulta të mbeturinave në sajë të angazhimit të komunitetit në aplikimin e skemave të kompostimit, duke përmirësuar në këtë mënyrë edhe shërbimin dhe cilësinë e njedisit Rritja e numrit të qytetarëve dhe numrit të nxënësve të shkollave të informuar në lidhje me procesin e kompostimit, dhe njëkohësisht që janë gati të ndërmarrin iniciativën për kompostimin e mbeturinave organike Vetëdijësimin dhe informimin e qytetarëve në komunë në lidhje me procesin se si do të kryhet kompostimi, si dhe angazhimi i tyre konkret në aplikimin e skemave të kompostimit dhe riciklimit të mbeturinave Prezantimin e skemave të ndryshme të kompostimit për kategori të ndryshme të qytetarëve dhe aktorëve që do të përfshihen në këtë iniciativë Prezantimin e modeleve/metodave që do të ndihmojnë në informimin dhe trajnimin e 	Komuna Vitisë	2020-2021	
		<ul style="list-style-type: none"> Vetëdijësimin dhe informimin e qytetarëve në komunë në lidhje me skemat e reja të menaxhimit të mbeturinave, si do të kryhen, si dhe angazhimin e tyre konkret në aplikimin e tyre Vetëdijësimin dhe rritjen e numrit të qytetarëve që paguajnë tarifën për shërbimet e mbeturinave Mbështetje në aplikimin e skemave nxitëse për tarifa më të ulta të mbeturinave në sajë të angazhimit të komunitetit në aplikimin e skemave të kompostimit, duke përmirësuar në këtë mënyrë edhe shërbimin dhe cilësinë e njedisit Rritja e numrit të qytetarëve dhe numrit të nxënësve të shkollave të informuar në lidhje me procesin e kompostimit, dhe njëkohësisht që janë gati të ndërmarrin iniciativën për kompostimin e mbeturinave organike Vetëdijësimin dhe informimin e qytetarëve në komunë në lidhje me procesin se si do të kryhet kompostimi, si dhe angazhimi i tyre konkret në aplikimin e skemave të kompostimit dhe riciklimit të mbeturinave Prezantimin e skemave të ndryshme të kompostimit për kategori të ndryshme të qytetarëve dhe aktorëve që do të përfshihen në këtë iniciativë Prezantimin e modeleve/metodave që do të ndihmojnë në informimin dhe trajnimin e 	<p>% e qytetarëve të informuar</p> <p>% e fushatave të vetëdijësimit të zhvilluara në komunë</p>		

				<p>aktorëve të interesuar në aplikimin konkret të kompostimit të mbeturinave organike dhe riciklimin e mbeturinave të riciklueshme</p> <ul style="list-style-type: none"> • Prezantimin e skemave nxitëse për rritjen e pjesëmarrjes të aktorëve që do të aplikojnë skemat e kompostimit dhe riciklimit të mbeturinave • Promovimi i mbrojtjes së mjedisit urban dhe rural • Programi I: Programi i fushatës vetëdijësuese dhe informuese për menaxhimin e mbeturinave • Programi II: Informimi për sistemin e ri të tarifave 			

VIII. RISHIKIMI I PLANIT

Rishikimi i këtij plani do të jetë një proces i vazhdueshëm që përsëritet çdo 5 vjet, ose më shpesh nëse zhvillimet në legjislacion ose në zonë indikojnë nevojën për rishikimin e objektivave dhe masave, apo nëse politika nacionale e mbeturinave rekomandon apo detyron ndryshime thelbësore në lidhje me menaxhimin e mbeturinave. Gjatë zbatimit të planit është e rëndësishme që të analizohen në mënyrë të vazhdueshme të gjithë faktorët që ndikojnë në masat e planifikuara dhe objektivat e vëna, siç mund të jenë ndryshimet në standardin e jetesës të komunës, në konsumin, vëllimin e mbeturinave, zhvillimet demografike, etj. Gjithashtu analizimi i këtyre faktorëve shërben për të vlerësuar programet dhe projektet në proces apo që priten të fillojnë.

8.1 Monitorimi i Zbatimit të Planit

Monitorimi i planit do të bëhet sipas indikatorëve të performancës të përcaktuar në tabelën e mëposhtme që do të shërbejë: **i)** Për të dhënë informacion të vazhdueshëm tek bashkëpunëtorët dhe grupet e interesit mbi statusin e zbatimit të planit; **ii)** Për të analizuar statusin dhe për të vlerësuar efektivitetin e skemave të zbatuara; **iii)** Për të përshtatur, modifikuar ose forcuar skemat apo programet në proces, ose për të krijuar të reja më të përshtatshme apo më të efektshme.

Indikatorët e performancës		Klasifikimi i koduar sipas ngjyrave			Cilësia e të dhënave
		I ulët	Mesëm	I lartë	
					I ulët Mesëm I lartë
Cilësia e shërbimit	C1 Sipërfaqja e mbuluar me shërbim				
	<i>C1.1 Zonat urbane dhe periferike</i>	0 – 40 %	41 – 80%	81 – 100%	
	<i>C1.2 Zonat rurale</i>	0 – 30 %	31 – 50%	51 – 100%	
	C2 Pastërtia e qytetit	0 – 32 %	33 - 66%	> 66%	
C3 Perceptimi i publikut: shkalla e kënaqësisë kundrejt shërbimit	0 – 50%	51 - 80%	81 - 100%		
Qëndrueshmëri mjedisore	D1 Ripërdorimi: shkalla e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve	0 – 5%	5 – 20%	>20%	
	D2 Mbrojtja e burimeve natyrore: shkalla e trajtimit të mbetjeve në impiante trajtimi.	0 – 30%	31 – 70%	71 – 100%	
Qëndrueshmëria ekonomike dhe financiare	E1 Mbulimi i kostos: Tarifat mbulojnë koston.	0 – 35%	36 – 70%	71 – 100%	
	E2 Sa banorët kontribuojnë në financimin e shërbimit : shkalla e mbledhjes së tarifës	0 – 40%	41 – 75%	75 – 100%	
	E3 Transparenca e sistemit të faturimit	uUlet	mesme	lartë	
Kosto e shërbimit	Euro/ton			
	Euro / banorë / vit			

Figura 26 Indikatorët e performancës
[Burimi: zhvilluar nga autori]

8.2 Raportimi

Çdo komunë ka si detyrim të raportojë në Ministrinë e Mjedisit dhe Panifikimit Hapësinor, sot Ministria e Infratsukturës, një raport vjetor për realizimin e planit komunal të menaxhimit të mbeturinave për territorin e saj deri në 31 Mars të vitit vijues. Ndërkohë zotëruesit dhe prodhuesit e mbeturinave jo komunale duhet të paraqesin një raport vjetor pranë Ministrisë brenda datës 31 Mars të vitit vijues. Personat e licensuar që merren me menaxhimin e mbeturinave paraqesin raportin vjetor në të njëjta afate kohore pranë Komunave përkatëse. Ministria pasi mbledh raportimet nga Komunat dhe nga zotëruesit dhe prodhuesit e mbeturinave komunale përgatit një raport vjetor dhe ja paraqet Qeverisë në 3 mujorin e dytë të vitit vijues.




Figura 27 Struktura e rishikimit të planit
[Burimi: Ligji për mbeturinat neni 58, përshtatur nga autori]

Këto raportime duhet të përmbajnë:

- Llojin, përbërjen, karakteristikat, sasinë, origjinën, ruajtjen, transportin, trajtimin, përpunimin, riciklimin, magazinimin dhe deponimin e mbeturinave si dhe mbeturinave të cilat pranohen në objektet dhe pajisjet për menaxhimin e mbeturinave;
- Llojin, përbërjen, karakteristikat, sasinë, origjinën, ruajtjen, transportin dhe destinimin e lëndës së parë sekondare të përfituar në objektet për menaxhimin e mbeturinave;
- Çështje tjera të rëndësishme.

IX. REFERENCAT E PLANIT

RAPORTI PËR DEPONITË E EGRA NË KOMUNËN VITI

REGJISTRIMI I POPULLSISË EKONOMIVE FAMILJARE DHE BANESAVE NË KOSOVË 2011, Agjensia e Statistikave të Kosovës

DRAFT PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E VITISË

LIGJI NR. 04/L-060 "PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE" 2012, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor

STRATEGJIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE 2013-2022, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor

PLANI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE (PRKMM) 2013-2017, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor

TË DHËNA NGA DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, Komuna Viti,

TË DHËNA NGA KOMPANIA ECO-HIGJENA SH.P.K NJËSIA OPERATIVE VITI